

VENDIMI I ATP PER PRONAT

Zbardhet kërkesa e plotë për të marrë kompesimin

Dokumentat që duhen për të paraqitur kërkesën si dhe afatet e përcaktuara

► F12

SUPLEMENTI "RILINDASI"

► F13-20

KJO ESHTË ZYLI...

TE PATHENAT E AKTORES SE 250 PREMIERAVE NE SKEÇE, KINEMA E TEATER

NGA XHAHID BUSHATI

WHITNEY WARREN, NJE AMERIKAN NE SHQIPERI NE MBARIM TE LUFTES SE PARE BOTERORE

NGA FOTAQ ANDREA



[SHQIPTARJA.COM]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR. 34

E DIEL, 12-02-2017

www.shqiptarja.com

EKSKLUZIVE

Soros në Shqipëri:

"LIDHJA ME PS NE PUSHTET NA PREK BESUESHMERINE"

Shqiptarja.com zbardh e-mail-et e hakeruara të organizatës së George Soros. Çfarë thuhet për politikën e ndjekur në Shqipëri. Ja raporti me Partinë Socialiste dhe Partinë Demokratike. Lobimi i fortë për integrimin e vendit tonë në BE



RAPORTIMET

FONDACIONI SOROS INTERES TE PAKET PER VENDIN TONE

► FAQE 2-3

HISTORIA

SI U VODH KORRESPONDENCA ELEKTRONIKE E GEORGE SOROS



EMERIMET E FUNDIT ► F4

KLD kërkon rikthimin në detyrë të gjyqtarëve të pezulluar për korrupsion

SKEMA E RE ► F9

Veliq: Bashkia e Tiranës do japë 1 milion dollarë kredi për strehim

KONVENTA E LSI ► F6-7

ILIR META FLET PER 'PAPAGALLET': LSI NUK E KA FRIKE REFORMEN NE DREJTESI

Thumbimi për qeverinë: Mos jepni me koncesion dinjitetin e të rinjve



SKANDALI 'CEZ' ► F5

THIRRET SERISH SHKELZEN BERISHA, GATI DY DOSJE PENALE

Strategjia e komisionit hetimor për të marrë dëshmitë e djalit të Berishës dhe sekserit Nuel Kalaj

HISTORIA E FONDACIONIT SOROS NË SHQIPËRI

- 1992 - 1995** Themelohet Fondacioni. Programet e tij kryesore janë në fushën e medias, arsimit dhe kulturës
- 1996 - 2000** Rritet mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë civile, reformën ligjore, si dhe administratën publike.
- 2002 - 2008** Puna e fondacionit është e përqendruar në përmirësimin e qeverisjes dhe mbështetjen ndaj reformës institucionale.
- 2001 - 2005** Disa programe kyçe të fondacionit shkrihen me organizatat lokale të pavarura.
- 2005 - 2008** Fondacioni delegon pjesë të punës së programit të saj operative tek gjashtë organizata shqiptare të shoqërisë civile.
- 2009 NË VAZHDIM** OSFA rishikon fushat prioritare për të përfshirë: qeverisjen e mirë dhe integrimin në BE; drejtësia e të drejtat e njeriut; dhe përfshirja sociale.



Demokratët sillen keq

"Në fund të fundit, megjithatë, qëndrueshmëria e pozitave tona dhe zhvillimet në vend (përmirësimi i komunikimeve me Partinë Socialiste dhe vazhdimi i sjelljes së keqe nga demokratët) ndihmoi për të vënë politikën në lëvizje".

TRE RASTE KUR NDËRHYRI SOROSI

- 1- Pas zgjedhjeve të vitit 2009, kur opozita e atëhershme i cilësoi ato të pavlefshme, bojkotoi Parlamentin dhe nisi një grevë urie
- 2- Në vitin 2011, pas zgjedhjeve lokale dhe rezultateve të diskutueshme në Bashkinë e Tiranës
- 3- Pas dhunës në demonstrata në Tiranë



Soros në Shqipëri: "Lidhja me PS në pushtet na prek besueshmërinë"

Misioni çerekshkullor i filantropistit me famë botërore, George Soros, në Shqipëri, është rrethuar gjithnjë me një mjegull misteri. Emri i miliardërit Soros, herë pas here, del nga nëndheu i politikës shqiptare, ndërsa teoritë konspirative dhe aludimet e artikuluara në adresë të tij, janë të pafundme. Ndërkaq, për herë të parë, Shqiptarja.com zbardh disa dokumente sekrete, të strukturave të 'perandorisë Soros', të cilat qartësojnë rolin e saj dhe politikën e ndjekura në Shqipëri. E-mail-et janë hakëruar nga një grup i panjohur, i cili fshihet nën emrin DC Leaks. Përmbaja e njerit prej e-mail-eve, zbardhur nga Shqiptarja.com, vizaton rolin real të George Soros në zhvillimet politike në Shqipëri, në rrugën e integritimit në Bashkimin Evropian si dhe pozicionin e organizatës në raport me kampet politike në Tiranë. Ndryshe nga perceptimet e krijuara, rezultoni se Shqipëria ka një peshe modeste në planet e Sorosit. Ndërkaq, organizata e Sorosit, Open Society Foundation (OSF) në Shqipëri pranon afrimin me Partinë Socialiste, ndërsa tregon momente kyçe të ndërhyrjes në zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Shqipëri.

SHQIPËRIA

Në publikimet e "Soros Leaks", të bëra nga një subjekt i panjohur DC Leaks, pak kohë më parë, del qartë në pah interesimi që Shqipëria të vijojë rrugën e saj drejt integritimit evropian, në të cilën

Zbardhen e-maili i hakëruar i Sorosit, pasqyrohet lobimi i fortë i OSF për integrimin e Shqipërisë në BE

njerëzit e Sorosit do të japin kontributin e tyre, duke ndikuar mbi politikëbërësit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropë, që ajo të pranohet në BE. Por, njerëzit e Sorosit, duket se e shohin si kundërproduktiv faktin që sa vjen e më shumë organizata e manjatit me origjinë hungareze po afrohet me pozitën e Partisë Socialiste, por kjo shihet se nuk është një defekt i Open Society Foundation, por rezultat i një qëndrimi tradicionalisht të ftohtë nga ana e Partisë Demokratike. "OSF ka qenë shpesh në anën e opozitës...OSF u lidh me Partinë Socialiste, çka dëmtoi besueshmërinë tonë si në Tiranë, ashtu edhe në Bruksel", shkruhet në një nga raportimet e hakëruara.

RAPORTET ME PS DHE PD

Në morinë e e-maileve të publikuara nga DC Leaks, një prej tyre është mjaft interesant. Në një mesazh të muajit maj të vitit 2014, një nga degët e organizatës sorosiane, OSEPI, që merret me politikën evropiane, i kushton një analizë të shkurtër situatës politike në Shqipëri, por jo shumë në këndvështrimin e brendshëm, por më tepër në atë të ecurisë së integritimit evropian të vendit. Aty më shumë nga çdo gjë tjetër të bën përshtyp-

OPEN SOCIETY EUROPEAN POLICY INSTITUTE

LESSONS LEARNED FROM COLLABORATIVE ADVOCACY between OSEPI and foundations

1. Moldova, Ukraine and Georgia: anti-discrimination legislation
2. Moldova: repeal of a repressive anti-propaganda law
3. Armenia, Georgia, Moldova, Ukraine: EU Integration Index
4. Burma: rights as condition to lift sanctions
5. DR Congo: M23 crisis
6. DR Congo: presidential election
7. Italy: Roma and migrants
8. Hungary: rollback of democracy
9. Albania: exit from crisis, towards the EU
10. Uzbekistan: foreign policy

aware of how to access the EU, nor of what the EU could do to exert pressure on Hungary, so the two-way dialogue helped to build their knowledge of the EU and contacts with officials.

9. Goal: Albania moves beyond its political impasse and towards EU integration.

Why EU advocacy? For Albania to achieve a closer relationship with the EU and advance towards eventual membership, the European Commission has to recommend that the Council grants candidate status to the country. EU integration is a central goal of Albanian foreign policy under all governments.

Advocacy activities: OSF made consistent efforts to push US and European policy-makers to address the political crisis from 2009 to 2012 when the opposition Socialist Party of Edi Rama boycotted parliament. What was initially crisis advocacy became a more campaign as the political tensions continued throughout that period. OSF was most active at three points: in the aftermath of the 2009 elections, when the then opposition cried foul, boycotted parliament and staged a hunger strike; in 2011, after local elections and the disputed results in the municipality of Tirana; and after violence at a demonstration in 2012. Advocacy included meetings with the Commission and EU leaders, from the regular annual consultation cycle by the Commission to wider outreach in the European Parliament, member-states and NATO. OSF commissioned a report on Albania from the foreign policy think-tank, FRIDE, and one on elections from the European Stability Initiative. There was also a (failed) effort to construct a contact group of well-known people to advocate for Albania. Those involved in the advocacy included OSF-DC, OSEPI, George Soros and Ivan Krastev.

Outcome: The eventual election and current period of relative stability resulted from multi-level approaches by many OSF actors. Albania is now on track for the Council to approve candidate status in June 2014.

Lessons learned: There was a core group of senior advocates with high-level access, mobilized at the right time to have an impact. OSF was often on the side of the opposition. While that was the right place to be from a rights and democratic standpoint, OSF became associated with the Socialist Party, which undermined our credibility both in Tirana and Brussels. In the end, however, the consistency of our position and events on the ground (improved communications coming out of the Socialist Party and continued bad behavior by the Democrats) helped swing policy around.

Lidhja me PS

"OSF ka qenë shpesh në anën e opozitës. Ndërkohë që ky ishte një pozicion i duhur nga pikëpamja e të drejtave dhe demokracisë, OSF u lidh me Partinë Socialiste, çka dëmtoi besueshmërinë tonë si në Tiranë, ashtu edhe në Bruksel".

je se përshkruhet raporti i vetë organizatës sorosiane me dy partitë kryesore në vend: Partinë Socialiste dhe Partinë Demokratike. "Open Society Foundation ka qenë shpesh në anën e opozitës. Ndërkohë që ky ishte një pozicion i duhur nga pikëpamja e të drejtave dhe demokracisë, OSF u lidh me Partinë Socialiste, çka dëmtoi besueshmërinë tonë si në Tiranë, ashtu edhe në Bruksel", raporton Instituti i Sorosit për qendrën, në 2014 kur ndërkohë PS ishte në pushtet. Kjo duket si një autokritikë e njerëzve të Sorosit, por ata gjithsesi kanë edhe justifikim për një situatë të tillë. "Në fund të fundit, megjithatë, qëndrueshmëria e pozitave tona dhe zhvillimet në vend (përmirësimi i komunikimeve me Partinë Socialiste dhe vazhdimi i sjelljes së keqe nga demokratët) ndihmoi për të vënë politikën në lëvizje", raporton Instituti OSEPI.


LOBIMI PËR INTEGRIMIN NË BE

Në mesazhin e muajit maj të vitit 2014, OSEPI në analizën e gjendjes në Shqipëri dhe ecurisë së integritimit evropian të vendit, tregon haptazi qëllimet pozitive të organizatës së Sorosit ndaj vendit tonë. Qëllimi i shprehur haptazi për organizatën e Sorosit është "Shqipëria të lëvizë përtej qorrakut politik dhe drejt integritimit evropian". OSEPI konstaton se ky proces në fakt ka qenë në qendër të

vëmendjes dhe objektiv i të gjitha qeverive shqiptare. Për këtë, Open Society Foundation raportohet të ketë bërë disa veprime konkrete për të ndikuar pozitivisht në proces. Citojmë: "OSF ka bërë përpjekje të rëndësishme për të shtyrë politikëbërësit e BE dhe SHBA për të zgjidhur krizën politike nga viti 2009 deri në vitin 2012, kur Partia Socialiste e Edi Ramës bojkotonte Parlamentin. Kjo, në fillim, ishte një mbështetje për zgjidhjen e krizës, por më pas kaloi në një fushatë më të gjerë nga ana e Sorosit, ndërkohë që tensionet politike vijuan përgjatë periudhës në fjalë. Kështu, Open Society Foundation u tregua aktive në tre raste, sipas e-mailit: Pas zgjedhjeve të vitit 2009, kur opozita e atëhershme i cilësoi ato të pavlefshme, bojkotoi Parlamentin dhe nisi një grevë urie; Në vitin 2011, pas zgjedhjeve lokale dhe rezultateve të diskutueshme në Bashkinë e Tiranës dhe pas dhunës në demonstrata në Tiranë.

PËRFSHIRJA PERSONALE E SOROS

Sipas e-mailit, mbështetja përfshiu takime me Komisionin Evropian dhe me liderë të Bashkimit Evropian dhe në NATO. OSF përgatiti një raport për Shqipërinë lidhur me politikën dhe një tjetër për zgjedhjet. Po kështu, ka patur një përpjekje që nuk rezultoi të suksesshme për të krijuar një grup personalitetesh të njohur që të mbështetnin përpjekjet e Shqipërisë, ku do të përfshiheshin, veç të tjerëve, vetë George Soros dhe studiuesi bullgar Ivan Krastev.



E-mailet, Shqipëria jashtë planeve të George Soros

Raportimet, filantropisti interes të pakët për vendin tonë

Roli i Shqipërisë

Referuar përmbajtjes së e-mailit për zhvillimet në Shqipëri, të publikuara nga DC Leaks, Shqipëria rezulton jashtë planeve të Soros. Nga qindra materiale të hakeruara, vetëm një numër i papërfillshëm flet për zhvillimet politike në Shqipëri.

Ndërhyrjet Sipas e-maileve, të cilat kanë rënë në duart e DC Leaks, angazhimi i Sorosit ka konsistuar në aktivizimin e qytetarëve për të penguar dhe zbuluar manipulimet në zgjedhje, në edukimin e votuesve dhe monitorimin e votave.

REAGIMI PAS SULMEVE

Zyra e Soros: Akuzat ndaj nesh nga qeveri të dështuara

Shtimi i sulmeve ndaj organizatave të lidhura me filantropin miliarder amerikan George Soros, ose të paktën të perceptuara si të financuara prej tij, kanë sjellë reagimin e institutit Open Society Foundations. Shefja e zyrës së komunikimit pranë këtij organizimi, Laura Silber i tha rrjetit investigativ "BIRN" se goditjet ndaj Soros, nga ata që i cilësoi si "qeveri joliberal", janë përpjekje për të devijuar vëmendjen nga dështimi për të zgjidhur problemet kyçe si papunësia, korrupsioni dhe perspektiva e dobët ekonomike. "Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në kërkesën e llogarisë ndaj qeverive dhe në forcimin e demokracisë. Ne jemi krenarë që mbështesim organizata që punojnë për të përmirësuar jetët e njerëzve", ishte komenti i saj. Emri i Sorosit është lakuar shpesh herë në Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Rumania e Serbi gjatë fushatave kundër organizatave të pavarura joqeveritare. Të tilla fushata përshkallëzohen rëndom në periudhat parazgjedhore. Në kohë të tilla, aktivistë e gazetarë janë gjendur jo pak herë përpara akuzave për mungesë patriotizmi. Pas përfundimit të zgjedhjeve të 11 dhjetorit në Maqedoni, Nikolla Gruevski u hodh në sulm kundër OJQ-ve të financuara nga jashtë dhe tha se partia e tij do të luftonte për ta larguar vendin nga influenca e Sorosit. Në janar erdhi deklarata e ministrit të Jashtëm, Nikolla Poposki, për një media italiane se aktivitetet e Sorosit në Maqedoni po shihen si të papranueshme. Disa zëra pro-qeveritarë kanë hequr paralele të ngjashme edhe në Rumania, duke i cilësuar liderët e protestave popullore të ditëve të fundit si "agjentë të Sorosit". Fushata të së njëjtës natyrë kundër OJQ-ve dhe medias kanë mbi një vit që organizohen edhe në Serbi, ku Soros përmendet jo rrallë herë si sponsori i atyre që "po destabilizojnë shtetin serb".

Ka një perceptim të fortë, sipas të cilit filantropisti me famë botërore, George Soros, lëviz flijet e padukshme të politikës shqiptare, duke diktuar kahet, ngjarjet dhe zhvillimet në Shqipëri. Ky perceptim u përforcua pas një vizite të George Soros në Tiranë, në 6 Dhjetor të 2014, ku zhvilloi takime me krerët e dy partive kryesore në Shqipëri. Por, rrjedhja e e-maileve të organizatës së Sorosit, një prej të cilëve i zbardhur nga Shqiptarja.com, tregojnë një tjetër realitet. Referuar përmbajtjes së e-mailit për zhvillimet në Shqipëri, të hakeruara nga DC Leaks, Shqipëria rezulton jashtë planeve të Soros. Nga qindra materiale të hakeruara, vetëm një numër i papërfillshëm flet për zhvillimet politike në Shqipëri. Referuar dokumenteve të duket që organizata e Sorosit nuk e ka pasur Shqipërinë në qendër të vëmendjes së aktivitetit të saj. Krahasuar me Wikileaks, që publikoi një numër shumë të lartë dokumentesh sekrete të ambasadave amerikane dërguar Departamentit në Uashington, "Soros Leaks" nuk ka treguar ndonjë rëndësi të veçantë për të zbuluar të fshehta të mëdha për vendin tonë. Soros ka treguar më shumë interes për Malin e Zi, Serbinë, Ukrainën, Kirgistanin etj. "Shoqëria e Hapur ka qenë e përfshirë në shumë transformime të mëdha në rajon, përfshirë Sllovakinë (1998-1999), Kroacinë (1999-2000), Serbinë (2000), Gjeorgjinë (2003-2004), Ukrainën (2004) dhe Kirgistan (2005). Edhe pse është e vështirë për të vlerësuar se sa vendimtar Shoqëria e Hapur ka qenë, ndihmesa e qeverive dhe organizatave perëndimore ishte një faktor domethënës në fuqizimin e aktorëve lokalë për të kontestuar zgjedhjet që janë manipuluar në masë të madhe kundër tyre. Lëvizjet sociale që mbanin axhendën demokratike në këtë periudhë janë zbehur në masë të madhe. Shoqëria e Hapur ka ndihmuar krijimin e një numri OJQ-sh që kanë shërbyer si aktorë kryesorë rreth zgjedhjeve në rajon, të tilla si GONG (Kroaci), CESID

HISTORIA

Si u vodh korrespondenca elektronike e George Soros

Në kulmin e fushatës për zgjedhjet presidenciale amerikane, vitin e kaluar, agjencia e lajmeve Bloomberg publikoi një lajm-bombë: Arkivat e Partisë Demokratike amerikane ishin hakuar. Më pas, vijuan akuzat se Moskë zyrtare kishte gisht në këto hakime, çka Rusia e ka mohuar deri tani. Por, ndër të tjera, kaloi pa bërë shumë bujë se edhe manjati amerikan me origjinë hungareze George Soros i ishin "vjedhur" mijëra e mijëra e-maile që gjenden në data bazën e organizatës së tij, të

Grupi i panjohur DC Leaks theu pengesat që ruanin korrespondencën e grupit të Sorosit

cilat janë dërguar në kanalet elektronike të komunikimit nga ana e raportuesve të tij në mbarë botën: Institute apo vëzhgues të politikës botërore. Një grup i panjohur, që fshihet nën emrin DC Leaks, ka arritur të thyjë këstu pengesat që ruajnë korrespondencën e grupit të Sorosit, duke bërë të mundur që një pjesë e tyre të mund të bëhen tanimë publike. Në e-mailet e hakuar del qartë interesimi i jashtëzakonshëm i organizatës së Sorosit, Open Society Foundation (OPF) dhe degëve të shumta të saj për zhvillimet

Overview of Open Society Engagement on Elections

Open Society's engagement with electoral processes began in **Central and Eastern Europe and the countries of the former Soviet Union**, where the Foundations nurtured a number of social movements that culminated in the ousting of authoritarian governments through elections. That support took several forms: developing a cadre of activists through long-standing backing of civil society organizations; providing money and expertise to emerging political movements; advocating on behalf of democratic activists with Western governments; and providing support to reformists who came to power after elections, usually in the form of capacity building grants.

Open Society was involved in many of the major transformations in this region, including Slovakia (1998-1999), Croatia (1999-2000), Serbia (2000), Georgia (2003-2004), Ukraine (2004) and Kyrgyzstan (2005). While it is not possible to gauge how decisive Open Society's role was, support from Western governments and organizations was a significant factor in empowering local actors to contest elections that were largely rigged against them. The social movements that carried the democratic agenda in this period have largely faded away.

Open Society also helped create a number of NGOs that have served as the primary domestic actors around elections in the region, such as GONG (Croatia), CESID (Serbia), MOST (Macedonia) and CEMI (Montenegro). These organizations have developed a palette of activities designed to activate citizens and to deter and detect manipulation. Their tools include reforming the electoral code; voter education, get out the vote and media monitoring in advance of elections; observation of polling stations and vote tabulation, exit polls and parallel vote tabulation on Election Day; and reporting and advocacy with international institutions after the fact, especially where controversy has arisen.

This approach tends to be more technical than "political," grounded in the integrity of the electoral process – with no interest in who wins – rather than being allied with a social movement whose tacit goal is the removal of an authoritarian government. NGOs working in this way have contributed to improved elections in some, but not all, the countries where they

(Serbi), MOST (Maqedoni) dhe CEMI (Mali i Zi) Këto organizata kanë zhvilluar një gamë aktivitetesh të dizajnuara për të aktivizuar qytetarët dhe për të penguar dhe zbuluar manipulimet", thuhet në dokumentin raportues.

MISIONI

Sipas e-maileve, të cilat kanë rënë në duart e DC Leaks, angazhimi i Sorosit ka konsistuar në aktivizimin e qytetarëve për të penguar dhe zbuluar manipulimet në zgjedhje. "Këto organizata kanë

zhvilluar një gamë aktivitetesh të dizajnuara për të aktivizuar qytetarët dhe për të penguar dhe zbuluar manipulimet. Mënyrat e tyre përfshinin reformimin e Kodit Zgjedhor; edukimin e votuesve, monitorimin e votave dhe të medias në prag të zgjedhjeve; vëzhgimin e vendvotimeve dhe nxjerrjen votave, sondazhe dhe nxjerrjen paralel të votave në ditën e zgjedhjeve; dhe raportimin dhe avokimi me institucionet ndërkombëtare pas faktit, sidomos aty ku ka pasur polemika", thuhet në dokumentin raportues.



Vjedhja Një grup i panjohur, që fshihet nën emrin DC Leaks, ka arritur të thyjë këstu pengesat që ruajnë korrespondencën e grupit të Sorosit, duke bërë të mundur që një pjesë e tyre të mund të bëhen tanimë publike.

politike në rajone të ndryshme të botës, duke filluar nga Afrika, por edhe në Evropën Lindore. Madje, nuk është fjala vetëm për interesim: OPF, siç dëshmohej nga korrespondenca dhe raportimet, ka vepruar aktivisht nëpër vite me lobime për të ushtruar ndikimin në zhvillimet e jetës politike në vende të caktuara, ku bën pjesë e Shqipëria.

KLD kërkon rikthimin e gjyqtarëve të pezulluar

KLD emëri jashtë kompetencave, Gjin Gjoni dhe Gerd Hoxha sulmojnë Reformën në Drejtësi

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

DEBATET

NE KLD PER PLOTESIMIN E VENDEVE VAKANTE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë kërkon rikthimin në gjyqësor të gjyqtarëve të akuzuar nga Prokuroria për korrupsionin, në kundërshtim me ligjin për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, ligji i cili ka kufizuar kompetencat e KLD, deri në shkrirjen e këtij institucioni, që do të përkon me ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në mbledhjen e datës 20 Janar, kreu i ri i Unionit të Gjyqtarëve, Gerd Hoxha, njëherësh anëtar i KLD, i ka kërkuar kryetarit Bujar Nishani rikthimin në detyrë të gjyqtarëve të Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë, zonjës Marsela Balili. Kjo e fundit është pezulluar nga detyra në 2 Dhjetor të vitit 2009. Në të njëjtën kohë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë miratoi kërkesën e prokurorisë për ta ndjekur penalisht gjyqtarë, me akuzën e korrupsionit. Në tetor të 2013, bashkëshorti i saj prokuror u dënua me 1 vit burg, me akuzën se tentoi të ndërhynte te bashkëshortja për t'i ulur dënimin një të akuzuari për trafik droge. Zonja Marsela Balili ka fituar pafajësinë në Gjykatën e Lartë, por KLD-së i është hequr me ligj kompetenca e emërimeve në gjyqësor, përpos magistratëve të diplomuar në vitin 2016. "Unë doja të sillja në vëmendjen tuaj rastin e një gjyqtareje, të cilës i ka përfunduar procedimi penal, madje edhe në Gjykatë të Lartë. Është rasti i gjyqtarëve të Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë, zonjës Marsela Balili. Ne e kemi diskutuar disa mbledhje më përpara. Kemi marrë informacion se çfarë është bërë me të. Ka përfunduar gjykimi edhe në Gjykatë të Lartë. Çmuj se ne jemi brenda të gjithë kompetencave tona për ta rikthyer në detyrë këtë zonjë të nderuar", ka propozuar Gerd Hoxha. Ndërkaq, Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, njëherësh kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërko



-Petrit Çomo: Ndoshta s'po kuptohet. Vendet vakante, me ligjin e ri, dhe emërimi si "Magjistrat" janë gjëra të ndryshme.

-Bujar Nishani: Vetëm një gjë z. ministër. Këshilli Ka të drejtën e emërimit të magistratëve për ato vakanca që ekzistojnë. Jo të shpallen të tjera. Në qoftë se është kjo logjikë që mbron dikush... Prandaj, unë them, të ecim me shpalljen e vendeve për 8 (tetë) magistratët dhe ndjekim pastaj hapat e tjera që përcakton ligji dhe dispozita tranzitore.

-Ylli Manjani: Edhe një pyetje kam, meqenëse, duhet të ballafaqojmë idetë me thënë të drejtën. Situata është realisht delikate. Në kuptimin që, nuk e dimë cili është ligji. Nuk e dimë. E them me përgjegjësi këtë. Nuk e dimë se kush është ligji që zbatohet. Në qoftë se e vlerësojmë në tërësi, por edhe nën për nen edhe në frymë edhe në gërmë, unë sot nuk e di se çfarë vendimi duhet të marr dhe në bazë të kujt ligji.

-Sokol Çomo: Nuk të bën më përfundimi i Shkollës së Magistraturës magistrat, ligji parashikon që përfundimi i Shkollës së Magistraturës të bën kandidat për magistrat dhe është vetëm për rastin konkret, 2016-ën, KLD-ja aktuale që do të vendosë nëse këto kandidatë që kanë mbaruar shkollën në 2016-ën do ta marrin ose jo titullin "Magjistrat" dhe pastaj KLGJ-ja në të ardhmen. Dhe përsëri, ligji i statusit, siç e kam kuptuar unë, më është dukur i qartë kur thotë, tre janë kriteret që ata që kanë përfunduar Shkollën e Magistraturës, të marrin titullin "Magjistrat": së pari, të kenë marrë jo më pak se 70% të pikëve maksimale në dy vitet e para teorike; kriteri i dytë, të paktën të kenë dalë mirë në vitin e tretë që konsiderohet si praktika e magistratëve dhe; kriteri i tretë, të mos kenë probleme me pasurinë dhe me integritetin dhe me figurën. Dhe vetëm pasi KLD-ja aktuale ose Këshilli Gjyqësor në të ardhmen, do të verifikojnë plotësimin e këtyre tre kriterëve, do të kalojnë në atë që quhet hapi i parë dhe që ligji në dispozitat tranzitore thotë që ne duhet ta bëjmë brenda 2 muajve, emërimin "Magjistrat".

-Ylli Manjani: Unë do ta ftoj Këshillin e Lartë të Drejtësisë që ta shohin këtë çështje me një arsytim kumulativ. Sepse një interpretim strikt i ligjit të ri, pa dyshim që e nxjerr totalisht jashtë juridiksionit Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Kjo është e padiskutueshme.

-Gjin Gjoni: Z. President! Unë i dëgjova me shumë vëmendje të gjitha diskutimet që janë bërë deri në momentin aktual. Të them të drejtën, bashkohem me qëndrimin tuaj zoti President dhe me qëndrimin e ministrit të Drejtësisë që, legjislacioni i cili është aktualisht në tavolinën tonë duke filluar që nga Kushtetuta, që nga legjislacioni në lidhje me Vetingun, që nga statusi i magistratit, ka përplasje dhe kontradikta në lidhje me njëri tjetrin. Unë qofsha i gabuar, zakonisht nuk mbahem për pesimist, por shoh që do ketë një përplasje të kompetencave dhe institucioneve derisa ata të fillojnë të futen në shtratin e tyre. Unë kam përshtypjen që do ketë jashtëzakonisht shumë përplasje, sepse e shoh.

-Gerd Hoxha: Gjithë ky diskutim që po bëjmë tani dhe gjithë ky diskutim që po bëhet jo vetëm në Këshill por edhe në rrethet e tjera të juristëve, nxjerr në pah një gjë, që kjo reformë ka shkaktuar një kaos dhe unë bashkohem edhe me disa parafolës këtu, ka shkaktuar një kaos në mënyrën sesi po funksionon sot sistemi i drejtësisë. Kjo ka qenë edhe arsyeja që edhe gjyqtarët në disa raste apo persona të tjerë janë angazhuar dhe kanë kërkuar të rregullohen këto. S'janë kundër reformës por kanë kërkuar që reforma të bëhet ashtu siç duhet. Unë gjej rastin që nga kjo tryezë shumë e nderuar, bëj thirrje që ata njerëz që ndihen përgjegjës, të fillojnë t'i vejnë gishtin kokës, të paktën kur të bëjnë aktet e tjera ligjore apo ligjet e tjera për reformën, të dëgjojnë më shumë zërin e gjyqtarëve, në mënyrë që të mos na sjellin në këtë pikë, ku nuk dimë se çfarë duhet të bëjmë, ku një dispozitë kundërshton dispozitën tjetër.



kohë për t'u shprehur mbi kërkesën e anëtarit Hoxha. "Ta shoh praktikën. Ta konsultoj me Drejtorinë Juridike. Në mbledhjen e ardhshme pastaj e vendosim e fusim apo jo", është shprehur Nishani.

DEBATET PËR VENDET VAKANTE

Gjatë mbledhjes së KLD ka pasur debate të forta edhe mbi procedurën e dhënies së titullit "magjistrat" të disa kandidatëve që kanë

përfunduar Shkollën e Magistraturës si dhe për plotësimin e 8 vendeve vakante me magistratët që do të marrin titullin. Anëtarët e KLD e kanë interpretuar në mënyra të

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË
Bulevardi "Zogu I", Tiranë Tel: +3554 2259817, Fax: +3554 2259822 www.kld.al

Nr. _____ Prot. Tiranë, më _____ 2017

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 20.01.2017)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Mbi emërimin e kandidatëve për magistratë të diplomuar në formimin fillestar në vitin 2016 (që kanë ndjekur studimet në formimin fillestar (profilin gjyqtar) në Shkollën e Magistraturës, gjatë periudhës tetor 2013-qershor 2016).

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 12:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Bujar Nishani	(kryetar)
2. Ylli Manjani	(anëtar)
3. Xhezar Zaganjori	(anëtar)
4. Artan Broci	(anëtar)
5. Astrit Haxhialushi	(anëtar)
6. Gjin Gjoni	(anëtar)

KËRKESA

Këshilli i Lartë i Drejtësisë kërkon rikthimin në gjyqësor të gjyqtarëve të akuzuar nga Prokuroria për korrupsionin, në kundërshtim flagrant me ligjin për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve.

GERD HOXHA

"Çmuj se ne jemi brenda të gjithë kompetencave tona për ta rikthyer në detyrë këtë zonjë të nderuar, e cila ka kaq kohë që është pa punë. Është një familjare me dy fëmijë. Dhe besoj se edhe ligji i ri ne nuk na ndalon".

Vetingu

Mit'hat Hvari denoncon gjyqtarin Gjylbegaj: I ka shërbyer diktaturës



sh-drejtori i Policisë së Tiranës, Mit'hat Hvari ka denoncuar gjyqtarin Artan Gjylbegaj, i cili ka aplikuar për në komisionet e Vetingut, se vjen nga diktatura komuniste. "Dua të bëj publike një rast skandaloz që lidhet me emrat e një liste që ka nxjerrë Avokati i Popullit, të cilët janë kandidatë të Vetingut. Ai është Artan Gjylbegu ish-gjykatës ushtarak i diktaturës komuniste. Artan Gjylbegu ka qenë një gjykatës ekstremist i ish-regjimit komunist që me dorën e tij të rëndë ka dënua dhjetëra djem të rinj që morën pjesë në demonstratën e 14 dhjetorit 1990 në Elbasan", shkruan në Facebook, Hvari. Ai tregon dhe historinë e tij personale sesi është dënua me 16 vite burg nga ky gjyqtar për shkak të bindjeve të tij politike. "Unë Mit'hat Hvari isha viktimë e këtij gjykatësi ekstremist, i cili më dënoi me detyrë të mbyllura 16 vjet burg pa prova ligjore, thjesht politikisht, pasi unë isha kundërshtar i regjimit të tij diktatorial", shkruan Hvari.

ndryshme ligjin e ri. Madje, ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, është shprehur se nuk ishte i qartë se çfarë vendimi duhet të merrte KLD në këtë situatë. Ndërkaq, anëtar i KLD Çomo i ka propozuar që fillimisht t'u jepej titulli "magjistrat" kandidatëve

dhe më pas të procedohej me plotësimin e vendeve vakante. Por, anëtarët u ndanë edhe sa i takon procedurës së plotësimit të vendeve vakante. Ndërkaq, Gjin Gjoni dhe Gerd Hoxha ka shpërthyer ndaj njerëzve që kanë hartuar dhe miratuar reformën në drejtësi.

Thirrret sërish Shkëlzen Berisha, gati dy dosje penale

Strategjia e komisionit hetimor për të marrë dëshmitë e Shkëlzenit dhe sekserit Nuel Kalaj

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Djali i ish-kryeministrit Sali Berisha, Shkëlzen Berisha, me vullnet të lirë apo me forcën e policisë, do të paraqitet për herë të tretë para komisionit parlamentar hetimor, për të dëshmuar rreth rolit të tij (nëse ka) në procesin korruptiv të privatizimit të OSSH, në sagën e favorizimeve të CEZ si dhe për raportet e pretenduara me sekserin Nuel Kalaj. Pas dy seancave të dështuara, ku Shkëlzen Berisha refuzoi të betohej se do të thoshte të vërtetën për çështjen 'CEZ', me argumentin se kryetari ishte në konflikt interesi, komisioni hetimor ka vendosur ta thërrasë sërish. Anëtarë të këtij komisioni thanë për Shqiptarja.com se, në shkresën e tretë, Shkëlzen Berisha paralajmërohet për detyrimin ligjor për t'u paraqitur para komisionit si dhe për mundësinë e vënies në lëvizje të organeve të policisë në rast refuzimi. Në seancën e radhës pritet të ezaurohet edhe pretendimi i djalit të ish-kryeministrit, i cili për të shmangur dëshminë, paraqiti një kërkesë për përjashtimin e kryetarit të komisionit Taulant Balla nga kryesimi i seancës dhe nga pyetja e dëshmitarit. Referuar praktikës dhe precedentëve, komisioni e ka hedhur poshtë kërkesën.

DY DOSJE PËR SHKËLZENIN

Burime pranë komisionit thanë për Shqiptarja.com se, nëse Shkëlzen Berisha do të refuzojë të betohet edhe pas rrëzimit të kërkesës për përjashtimin e Taulant Ballës, komisioni hetimor do ta kallëzojë penalisht atë në Prokurori, për refuzim për të dëshmuar. Pra, seanca e radhës, e cila do të mbahet gjatë javës që vjen, do të jetë përcaktuese për vendimmarrjen e komisionit në raport me përgjegjësinë penale të dëshmitarit Berisha. Ndërkaq, pavarësisht vullnetit për të dëshmuar apo refuzuar, Shkëlzen Berisha, do të jetë pjesë e dosjes me konkluzionet e hetimit, e cila do të referohet në Prokurori, mbështetur në e-mailin e ish-drejtorit të CEZ në Shqipëri, Josef Hejsek, drejtuar nëndrejtorit të CEZ-it në Pragë, Tomas Pleskac, ku implikon djalin e ish-kryeministrit në privatizimin e OSSH.

STRATEGJIA E KOMISIONIT

Anëtarë i komisionit hetimor, Ervin Koçi, tha dje për Shqiptarja.com se pavarësisht kallëzimit të penal për refuzim për të dëshmuar, komisioni do të vijojë të thërrasë Shkëlzen Berishën dhe Nuel Kalajn për të dëshmuar. Në varësi të zhvillimeve në se-



Nuel Kalaj

Rënia e alibisë

Në seancën e tretë pritet të ezaurohet edhe pretendimi i fundit i djalit të ish-kryeministrit, i cili për të shmangur dëshminë, paraqiti një kërkesë për përjashtimin e kryetarit të komisionit, Taulant Balla.

Kallëzimi

Nëse Shkëlzen Berisha do të refuzojë të betohet edhe pas rrëzimit të kërkesës për përjashtimin e Ballës, komisioni hetimor do ta kallëzojë penalisht atë, për refuzim për të dëshmuar

Kërkesa e Shkëlzen Berishës

-Kërkues: Shkëlzen Berisha, i biri i Saliut dhe i Lirisë, i datëlindjes 27.02.1979, lindur dhe banues në Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, banues në Vila B9 Lundër Tiranë.

-Objekti i kërkesës: 1. Përjashtimi i z. Taulant Balla nga kryesimi dhe pjesëmarrja në seancën e pyetjes së kërkuesit në Komisionin e Hetimit Parlamentar në lidhje me hetimin e kompanisë CEZ. Pezullimin e tij deri në shqyrtimin e kërkesës për përjashtim.

Kryetari i Komisionit të Hetimit Parlamentar ku unë jam thirrur për të dëshmuar ka qenë i paditur nga unë në një çështje civile me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror të shkaktuar nga ai ndaj meje si dhe detyrimin e tij që të përgënjestrojë deklaratat e rreme publike. Kjo padi është pranuar nga gjykatat e të gjitha shkallëve dhe ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 1419, date 09.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ky fakt dëshmon se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie nga ana e Kryetarit të Komisionit. Po kështu Z. Taulant Balla ka paragjykuar përfundimin e hetimeve të komisionit duke përdorur terma ofendues dhe shtipje ndaj personit tim.

ancën e ardhshme, Shkëlzen Berisha pritet të kallëzohet penalisht në prokurori për refuzim për të dëshmuar, parashikuar në 307 të Kodit

Penal, ndërsa Nuel Kalaj për refuzim të dëshmitarit për t'u paraqitur, parashikuar në nenin 310 të Kodit Penal. Në të njëjtën kohë, komisioni

hetimor, në bazë të planit të hetimeve, po përgatit raportin me gjetjet dhe provat e deritanishme, raport i cili do t'i paraqitet Kuvendit për miratim, në përfundim të hetimeve. Në raport do të përfshihen edhe të dhënat për ekzistencën e veprave penale si dhe personat e implikuar, për t'u referua më pas në organin e akuzës.

PROVA KRYESORE

Komisioni hetimor ka administruar një e-mail të ish-drejtorit të CEZ në Shqipëri, Josef Hejsek, i cili i shkruante nëndrejtorit të CEZ-it në Pragë, Tomas Pleskac, rreth një takimi të planifikuar me ish-kryeministrit Berisha dhe të birin e tij, Shkëlzen Berishën, me ndërmjetësimin e Nuel Kalajt. Kjo është një ndër provat



Shkëlzen Berisha

LEGJSLACIONI, DETYRIMET PËR TË DËSHMUAR DHE PASOJAT

NENI 16, LIGJI PËR KOMISIONET HETIMORE

Thirrja për të dëshmuar

1. Komisioni thërret dëshmitarë për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 360, Kodi i Procedurës Penale

Sekretari lexon deklaratën e betimit të dëshmitarit: "Betohej se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë". Pas kësaj dëshmitari deklaron: "Betohej" dhe tregon gjeneralitetet e tij.

Mosrespektimi i dispozitave të paragrafëve 2 dhe 3 sjell pavlefshmërinë e veprimit të kryer.

NENI 306 I KODIT PENAL

Dëshmia e rreme

Dëshmia e rreme e bërë përpara gjykatës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

NENI 307, KODI PENAL

Refuzimi për të dëshmuar

-Refuzimi për t'u përgjigjur pyetjeve rreth dijenisë për kryerjen e një veprë penale apo të autorit të saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

-Kur refuzimi për të dëshmuar bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

-Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale ose nga dikush, që duhet të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'u përgjigjur pyetjeve.

NENI 310, KODI PENAL

Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit

Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit, pa shkaqe të arsyeshme ose mospranimi prej tyre për të kryer detyrat e caktuara nga organi i ndjekjes penale ose gjykata, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

kryesore që implikon Shkëlzen Berishën në këtë histori. Publikisht, Shkëlzen Berisha ka deklaruar se ky takim nuk është zhvilluar kurrë. Po ashtu, Shkëlzeni ka hedhur dyshime se ky e-mail mund të jetë manipuluar. Por, juristi i OSSH, Romeo Kara ka hed-

hur poshtë çdo dyshim, duke deklaruar se mban përgjegjësi për vërtetësinë e e-mailit. Për të konfirmuar e-mailin, komisioni, me anë të Ministrisë së Drejtësisë, ka nisur procedurat për të marrë dëshminë e ish-drejtorit të CEZ në Shqipëri, Josef Hejsek.

STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 3 PËR:

Njësi, me sipërfaqe 59.4 m², Zona Kadastrale: 1819, Numri i Pasurisë: 61/172-N7, Vol. 2, Faqe 7 e regjistruar ne Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës me vendodhje Lagjia Gostil Kukës, vlerësohet me vlerën e **950 651.85 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e pesë) Lekë.**

Njësi, me sipërfaqe 51.87 m², Zona Kadastrale: 1819, Numri i Pasurisë: 61/177-N3, Vol. 2, Faqe 9 e regjistruar ne Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës me vendodhje Lagjia Gostil Kukës, vlerësohet me vlerën e **860 113.8 (tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e trembëdhjetë pikë tetë) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **01.03.2017, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" sh.p.k., me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla.1, Kati, 2. Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni
Cel. 0693041355, eMail: speed.solution@yahoo.com

Meta flet për papagallët: LSI nuk e ka frikë reformën në drejtësi

Thumbimi për qeverinë: Mos jepni me koncesionin dinjitetin e të rinjve

ESIONA KONOMI
TIRANE

Ilir Meta ka ashpërsuar dje gjuhën ndaj atyre që sulmojnë LSI-në dhe e akuzojnë atë si bllokues të reformës në drejtësi. Kreu i Kuvendit ka kaluar në sulm me disa njerëz që ai nuk i identifikoi, por i quajti sharlatanë dhe papagallë nëpër hapësirat televizive dhe ju kujtoi se ata nuk do të kalonin dot vettingun nëse do t'i nënshtroheshin. Në fjalën përshëndetëse të mbajtur në Konventën e Tiranë, Kryetari i LSI-së tha se partia e tij nuk e ka frikë reformën në drejtësi. "Të gjithë ata që me keqardhje do t'i quaja sharlatanë apo papagallë që përsërisin nëpër ekrane kanë një vit e gjysmë, që LSI ka frikë nga reforma, që LSI nuk e do reformën e ku di unë. Thonë të gjithë të njëjtën fjalë, të njëjtin mesazh, ndërkohë që qëndrimi i LSI-së ka qenë mjaft parimor, mjaft publik dhe vendimtar për suksesin e reformës të paktën deri tani. Të gjithë këta po t'u bësh vettingun do të dalin shumë keq me këtë dhe asnjë nuk do ta kalojë vettingun", - deklaroi ndër të tjera Ilir Meta. Ai shtoi se LSI ka qenë dhe do të jetë garante e zbatimit të kësaj reforme. "LSI ka qenë më e qartë se askush tjetër për reformën në drejtësi në Shqipëri dhe për domosdoshmërinë e realizimit të saj. Dhe nëse do të ishin dëgjuar qëndrimet dhe vlerësimet publike të LSI-së, reforma do të kishte filluar zbatimin me kohë dhe vendi nuk do të kishte harxhuar aq shumë energji me retorika të padobishme. LSI theksoi që në fillim se nuk kishte asnjë interes për të mbrojtur sistemin e degraduar të drejtësisë herë nga drejtësia edhe nga politika në këto 20 vjet por njëkohësisht deklaroi se nuk kishte asnjë interes për të kapur sistemin e ri të drejtësisë", - vijoi Kryetarin i LSI-së. Në thumbim me koncesionet e shumta që janë dhënë nga qeveria "Rama", Meta tha se askujt nuk duhet t'i shkojë mendja që të japë me koncesion dinjitetin e Shqipërisë dhe dinjitetin e të rinjve dhe të rejave të Shqipërisë. "Nëse ka diçka që kurrë askujt nuk



Kryetari i LSI-së, Ilir Meta

duhet t'i shkojë mendja që të japë me koncesion, është dinjiteti i Shqipërisë dhe dinjiteti i të rinjve dhe të rejave të Shqipërisë. Sepse ata nuk kanë asnjë kompleks nga e kaluara e tyre, sepse ata janë të pashantazhueshëm nga kushdo, sepse ata sot nuk kanë vetëm dëshirën, nuk kanë vetëm pasionin, por kanë vetëm eksperiencën dhe aftësinë për t'i dalë zot vendit të tyre", - tha Meta. Për herë të parë, Meta ka mbajtur dhe një qëndrim të ngjashëm me të opozitës, ku thotë se zgjedhjet e ardhshme janë kusht për marrjen e statusit kandidat. "Sepse rezultati i zgjedhjeve lidhur me standardin e tyre në 18 qershor është vendimtar për hapjen ose jo të negociatave të Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Standardi i zgjedhjeve të 18 qershorit është një standard i panegociueshëm për të ardhmen e Shqipërisë në

duhet t'i shkojë mendja që të japë me koncesion, është dinjiteti i Shqipërisë dhe dinjiteti i të rinjve dhe të rejave të Shqipërisë. Sepse ata nuk kanë asnjë kompleks nga e kaluara e tyre, sepse ata janë të pashantazhueshëm nga kushdo, sepse ata sot nuk kanë vetëm dëshirën, nuk kanë vetëm pasionin, por kanë vetëm eksperiencën dhe aftësinë për t'i dalë zot vendit të tyre", - tha Meta. Për herë të parë, Meta ka mbajtur dhe një qëndrim të ngjashëm me të opozitës, ku thotë se zgjedhjet e ardhshme janë kusht për marrjen e statusit kandidat. "Sepse rezultati i zgjedhjeve lidhur me standardin e tyre në 18 qershor është vendimtar për hapjen ose jo të negociatave të Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Standardi i zgjedhjeve të 18 qershorit është një standard i panegociueshëm për të ardhmen e Shqipërisë në

▼ Mesazhi

"Besoj se jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se duke qenë të ndarë dhe përjashtues me njëri-tjetrin bëhemi edhe më të vegjël edhe më të parëndësishëm dhe më të bezdisshëm, jo vetëm për vetën tonë, por edhe për partnerët tanë që duam që të na mbështesin".

▼ Koncesioni

"Nëse ka diçka që kurrë askujt nuk duhet t'i shkojë mendja që të japë me koncesion, është dinjiteti i Shqipërisë dhe dinjiteti i të rinjve dhe të rejave të Shqipërisë. Sepse ata nuk kanë asnjë kompleks nga e kaluara e tyre".

Deputetja e LSI

Kryemadhi: Pranojmë faj për gabimet në qeveri, të tjerët jo

Deputetja e LSI-së, Monika Kryemadhi, përcolli mesazhe të forta për politikën nga Konventa e LSI-së për Tiranën. Ajo deklaroi se LSI ka sukseset e saj në qeverisjen e vendit, sikurse ka edhe fajet e saj në dështimet e qeverisë. Por Kryemadhi kujtoi se ndryshe nga forcat e tjera politike, LSI ka kurajo të kërkojë falje për gabimet. "Kemi edhe ne fajet tona, gabimet tona, e s'është turp të thuhet më fal për gabimet, se të thuash më fal është njerëzore. Një njeri që pranon gabimet, nuk i përsërit më ato, por një njeri që nuk pranon gabimet, do gabojë përsëri", -u shpreh Kryemadhi. Ajo deklaroi se LSI ka besim të plotë te lidhshmëria e saj, Ilir Meta. "Ne jemi me Ilir Metën deri në momentin që ai do të luftojë për shqiptarët për t'u rikthyer shpresën shqiptarëve, derisa ai të luftojë për sovranitetin tonë. Ne kemi dinjitetin tonë, integritetin tonë", -tha bashkëshortja e Ilir

Metës. Kryemadhi sqaroi edhe vendimin e LSI-së në 2009-ën. Sipas Kryemadhit, nëse katër mandatet e LSI nuk do kishin shkuar për formimin e qeverisë, shqiptarët do ishin dhe sot me regjim vizash në BE. "Në vitin 2009-ë ne bëmë koalicionin me PD-në. Nëse LSI s'do jepte 4 mandatet e saj, shqiptarët sot do ishin viktimë të trafikut të vizave, do vazhdonin të ishin në radhë të gjata në dyert e ambasadave, sot shqiptarët do ishin më të izoluar se kanë qenë. Kush e ka harruar, duhet t'ia kujtojë. Edhe sot

LSI mban një nga postet ndoshta jo të pushtetshme, pa polici, pa tenderë si Ministria e Integritetit, është një ministri që në dukje për njerëzit është burokratike, por është shumë e rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë. Përballet çdo ditë me vështirësitë, korrupsionin, pabesitë, paaftësinë e administratës tonë, e cila çdo ditë këtë zullum duhet ta mbulojmë, ta pastrojmë", -tha Kryemadhi. Ajo shtoi se vendi duhet të ecë në rrugën e integritetit evropian. "Që të ecësh në këtë rrugë duhen kryer disa procese që nga opozita e anëtarët e tjerë të koalicionit. Mos harroni që LSI është e vetmja alternativë që kanë sot shqiptarët. E them këtë, pse, sepse është e vetmja parti që s'ka asnjë lloj kompleksi në të gjitha gjërat e saj, ka koka të saj të funksionimit, respekton ligjin dhe zotën në qiell, janë dy gjëra shumë të rëndësishme, dy kode të pacenueshme, të cilat këtë e bëjnë që LSI të rritet çdo ditë e më shumë", -tha Kryemadhi.



Monika Kryemadhi

BE ndaj duhet të kujdesemi më shumë sot për rezultatin që zgjedhjet e vendit tonë do të marrin më 18 qershor. Sepse rezultati i 18 qershorit është shumë i rëndësishëm për legjitimitetin e të gjithë

institucioneve ligjvënese dhe qeverisë në Shqipëri pas 18 qershorit. Sepse standar-

di i këtyre zgjedhjeve është shumë i rëndësishëm për të ecur në zbatimin me sukses dhe besueshmëri të reformës në drejtësi që është mjaft jetike për Shqipërinë e dekadave që vijnë", - deklaroi



Konventa e LSI-së

→ REFLEKTIMI

"Shqipëria është europiane, shqiptarët janë evropianë, por kemi nevojë për një politikë jo arrogante, politikë moderne dhe evropiane. LSI është një forcë që kujdeset për njerëzit, i do dhe i mban afër ata."

Kryetari i LSI-së. Në përpjekje për të bërë balancimin dhe për të mbajtur përgjegjësitë e saj, Meta tha se partia e tij mban përgjegjësi për gabimet dhe është e gatshme të reflektojë. "Ne nuk jemi një forcë e pagabueshme, ne nuk jemi një forcë e pakritikueshme, përkundrazi, por fuqia jonë është tek aftësia për të reflektuar, për të ndryshuar dhe për tu përmirësuar duke i dëgjuar njerëzit dhe duke qenë gjithnjë pranë tyre dhe shqetësimeve që ata kanë për të sotmen dhe të nesërmen e tyre dhe të fëmijëve të tyre. Dhe do të vazhdojmë në këtë mënyrë edhe në të ardhmen. Fuqia jonë vjen nga dashuria për vendin dhe nga besimi ynë, që ky vend do të bëhet, në radhë të parë, nga shqiptarët dhe nga të rinjtë dhe të rejat tona. Individualizmi, egoizmi dhe cinizmi janë disa nga sëmundjet më të rrezikshme të politikës sonë, të cilat sjellin edhe arrogancën, edhe përjashtimin, edhe konfliktin dhe këtyre do t'i kundërvihemi, duke zgjeruar dhe fuqizuar solidaritetin përfshirjen dhe frymën e bashkëpunimit me njëri-tjetrin, por edhe më gjithë të tjerët", -tha Meta.



NENKRYETARI

Luan Rama: Rinia shqiptare nuk meriton të quhet e kanabizuar

Në konventën e LSI-së ka pasur edhe kritika ndaj qeverisë "Rama". Nënkrjetarët të LSI-së, Luan Rama ka pakënaqësi nga puna e ekzekutivit sa i takon çështjes së kanabisit. Teksa ka falënderuar rininë në sallë për praninë e saj në Konventën e LSI në Tiranë që po mbahet në Pallatin e Kongreseve, Rama theksoi se "të rinjtë nuk meritojnë të jenë pjesë e një vendi të kanabizuar". Kryetari i grupit parlamentar të LSI, Luan Rama u shpreh pa LSI-në politika shqiptare do të ecte kuturu. Rama foli për të rinjtë dhe rolin e tyre në shoqëri, ndërsa ceku edhe probleme si kultivimi i kanabisit dhe krimi i organizuar, të cilat sipas tij prekin rininë shqiptare. "Ju nuk e meritoni të quheni rinia e një vendi të kanabizuar. Ju nuk e meritoni të quheni rinia e një vendi të kriminalizuar. Një pjesë e politikës guxoi ta fuste krimin edhe brenda radhëve të saj. Motoja jonë për dekriminalizimin e politikës duhet kthyer në moto për dekriminalizimin e të gjithë shoqërisë shqiptare. Ne jemi në mbështetje të policisë, mjekëve, gjykatësve dhe prokurorëve, për të mos lejuar askënd që të ngrejë dorën mbi ta", tha Luan Rama.

QËNDRIMET



Shezai Rrokaj:

"LSI i është përgjigjur konfliktualitetit me pozitivitet dhe konstruktivitet. Qytetarët nuk kanë nevojë për politike tensionuese që mbjell ankth. Qytetarët kanë nevojë për shpresë, kjo shpresë në Shqipëri ka një garant që quhet LSI."



Rea Kotani:

"Të realizojmë qëllimin për të cilin jemi krijuar, të jemi pranë çdo qytetari shqiptar. Investimi tek rinia është investim i drejtpërdrejtë për Shqipërinë tonë."



Dritan Ylli:

"LSI ka qënë një derë e hapur jo vetëm për të mirëpritur qindra qytetarë që kërkojnë të bëhen anëtarë të LSI, por edhe derë mikpritëse për të dëgjuar çdo hall të çdo banori dhe për tu dhënë zgjidhje."



Erisa Xhixho:

"Ne besojmë fort tek pjesëmarrja juaj në çdo vendimarrje të LSI. Hapja e LSI drejt intelektualeve, të rinjve, grave dhe vajzave duhet të vazhdojë. Duhet të vazhdojmë dhe konsolidojmë vlerat tona për të qënë pranë njerëzve."



Klajda Gjoshja:

"Është detyra jonë t'u ofrojmë një shans të gjithë qytetarëve. Solidariteti me qytetarët na nxit të jemi konstruktivë duke ofruar mundësi reale për një jetë më të mirë."



Ardit Çela:

"Nder dhe respekt për gjithë të zgjedhurit në strukturat e LSI. LSI përfaqëson sot një shans për të gjithë."



Luigj Turmalaj:

"Një shans për të gjithë e gjeta mes jush. Inkurajoj çdokënd që kërkon të angazhohet, dera e LSI-së është e hapur."



Edmond Haxhinasto:

"Forca jonë politike në vitin e 13 të jetës së saj ka treguar një qëndrueshmëri të admirueshme të parimeve dhe vlerave të veta thelbësore."



Klevi Pojana:

"LSI qëndron tashmë si alternativa politike që përfaqëson vlerat më të mira të socialdemokracisë në Shqipëri. LSI përfaqëson strukturë dhe përmbajtje, jo fasadë dhe reklamë."



Floida Kërpaçi:

"LSI-ja është partia e politikës për popullin. Të gjithë të rinjtë meritojnë një shans. Në përballje me sfidat, LSI-ja do të vazhdojë të jetë mbështetësja më e madhe."



Endrit Braimllari:

"Vlerësuam meritokracinë. LSI vlerëson komunikimin e drejtpërdrejtë dhe transparent me qytetarët. LSI është një shans për këdo që dëshiron të kontribuojë për zhvillimin e vendit."



Kejdi Mehmetaj:

"E ardhmja jonë është fitorja. Përgjegjshmëria na ka diferencuar nga të tjerët. Forca qëndron tek njerëzit dhe punët ndahen në ekip."

LSI nuk flet për koalicionin, Rrokaj: E vendos bilanci qeverisës

Profesori i LSI-së: Protesta e opozitës legjitime për zgjedhje të lira

ESIONA KONOMI
TIRANE

→ RROKAJ

KLAJDA GJOSHA

Lëvizja Socialiste për Integrim organizoi dje Konventën Zgjedhore të LSI Tiranë. Në aktivitetin e zhvilluar në Pallatin e Kongreseve morën pjesë 2301 delegatë nga të gjitha njësitë e kryeqytetit për të zgjedhur anëtarët e rinj të Komitetit Drejtues të LSI Tiranë dhe Kryetarin e LSI Tiranë. Ata përdorën votimin elektronik për të zgjedhur kryetarin dhe kryesinë, ndërsa dhjetëra fjalime ju referuan qeverisjes, vizionit të LSI-së dhe zgjedhjeve të ardhshme. Në morinë e fjalimeve, asnjë prej drejtuesve të LSI-së nuk u ndal tek e ardhmja e koalicionit dhe pse folën për standardet e qeverisjes. I pyetur për këtë çështje, kryetari i LSI-së së Tiranës, Prof. Dr. Shezai Rrokaj, në ditën e tij të fundit në këtë post, tha se një bilanc i punëve të përbashkëta në qeverisje do të përcaktojë edhe vendimin e strukturave të LSI për koalicionin zgjedhor. Gjatë një interviste për Report TV Rrokaj thotë se ka ende edhe pak kohë për një vendim të tillë, por nga ana tjetër kërkoi të shmangët gjuha e tensionit, e po ashtu tha ai debati i brendshëm e zhvillon më shumë një qeverisje. "Ky koalicion ka ende kohë për të verifikuar arritjet e veta, për të konstatuar edhe atë problematike që nuk është arritur dhe më pas do të ketë një bilanc dhe vendimarrje të pjekur, në mënyrë që shqiptarët të kuptojnë se çfarë ka qënë e mundur për t'u realizuar, jo për shkak se ka qënë e pamundur, por për shkak të papjekurisë politike, të arrogancës dhe shumë problemeve të tjera që lidhen me qeverisjen. Ne nuk duhet të kërkojmë një koalicion i cili quhet i mirë kur nuk ka polemikë", u shpreh Rrokaj. Duke folur për votimin e numërimit elektronik, praktikë kjo që zhvillohet prej kohësh në zgjedhjet brenda strukturave të LSI, Shezai Rrokaj tha se një proces i tillë e bën më transparente dhe të besueshme votimin. E megjithatë sipas tij ky proces është i mundshëm edhe në zgjedhjet politike të 18 qershorit, mjafton vullneti

"Ky koalicion ka ende kohë për të verifikuar arritjet e veta, për të konstatuar edhe atë problematike që nuk është arritur dhe më pas do të ketë një bilanc dhe vendimarrje të pjekur".

politik. "Votimi elektronik nuk është shpikje e LSI-së. Është një model teknik që e zbatojnë të gjitha vendet demokratike si në numri dhe verifikim. Sa i takon Shqipërisë, ne mbështesim çdo nismë e cila realizon një proces transparent zgjedhor. Asnjëherë s'është vonë për të bërë gjëra të mira. Të ulen të lënë mënjane hedhjet e ping-pong-ut, hedhjet e dorashkave", tha Rrokaj. Ndërsa mirëpret protestën e opozitës si një mekanizëm në demokraci, Shezai Rrokaj e konsideron legjitime kërkesën e opozitës për zgjedhje të lira. Sipas tij, çdo shqiptar duhet të kërkojë zgjedhje të lira. "Opozita shfrytëzon të gjitha mjetet që ka brenda kuadrit ligjor, për të kërkuar që zgjedhjet në Shqipëri të bëhen ashtu siç duhen. Unë them që çdo shqiptar, në këto kushte nuk do kishte dëshirë që zgjedhjet në Shqipëri të vidheshin apo të deformoheshin", theksoi Shezai Rrokaj. Ndërkohë, në asnjë prej fjalimeve të mbajtura nga përfaqësuesit e LSI, nuk është përmendur koalicioni me PS-në kur jemi 5 muaj larg zgjedhjeve parlamentare.

Ministrja e Integritetit: LSI është faktor stabiliteti

Ministrja e Integritetit, Klajda Gjoshja u shpreh se LSI vijon të mbetet një forcë politike që garanton stabilitetin e politikës shqiptare. Ajo vuri në dukje se në zgjedhjet 18 qershorit LSI do të bëjë diferencën. "LSI është faktor i stabilitetit të Shqipërisë, duke sjellë kulturën e re të politikëbërjes. Në zgjedhjet e 18 qershorit me votë qytetarët do të dinë të bëjnë diferencën"-u shpreh Gjoshja. Ajo tha gjithashtu se LSI i njeh mirë problematikat e kryeqytetit dhe çdo ditë do të jetë krah qytetarëve, pasi Tirana ka nevojë për më shumë punësim, mirëqenie dhe arsimim. "LSI është e vetmja forcë politike ku interesat kombëtare janë mbi çdo axhendë, pasi kanë në themel frymën e dialogut dhe zgjidhjeve që i shërbejnë vendit"-u shpreh Klajda Gjoshja.

NJOFTIM I TELEKOM ALBANIA SHA.

Lajmërim zyrtar lidhur me ofertën e bartjes së numrit në Telekom Albania sha.

Dëshirojmë t'ju informojmë se nga data 17 Shkurt 2017, të gjithë abonentët të cilët do të bartin numrat e tyre në Telekom Albania, do të përfitojnë për 6 muaj resht 30% ulje për paketat: M, L, XL, XXL. Gjithashtu do të përfitojnë edhe 100 lekë kohë bisedë pas aktivizimit të numrit.

Duke ju falenderuar paraprakisht.

Telekom Albania sha

T..

ÇASTE QË NA LIDHIN.

Nënkryetarja e LRI: Ja pse i kritikojmë ministrat socialistë

Rea Kotani: Qëndrimi ynë i pa lëkundur është kundër çdo rritje të tarifave studentore


ESIONA KONOMI
TIRANE

Ekonomia

Në Konventën e LSI-së së Tiranës, Rea Kotani e sheh të angazhuar mes qindra pjesëmarrësve të rinj, duke mirëpritur bashkëmoshatarët e saj. Studentja e ekonomisë shtrëngon nëpër duar fjalimin që do të mbajë në këtë takim në cilësinë e nënkryetares së LRI-së dhe anëtares së kryesisë së LSI-së. Pasi merr duartrokitjet e të pranishmëve, ajo ndalet të shpjegojë në një intervistë për "Shqiptarja.com" vizionin e saj në këtë parti, dhe çfarë do të thotë për të "Një shans për të gjithë". Kotani sqaron se pse LRI nuk i kursen ankesat e saj ndaj ministrave, jo vetëm socialistë, duke mos u përmbajtur në rrjetet sociale.

Rea, sa vite angazhim keni në LSI dhe si arritët të jeni anëtare e kryesisë së re?

Angazhimi im në Lëvizjen Rinore për Integrim ka nisur që prej 4 vitesh, kohë në të cilën unë isha një maturanë në gjimnazin e përgjithshëm "Petro Nini Luarasi". Kisha dëgjuar nga miqtë e mi për LRI dhe më impresionoi mënyra e organizimit dhe nismat konkrete politike. Për këtë arsye vendosa të bëhesha pjesë e këtij forumi dhe më duhet ta pranoj që ishte ndër vendimet më të mira që kam ndërmarrë. Në atë periudhë, ne të rinjtë e LRI ngritëm çështjen e Maturës Shtetërore si një problem serioz për të gjithë maturanët. Ndryshimet që erdhën si produkt i propozimeve tona, ishin një shembull konkret se angazhimi im në LRI ishte diçka shumë sesa mbledhje dhe diskutime, ishte një mundësi për të ndikuar në realitetin tonë, një shans për tu bërë pjesë e vendimmarrjes. Me kalimin e kohës, unë vazhdova angazhimin tim edhe në strukturat e tjera të LRI, si struktura e studenteve të FEUT dhe struktura në Njësinë Administrative 7, ku isha edhe koordinatore gjatë zgjedhjeve të vitit 2015. Njëkohësisht isha pjesë dhe e nismave të tjera politike të ndërmarra nga ky forum, si p.sh ligji i vullnetarizimit. Gjatë qershorit të vitit 2015 u zhvilluan zgjedhjet për leadershipin e ri të LRI-së, periudhë në të cilën unë u zgjodha nënkryetare e forumit. Më pas, në dhjetor u propozova nga z. Meta për të qenë pjesë e kryesisë së re dhe u votova nga Komiteti Drejtues i LSI. Për mua është një vlerësim i madh të qenit anëtare e Kryesisë së LSI dhe ky besim që më është dhënë duhet shpërblyer me akoma më shumë punë dhe përkushtim.



Papunësia

Papunësia tek grupmosha 15-29 vjeçare vazhdon të mbetet në shifra të larta, treguese kjo e nevojave të menjëhershme që ka vendi ynë për politika konkrete që nxisin punësimin e të rinjve.



Taksat

Biznesi shqiptar është i rënduar nga taksat, pasi realisht ka pasur një rritje të tyre, madje pavarësisht rritjes ato nuk kanë mundur të gjenerojnë të ardhurat e duhura në buxhetin e shtetit.

Mirëqenia

Jo gjithmonë një rritje ekonomike përkthehet në rritje të mirëqenies. Sipas Forumit Ekonomik Botëror nga rritja ekonomike kanë përfituar një pakicë, pasi shpërndarja e rritjes ekonomike nuk ka qenë gjithëpërfshirëse.



Ju tashmë jeni edhe nënkryetare e LRI-së e po ashtu edhe anëtare e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës. Në këto kushte dëshiroj

t'ju pyes për Ligjin e Arsimit të Lartë. A keni ju rezervë për sistemin e tanishëm arsimor?

Sistemi arsimor kishte nevojë për një reformë që do ta kthente atë në një sistem më të drejtë, ku parimi i meritokracisë do të mbizotëronte dhe në qendër të të cilit do të ishte studenti. Ligji i ri i Arsimit të Lartë vë theksin tek autonomia e institucioneve arsimore, që për mendimin tim është thelbësore për mirëfunksionimin e sistemit. Ajo për të cilën unë kisha dyshime ishte mënyra sesi ky ligj do të implementohej. Procesi i Maturës Shtetërore për vitin akademik 2015-2016 dështoi si në realizimin e transparencës ashtu edhe të meritokracisë. Ky dështim erdhi si pasojë e keqmenaxhimit të procesit dhe mungesës së theksuar së informacionit. Në ato kohe LSI pati propozimet e saj për të ndikuar pozitivisht në kaosin e krijuar, por nuk u morën parasysh. Edhe unë, së bashku me dy anëtarë të tjerë të Senatit Akademik të UT dërguam kërkesë si në Senat, po ashtu edhe në Ministrinë e Arsimit për rishikim të kriterëve, kërkesë e cila sërisht nuk u mor parasysh nga Ministria. Ndaj, mund të them se prova e parë e këtij ligji nuk rezultoi me sukses përse i përket implementimit. Gjithsesi, unë jam pozitive për këtë vit akademik, pasi kriteret e sapo shpallura të çdo fakulteti të UT përfshijnë vetëm lëndët e kurrikulës bazë, çështje për të cilën edhe ne ngulmuam nëpërmjet diskutimeve në Senat. Po ashtu, do të doja të shtoja që gjatë miratimit të këtij ligji një pjesë dërmuese e studentëve ishin dhe vazhdojnë të jenë të shqetësuar për tarifën studentore. Qëndrimi ynë i pa lëkundur është kundër çdo rritje të tarifave studentore.

Padyshim ju do të angazhoheni në fushatën elektorale të 18 qershorit. Me çfarë premtimesh do të shkonin pranë të rinjve shqiptarë?

Të rinjtë shqiptarë nuk kanë nevojë për shumë fjalë dhe premtime. As unë nuk jam një fanse e madhe e tyre. Mendoj se mënyra më e mirë për t'iu afruar të rinjve të tjerë është nëpërmjet sinqeritetit dhe projekteve konkrete për të rinjtë. Ne, si LRI kemi punuar mbi programin politik që do të ud-

hëheqë forumin tonë gjatë 4 viteve të ardhshme. Fokusin maksimal e kemi patur tek Arsimi, Punësimi dhe Përfshirja e të Rinjve në Vendimmarrje, duke i cilësuar si çështjet më të diskutuara nga të rinjtë. Fatmirësisht, si LRI kemi treguar prej kohësh që kemi dëshirën dhe pasionin maksimal për të iniciuar nisma konkrete politike, po ashtu jemi të përfaqësuar me 30% në çdo strukturë drejtuese brenda LSI, me 2 deputete në Parlament dhe me 80 këshilltarë në të gjithë Shqipërinë. Në këtë rast janë faktet ato që na japin më shumë avantazhe dhe garantojnë që fjalët tona nuk janë boshe, por kanë në thelb të tyre veprimin.

A jeni ambicioze për të qenë deputetja e re e parlamentit?

Përfshirja e të rinjve në pozicione vendimmarrëse si në pushtetin lokal ashtu edhe në atë qendror është një politik e suksesshme e ndjekur nga LSI dhe padyshim është një mundësi për të ndryshuar frymën dhe modelin e politikës shqiptare. Momentalisht, unë mbaj



Rea Kotani, Nënkryetarja e LRI-së

Ajo që shohim në rrjetet sociale, është një kritikë e fortë që të rinjtë e LSI-së bëjnë për ministra dhe funksionarë socialistë. Pse ka një mospërmbajtje në raport me artikullimin publik të LSI-së?

Ne jemi të rinj që i jemi bashkuar një forumi rinor politik, tek i cili be-sojmë. Nëse do të ishim të kënaqur me mënyrën sesi politika shqiptare funksionon apo politikën në tërësi, nuk do ishte nevoja të bëheshim pjesë e politikës, pasi nuk do të kishim asnjë shtysë të brendshme për ta bërë këtë gjë. Është realiteti shqiptar, janë ndryshimet që ne do dëshironim të shihnim në këtë realitet, që na frymëzojnë për të qenë pjesë e politikës, në mënyrë që të jemi pjesë e vendimmarrjes. Unë kam ardhur në politik si Rea Kotani dhe që në fillim kam pasur një qëllim, të mos lejoj politikën të më ndryshojë mua, por le të ndryshojmë ne të rinjtë politikën shqiptare. Le të jemi ne të rinjtë ata që ndonjëherë mbajnë një qëndrim të caktuar apo bëjnë një kritikë të fortë, kur e konsiderojmë të nevojshme. Nuk mendoj se



Ilir Meta, Rea Kotani dhe Lefter Koka

postin e Nënkryetares së LRI-së dhe të anëtares së Kryesisë së LSI. Jam vlerësuar shumë, ndaj e ndjej si përgjegjësime time, por mbi të gjitha edhe si dëshirën time për ta përkthyer këtë besim që më është dhënë në akoma më shumë punë. Nuk ka kaluar ende viti që nga zgjedhjet brenda forumit, ndaj kemi shumë punë dhe sfida përpara. Personalisht, jam e idesë që çdo individ duhet të përmbushi me sukses përgjegjësitë aktuale, përpara se të kërkojë diçka më shumë. Mendoj se nuk ka rëndësi pozicioni që gjithsecili prej nesh mbart, por rëndësi ka dëshira e mirë për të sjellë ndryshimin.

ne duhet të heshtim dhe të jemi indiferent ndaj veprimeve të caktuara, pasi të riut nuk i shkon për shtat të bëjë kompromise. Shpesh herë më duhet ta pranoj që politika shqiptare nuk jep maksimumin për realizimin e qëllimit të saj, për të qenë pranë çdo qytetari, problematikave të tyre dhe për të hartuar dhe implementuar politika eficiente. Ndaj, nuk i kemi kursyer mendimet apo kritikën tonë, jo vetëm ndaj funksionarëve socialistë, por edhe përfaqësuesve të LSI, në momentin që diçka nuk na është dukur korrekte apo kur për çështje të caktuara nuk ka pasur asnjë veprim politik.

Basha: Me 18 shkurt nis rruga për zgjedhje të lira

Kreu i PD: Nuk shtyhet më jeta kështu, disa marrin qindra milionë USD



Lulzim Basha me të rinjtë në Durrës

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

LULZIM BASHA

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka zhvilluar dje një takim me të rinjtë e FRPD së Durrësit, në kuadër të mobilizimit të qytetarëve për të marrë pjesë në protestën e 18 Shkurtit. Gjatë fjalës së tij, Lulzim Basha u shpreh se në 18 shkurt do të nisë rruga për zgjedhje të lira të ndershme. Kryetari i opozitës u shpreh gjithashtu se nuk mund të shtyhet më jeta në këtë mënyrë, ku një pjesë merr koncesione qindra milionë dollarë, ndërsa rinia rri rrugëve. “Ndaj bashkohemi të gjithë më 18 Shkurt në Tiranë, jo për një parti politike, jo vetëm për një axhendë politike, por për qëllimet e mbarë shqiptarëve. Ndryshim sepse kështu nuk çohet më jeta. Ndryshim, sepse Shqipëria nuk mund të vazhdojë më kështu. Ata që nuk duan ndryshim, duan ta mbajnë Shqipërinë kështu se për ta është mirë. Ata ndërtojnë vila 6 milionë dollarë dhe fusin 3 milionë në xhepat e tyre, me

“Ndryshim sepse kështu nuk çohet më jeta. Ata ndërtojnë vila 6 mln dollarë dhe fusin 3 mln në xhepat e tyre, me beton. Ata marrin koncesione qindra milionë dollarë, rinia rri rrugëve”.

beton. Ata marrin koncesione qindra milionë dollarë, rinia rri rrugëve.

18 SHKURTI

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, tha dje se në 18 Shkurt shqiptarët e braktisur do të marrin fatin e tyre në dorë. “Nuk mund të vazhdojë më kështu. Shqipëria do ndryshim. Ndryshimi vjen përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe rinia durrsake është gati për të garantuar që zëri i atyre që sot nuk dëgjohej, të kumbojë më 18 Shkurt dhe, me 18 Shkurt do kumbojë zëri i shumicës dërrmuese të shqiptarëve që sot nuk dëgjohej për shkak të propagandës dhe mashtrimit qeveritar. Shqiptarët e braktisur nga

qeveria do të marrin fatin e tyre në dorë. Shqiptarët e braktisur nga qeverisja do të diktojnë zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, unë i garantoj ata se do të kenë një qeverisje të qytetarëve një qeveri të qytetarëve, një kryeministër të qytetarëve”, pohoi Basha.

ALBANA VOKSHI

Kryetarja e Lidhjes Demokratike të Gruas së Shqipërisë, deputetja Albana Vokshi u takua me drejtueset e LDG-se Lezhë, Mirditë dhe Kurbin nga ku bëri thirrje për pjesëmarrje masive në protestën e 18 shkurtit në Tiranë për të rrëzuar qeverinë dhe për të çuar Shqipërinë drejt zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. “Nga Tirana nis një lëvizje popullore pa kthim, e cila do të përfundojë vetëm me largimin e kësaj qeverie të korruptuar, antisociale, të lidhur me krimin e organizuar. Sot qeverisemi nga kriminelë. Pushteti duhet t’u kthehet qytetarëve. Edi Rama erdhi në pushtet me vota të blera. Ndaj e mbushi Shqipërinë me hashash, sepse kërkon paratë e drogës që të blejë votat në zgjedhjet e ardhshme”, tha Vokshi.

Deklarata

Gafa e Dumës: Droga kaloi nga ‘aeroporti’ i Durrësit

Për Grida Dumën, sekretaren e Marrëdhënieve me Publikun në PD, qyteti i Durrësit ka një aeroport. Teksa ka denoncuar sot për kapjen e 8 ton hashash në Itali, Duma në vend që të thoshte se kjo sasi droge ka kaluar nga porti i Durrësit, ajo thotë nga “aeroporti i Durrësit”. Sikur të mos mjaftonte, ajo e përsërit dy herë madje me një vendosmëri dhe bindje të madhe. “Krimi, pushteti i krimi po dominon shtëpitë, po dominon edhe rrugët, madje edhe aeroportin e vetëm ndërkombëtar të vendit, por edhe aeroportin e Durrësit. 8 ton drogë kanë kaluar në aeroportin e Durrësit, duke bërë sikur nuk e ka vënë re, por realiteti është krejt ndryshe”, shprehet Duma.



Bashkia e Tiranës do japë 1 milion USD kredi për strehim

Kreditë e buta, ja skema e re e përfitimit për familjet e pastreha


Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka deklaruar dje se do të shpenzohen 1 milion dollarë për kreditë e buta, që do të shpërndahen pranverën e këtij viti, për strehim. “Do ta bëjmë me një sistem pikëzimi, ku pikët variojnë nga aftësia që ke për të paguar, nga nevoja për të zbutur kreditë, deri tek numri i fëmijëve që ke. Do të marrim indeksin e INSTAT dhe do ta azhurnojmë”, tha Veliaj. Sipas Veliaj ky nuk është një investim që ndihmon vetëm familjet në nevojë. “Ne kemi kalkuluar që për 1 milion dollarë që bashkia investon në

VELIAJ

“Do ta bëjmë me një sistem pikëzimi, ku pikët variojnë nga aftësia që ke për të paguar, nga nevoja për të zbutur kreditë, deri tek numri i fëmijëve që ke. Do të marrim indeksin e INSTAT dhe do ta azhurnojmë”.

këtë skemë, bankat çlirojnë 40-50 milionë dollarë. Të hedhim 40 ose 50 milionë dollarë në ekonominë e Tiranës në vitin 2017 është sa dy herë gjithë investimet publike të bashkisë të marra

së bashku”, nënvizon Veliaj. Kreditë e buta janë vetëm një nga alternativat e strehimit që ofron Bashkia e Tiranës. Për disa kategori ka mundësi të tjera. Nderkaq, Bashkia e Tiranës po i jap formë edhe bulevardit të ri. Pas vendosjes së pllakave të para, paralelisht Bashkia e Tiranës prej pak ditësh po vijon me procesin e mbjelljes së pemëve, çka do ta shndërron këtë pjesë të kryeqytetit në një hapësirë të madhe gjelbërime. Kështu, përveç shtrimit të pllakave dhe mbjelljes së pemëve, po punohet shpejt edhe me parkingun nëntokësor. Kreu i Bashkisë



Erion Veliaj

së Tiranës, Erion Veliaj, ishte i pranishëm gjatë procesit të mbjelljes së pemëve të para nga 1100 pemë të llojeve të ndryshme që do të mbillen në 800 metrat e para të Bulevardit, i cili u shpreh entuziast se puna për pjesën e parë është drejt fundit. “Kemi hyrë në fazën përfundimtare të pjesës së parë të Bulevardit, pra pasi nisëm me vendosjen e pllakave të

para, po mbyllim parkingun nëntokësor me 300 vende, i cili do të hapet në pranverë për publikun, dhe më në fund erdhëm në procesin e mbjelljes së pemëve. Janë pisha të buta mesdhetare, shumë të ngjashme me ato të Bulevardit të vjetër, pra për të ruajtur konturin e gjelbër që i lidh dy bulevardet, i cili po merr jetë dita-ditës”, tha kryebashkiaku Veliaj.

AKTIVITETI

Tirana, 97-vjet kryeqytet, Seferi: Një qytet evropian



Në kuadër të 97-vjetorit të shpalljes së Tiranës kryeqytet, Bashkia e Tiranës organizoi një sërë aktivitete të rëndësishme. Fillimisht nënkryetarët e Bashkisë, Andi Seferi dhe Abaz Hado, të shoqëruar edhe nga përfaqësues të familjeve tiranase, zbuluan në zonën e Kasharit pllakatën përkujtimore në nder të asaj dite ku qytetarët e Tiranës dhe drejtues të Bashkisë morën në mbrojtje përfaqësuesit e organeve drejtuese të shtetit shqiptar të zgjedhur nga Kongresi i Lushnjes. Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Andi Seferi u shpreh se ky 97-vjetor e gjen Tiranën një qytet ku punohet çdo ditë me përkushtim për ndërtimin e një qyteti evropian.

SARANDË

Hiqet busti i Hillary Clinton i vendosur në korrik të 2016




Busti i Hillary Clinton i cili është vendosur në muajin korrik të 2016 në qendër të sheshit të Sarandës, është hequr nga bashkia e këtij qyteti. Shkak për këtë janë bërë punimet për risistemimin e lulishtes. Të kontaktuar nga Report TV, zyrtarë të Bashkisë kanë deklaruar se heqja e bustit nuk ka aspak lidhje me faktin që Clinton ka humbur zgjedhjet në Amerikë, por arsyeja kryesore janë punimet në shesh. Ata janë shprehur se busti do të rivendoset sërish. Busti është vepër e skulptorit Idriz Balani. Vendimi u mor pas propozimit të kryetares së Bashkisë së Sarandës Floriana Koka, në nderim të mbështetjes së saj për shqiptarët.

Shtatëzania e vajzës shkak për krimin e dyfishtë

Ermira varroset vetëm nga familja. Autori i krimit nderohet nga mbi 1 mijë vetë

Ermira Arapi, 29-vjeçarja që u vra një ditë më parë në Fier nga dashuri i saj Drini Derveni, i cili më pas u vetëvra dyshohet se ka qenë shtatzënë. Ekspertët e grupit hetimor kanë ngritur dyshimet për shtatzëninë nisur nga këqyrja paraprake e trupit të pajetë, por pritet që përgjigja e autopsisë të japë detaje të sakta. Burime nga grupi hetimor kanë bërë me dije se 29-vjeçarja është qëlluar në pjesën e qafës dhe Derveni në pjesën e kokës. Sipas po të njëjtat burimeve, mësohet se është rrëzuar plotësisht pista që vrasjet të jenë bërë nga një person i tretë. Ditën e hënë pritet të ketë një përgjigje përfundimtare nga ana e mjekësisë ligjore. Një shtatzëni e mundshme në një kohë që bashkëshorti i viktimës ishte emigrant në Greqi, dyshohet se mund të ketë qenë edhe shkak i një grindje mes tyre, por kjo pistë ende është e pakonfirmuar. Nga grupi hetimor janë marrë edhe dëshmit të të afërmeve të tyre nëse kishin dijeni për këtë lidhje, apo viktimat të kenë pasur ndonjë konflikt të mundshëm. Ermira Arapi me origjinë nga Lushnja dhe e martuar në Fier është nënë e një vajze 5 vjeçe ndërsa Drini Derveni ka dy djem.



Drini Derveni

SHKAKU

Një shtatzëni e mundshme në një kohë që bashkëshorti i viktimës ishte emigrant në Greqi, dyshohet se mund të ketë qenë edhe shkak i një grindje mes tyre, por kjo pistë ende është e pakonfirmuar.



Ermira Arapi

tuar nga i dashuri i saj Sokrat Shani. Në ceremoninë e varrimit Jonida, u përcoll nga familja në banesën e fundit, ndërsa autori i krimit u përcoll me nderime dhe shumë njerës në ceremoni.

NGJARJA

Ngjarja e rëndë që tronditi dje Fierin dhe mbarë opinionin publik ndodhi gjatë orëve të paradites. Ermira Arapi me nderime dhe shumë njerës në ceremoni.

një makinë tip "Fuoristradë" buzë rrugës në fshatin Shënpjetër të Fierit. Nga këqyrja e trupave të tyre, policia tha se dallohej qartë se 31-vjeçari pasi kishte qëlluar me armë të dashurën, ka vrrarë edhe



Makina ku u gjendën të vdekur Drini Derveni dhe Ermira Arapi

veten. Policia e gjeti atë me një pistoletë tip "TT" në dorë dhe tha se ka qitje me puthitje në kokën e tij, që i shtyn hetuesit të besojnë që ai është autor i vrasjes së të resë, me të cilën ka pasur një lidhje jashtëmartesore. Pas këtij akti fieraku i ka dhënë fund edhe jetës së tij. Një gjë e tillë ishte planifikuar prej disa kohësh nga Derveni, pasi sipas hetuesve ai kohët e fundit kishte siguruar dhe armën e krimit. Pritet të dalin të tjera detaje rreth ngjarjes që tronditi mbarë opinionin publik.

TIRANE

Prostitucion në qendrën e estetikës, në pranga pronarja



Shkatërrohet një tjetër rrjet prostitucioni në Tiranë. Policia e kryeqytetit ka arrestuar pronarën e një qendre estetike, ndërkohë që 3 vajza që ushtronin prostitucion, njëra prej tyre 14 vjeçe dhe 3 klientë do të ndiqen në gjendje të lirë. Aksioni i policisë është zhvilluar ditën e premte në një qendër estetike në Tiranë. Polica thotë se kishte marrë informacione se në një ambient i cili përdorej për masazh, ushtrohej edhe prostitucion kundrejt pagesave ekstra nga klientët. Drejtuesja e këtij grupi ishte pronarja e qendrës estetike E.I 38 vjeçe, e cila tashmë është arrestuar. 38-vjeçarja i ftonte vajzat që të punonin si masazhatore në këtë qendër estetike. Më pas ajo iu thoshte atyre se nëse klientët ua kërkonin duhet të kryenin edhe marrëdhënie seksuale me ta dhe për këtë do të paguheshin ekstra. Ndërkohë po pronarja e kësaj qendra estetike u ofronte klientëve shërbime ekstra duke u thënë se vajzat do të ishin në dispozicion të tyre nëse paguanin 50-10 mijë lekë të reja më shumë. Ky aktivitet ushtrohej prej 5 muajsh në këtë qendër estetike.

ARMATIMET / REPARTI SPECIAL MODERNIZOHET

Armatim i ri për forcat RENEA

Ministri Tahiri: Gati edhe Reparti i ri



Saimir Tahiri te reparti RENEA

Gjatë ditës së djeshme Ministri i Punëve të Brendshme Saimir Tahiri së bashku me Drejtorin e Polcisë së Shtetit Haki Çako dhe drejtues të tjerë të lartë të Polcisë së Shtetit kanë marrë pjesë në një ceremoni për prezantimin e pajisjeve të reja dhe armatimit vënë në dispozicion të Repartit Special Renea, të cilat janë rezultat i investimit nga Buxheti Shtetit. Ministri Saimir Tahiri ka theksuar ndër të tjera se ky është i gjithi një investim njerëzor, buxhetor, infrastrukturor për Policinë e Shtetit, në mënyrë që ajo të japë shërbimin e duhur dhe të ketë rezultatet e duhura në luftën kundër kriminalitetit. "Kjo qeveri ka shpenzuar 4 milionë USD për pajisje të reja, armatim të ri për RENEA, për të luftuar kriminalitetin me shumë sukses.

Ky nuk është i vetmi sektor ku kemi investuar për një polici të mirë, pasi kemi investuar në zyrat e shërbimit unik, në mjete të reja, burime njerëzore, akademia e policisë nxjerr njerëz të kualifikuar, po investojmë edhe në forcat speciale. Shumë shpejt do të jetë gati reparti i ri për RENEA. Është një investim njerëzor dhe buxhetor për Policinë e Shtetit, në mënyrë që policia të japë shërbimin e duhur në luftën kundër kriminalitetit. Është kjo arsyeja pse Policia është trupa më e besuar nga shqiptarët. Por kjo është vetëm pikënisja jonë për të bërë gjithçka duhet në mënyrë që në vazhdim të kalojmë të gjitha sfidat e vështirësitë që kemi, të japim një shërbim shumë më të mirë, dhe të japim një shërbim shumë më të drejtë, ta bëjmë Shqipërinë shumë më të sigurt dhe më të drejtë"-u shpreh Tahiri.

Ngjarja në Itali

Arratisja e tre shqiptarëve nga burgu, kapet i pari

Ka rënë në prangat e policisë italiane një prej shqiptarëve të arratisur nga burgu Rebibbia në Romë, disa muaj më parë. Ai u kap në Milano, ndërsa nuk bëhet i ditur ende emri i shqiptarit të arrestuar. Shqiptarët që u arratisën në tetor të 2016 janë: Mikel Hasanbelli, 36 -vjeç, i dënuar për shfrytëzimi prostitucioni, Tesi Basho 36-vjeç i dënuar për vrasje dhe Ilir Pere 40 - vjeç, për tentativë vrasje. Arratisja e tyre nga burgu i Rebibbia-s në Romë, bëri bujë në mediat e vendit fqinj.



Ngjarja në Laç

Aksidentohet për vdekje këmbësori, pranga 22-vjeçarit

Një këmbësor ka humbur jetën pasditën e djeshme pasi është përplasur nga një makinë në superstradën Laç-Mamurras. Mësohet se këmbësori, identiteti i të cilit nuk dihet ende është përplasur nga mjete tip Benz veturë me targë AA 044 MS teksa ai po kalonte rrugën. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 17:50. Policia ka bërë të mundur arrestimin e drejtuesit të mjetit 22 vjeçar Preng Gjoka. Mbi 22-vjeçarin rëndon akuza e e veprës penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor".

ERMIRA, PËRCILLET E VETME NË VARRIM

Ditën e djeshme në orë dhe vende të ndryshme dy të rinjtë janë përcjellë për në banesën e fundit. Paradoxalisht, familja e burrit të Ermira Arapit, fisi i tij, por edhe njerëzit e fshati të saj kanë refuzuar pjesëmarrjen në ceremoninë e varimit të 29-vjeçares. Kjo pasi sipas tyre ata ndiheshin të turpëruar për veprimet jo morale të nuses. Megjithatë e martuar Ermira, jetonte me kunatën e saj në Lushnjë, ndërkohë bashkëshorti, vajza e vogël bashkë me vjerrën dhe vjehrrin, jetonin në Greqi. Në varrimin e 29 vjeçares Ermira Arapi kanë marrë pjesë vetëm pak njerëz nga familja e saj dhe varrimi është bërë në fshatin e saj në Lushnjë. E kundërta ka ndodhur në varrimin e Drini Derveni, i cili ka pasur një pjesëmarrje mjaft të madhe. Sipas informacioneve në ceremoninë mortore kanë qenë mbi 1 mijë persona të cilët i dhanë lamtumirën e fundit. Trupat e pajetë të Drini Derveni dhe Ermira Arapit u gjetën në një mjet tip Jeep në zonën e Hoxharës në Fier. Në fakt shqiptarët gjithmonë në këto raste braktisin viktimën, duke dënuar veprimet e vajzave që kanë mbetur të lëndura në këto raste, ndërkohë respektojnë autorët e krimit që në shumë raste kanë qenë burra. Rasti më i freskët është ai i një krimi të dyfishtë në zonën e Golemit, ku 29-vjeçarja Jonida Çanaku, është ekzeku-

Ministri Tahiri: Nuk tërhiqemi do të identifikojmë autorët

Në gjykatë, pritet të caktohet arrest me burg për policët

ELTON QYNO
TIRANE

Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri u shpreh këtë të shtunë se grabitja e 2.7 milionë euro tre ditë më parë në "Qafë Kashar" nga blindi i një shoqërie private të sigurisë, do zbardhet plotësisht, ndërsa nuk dha detaje për hetimet. Tahiri tha se policia do të bëjë punën e saj dhe nuk intimidohet nga sulmet. "Siç kemi zbardhur ngjarjet e tjera, do të zbardhim edhe këtë ngjarje. Policia nuk intimidohet, por do të bëjë detyrën e saj. Aseti ynë i çmuar është besimi i qytetarëve. Të jeni të bindur se policia do ta zbardhë edhe këtë ngjarje siç ka bërë me ngjarjet e tjera. Rezultatet e hetimit do të bëhen të ditura në momentin e duhur"-u shpreh ministri i Brendshëm.



Saimir Tahiri

TEK MAKINAT

Lidhur me këtë ngjarje, policia dhe prokuroria kanë ekzaminuar me imtësi dy autojetet e vjedhura që janë gjendur të djegura. Burimet shtojnë se pikërisht në këto mjete kanë shpresa të gjetjes të ndonjë sendi personal të autorëve, që mund ti ketë shpëtuar djegies

dur të grabisin 2.7 milion euro, në një kohë kur kamerat dhe GPS-i nuk kanë qënë në funksionim. Pesë policët e arrestuar, sipas prokurorisë janë përgjegjës për fikjen e kamerave dhe të GPS-it, pasi sipas deklarimeve që ata kanë dhënë gjatë marrjes në pyetje,

fikja është bërë pasi, 5 policët kishin planifikuar që pasi të ishin kthyer nga aeroporti i Rinanit të pinin kafe në një nga lokalet e zonës. Ky rrëfim ironik i njërit prej policëve, ka habitur prokurorët, të cilët ndaj tyre kanë ngritur akuzën e "Shpërdorimit të detyrës".




Momenti i grabitjes së parave



Shoqata

Grabitja, bankat: 7 muaj më parë kërkuam të merren masa


Shoqata e Bankave ka reaguar pas grabitjes së 2.7 milionë euro në Qafë Kashar, para këto të njëjtit nivelit të dytë që kishin për destinacion Vjenën. Shoqata thekson se bankat kanë përgjegjësi për sigurinë fizike brenda ambienteve ku zhvillojnë veprimtarinë, por sipas ligjit, bankat nuk lejohen të transportojnë vetë vlera monetare. Gjithashtu, bankat theksojnë se 7 muaj më parë kanë kërkuar marrjen e masave për vendosjen e standardeve për transportimin e të hollave, kërkesë e cila nuk është plotësuar. "Sipas ligjit, bankat nuk lejohen të transportojnë vetë vlera monetare. Ato nuk janë përgjegjëse për vendosjen e standardeve apo kërkesave për këtë veprimtari, sa kohë ligji nuk parashikon dhe nuk ja njehtë detyrë apo të drejtë. Shoqata Shqiptare e Bankave, pasi ka evidentuar elementët e rrezikut gjatë transportimit të vlerave monetare, ka kërkuar, për më tepër se 7 muaj, pranë autoriteteve vendosjen e standardeve për transportimin e vlerave monetare në kuadrin rregullator përkatës, i cili ende nuk është plotësuar"-thuhet në reagimin e bankave.



Arrestohet dy skafistët

Me 1.5 ton drogë u prishet skafi, i shpëton policia

Dy skafistë vlonjatë nuk kanë qënë dhe me shumë "fat" pasi teksa po transportonin drogë në Itali kanë rrezikuar të mbyteshin. Gomonja me të cilën por transportonin sasinë e drogës ka futur ujë e për pasojë i është fikur motori, duke bërë që dy skafistët konkretisht 25 dhe 43 vjeç të dy nga Vlora të kërkonin ndihmën e Policisë Italiane për t'i shpëtuar. Teksa kanë shkuar det për t'u dhënë ndihmë, policia ka konstatuar se në gomone kishte një sasi të madhe drogë e cila dyshohet se është rreth 1.5 ton. Skafi është gjetur



i përmbysur dhe dy skafistët po qëndronin mbi të, e ndërsa droga ka përfunduar në det. Burime për Report TV bëjnë me dije se për shpëtimin e dy skafistëve është përdorur dhe një helikopter i Guardia di Finanza. Dy vlonjatët kanë rënë në prangat e Policisë e ndërsa sipas hetimeve të deritanishme skafistët janë nisur mbrëmjen e djeshme rreth orës 02:00.

DROGA/ SASIA REKORD ËSHTË KAPUR NË ANKONA

Mediat italiane: Kapen 8 ton drogë, vinte nga Shqipëria

Policia Italiane ka kapur një sasi rekord drogë e cila ishte nisur nga Shqipëria. Ashtu siç raportojnë mediat italiane, thuhet se Guardia di Finanza ka sekuestruar 8 tonë drogë. Policia e kishtë lënë të kalonte drogën në portin e Ankonës me qëllim për të arrestuar personat që e prisnin atë. Për këtë arsye Policia dhe një njësi e ushtrisë në Itali e kanë ndjekur kamionin për kilometra të tëra. Në momentin që shoferi ka ndalur në një pikë servisi afer Venecia, Policia italiane ka vendosur të ndërhyjë. Ndëryhrja është bërë pasi shoferi po priste në këtë pikë servisi për disa orë dhe dyshimi i Policisë ishte që sasia e marijuanës do të qëndronte aty, ose shoferi e kishte kuptuar që po ndiqet nga Policia. Menjëhëre është arrestuar shoferi 38-vjeçar nga Maqedonia. Droga ishte fshehur mirë në kamion mes



OPERACIONI

Policia e kishtë lënë të kalonte drogën në portin e Ankonës me qëllim për të arrestuar personat që e prisnin atë. Për këtë arsye Policia dhe një njësi e ushtrisë në Itali e kanë ndjekur kamionin për kilometra të tëra.

VJEDHJA 2.7 MILION EURO

Nga dy automjetet pjesërisht të blindura, janë grabitur jo 2 milion euro, por shuma e saktë e eurove të mara nga katër personat e armatosur, është 2.7 milion euro. Kjo shumë financiare ka qënë e vendosura në arka dhe thasët e bankës, të cilat janë boshatisur tërësisht. Lajmi është konfirmuar nga prokuroria e Tiranës, e cila saktësoi se në dy automjetet e sulmuara nga katër personat, nuk është gjetur asnjë kartmonedhë. Sipas prokurorisë, ata kanë mun-

dy pllakave të cilat në pamje të parë nuk lejonin zbulimin e marijuanës. Mediat italiane si "Venezia Today" thonë se droga ishte nisur nga Shqipëria dhe

kishte destinacion final Italianë. Në një komunikatë për shtyp, Policia Shqiptare pretendon se nuk ka asnjë lidhje me sasinë e drogës së kapur në Itali.

Zbardhet kërkesa e plotë për të marrë kompensimin e pronave

Agjencia e Pronave: Të gjitha dokumentat që duhen për të paraqitur kërkesën si dhe afatat e përcaktuara

Agjencia për Trajtimin e Pronave ka publikuar vendimin e plotë për mënyrën se si do të plotësohet kërkesa për të marrim kompensimin. Kjo agjenci nëpërmjet këtij vendimi shpjegon për të gjithë ish-pronarët se si mund të marrin kompensimin. Subjekti i shpronësuar, trashëgimtarët e tij ligjorë ose përfaqësuesi i tyre me prokurë, depoziton në Agjencinë e Trajtitit të Pronës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet postës, kërkesën e motivuar për njohjen dhe kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, sipas këtij vendimi, me të cilin provon pretendimet e tij. Kërkesa e subjektit të shpronësuar, trashëgimtarëve të tij ligjorë ose përfaqësuesit me prokurë, duhet të jetë sipas formularit tip, bashkëlidhur këtij vendimi, për aplikimin e kërkesave për njohje e kompensim, i cili duhet të jetë i nënshkruar nga subjekti i shpronësuar ose përfaqësuesi i tij me prokurë. Formulari tip përmban një paralajmërim, që ngarkon me përgjegjësi sipas ligjit subjektin kërkues, në rast të deklarimit të të dhënave të rreme apo depozitimit të dokumentacionit të falsifikuar.

të shtetasve shqiptarë, të krijuara përpara datës 7 prill 1939, të cilat janë sekuestruar sipas nenit 14, të ligjit nr.37, datë 13.1.1945, "Ligja e tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës ose çdo dokument tjetër ligjor i lëshuar nga institucionet shtetërore i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes". b) kur një nga dokumentacionet e sipërpërmendura ligjore paraqet mangësi lidhur me sipërfaqen dhe kufijtë e pronës së pretenduar, subjekti depoziton vendimin gjyqësor të formës së prerë së bashku me planvendosjen e pronës, objekt gjykimi, të vulosura nga gjykata, si dhe aktekspertimin, në rast se gjatë gjykimit të çështjes në gjykatë është kryer një i tillë.


RASTET E VEÇANTA

Në rastet kur ATP-ja konstaton mungesë në dokumentacion, subjektit të shpronësuar i kërkohet plotësimi i dosjes përkatëse, brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes së njoftimit për plotësim dokumentacioni. Plotësimet mund të bëhen për të gjitha dosjet e depozituara në ATP për shqyrtim përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji si dhe për kërkesat e paraqitura nga subjektet brenda afatit 90-ditor të përcaktuar në ligj. Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të pajiset nga zyra e protokollit të ATP-së me vërtetimin përkatës për numrin e protokollit të dosjes së regjistruar, që tregon edhe datën e dorëzimit të kërkesës e të dokumenteve të tij. Kërkesat e subjekteve të shpronësuar, të cilat depozitohen nëpërmjet shërbimit postar dhe kanë mangësi në dokumentacionin shoqëruar, gjë që e bën të pamundur vlerësimin e tyre, do t'i kthehen kërkuesit në adresën e dhënë, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit në mënyrë të hollësishme. Kërkesa, së cilës i mungon adresa e saktë postare, vlerësohet jo e mirëqenë dhe riaktivizohet vetëm me interesimin e kërkuesit pranë zyrave të ATP-së. Në çastin e konstatimit, nga struktura përkatëse e ATP-së bëhet shpallja publike në mjediset e ATP-së dhe në njësitë e qeverisjes vendore, ku ndodhet

Pronat
Prona e kthyer vlerësohet sipas zërit kadastral aktual të saj dhe sipas zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit, duke llogaritur diferencën e vlerës, që do të rezultojë nga ndryshimi

DOKUMENTACIONI

Dokumentacioni shoqëruar, që vërteton pronësinë e subjektit të shpronësuar, përbëhet nga: a) dokumentacioni ligjor; b) dokumentacioni hartografik; c) vërtetime për përfitim nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore. Dokumentacioni ligjor përbëhet, sipas rastit, nga: a) dokumentacioni hipotekor, kadastral, arkivor, vendimet e mëparshme të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Komisionit/ Komitetit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ish-ZRKKP-së, AKKP-së, dokumenti që vërteton heqjen ose marrjen e së drejtës së pronësisë nga shteti subjektit të shpronësuar, sipas akteve ligjore e nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose në çdo mënyrë tjetër të padrejtë që nga data 29.11.1944 apo dokumenti për pasuritë e paluajtshme



prona, objekt pretendimi.

KTHIMI

Në rast të kundërt, kur kërkesa dhe dokumentacioni bashkëlidhur praktikës pas shqyrtimit nuk janë nga ana formale në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim edhe pas njoftimit të plotësimi të mangësive të saj, ATP-ja do t'i kthejë kërkuesit në adresën e dhënë aktet e praktikës. Në rastet kur dokumentacioni ligjor i administruar nga subjekti kërkues paraqet mangësi ose kur është i nevojshëm plotësimi i tij, ATP-ja kryen verifikimin dhe konfirmimin e dokumentacionit në institucionet përkatëse që e kanë lëshuar atë. Dokumentacioni hartografik për pozicionin gjeografik të pronës, që i takon periudhës kohore sa më të përafërt me dokumentin ligjor i cili përmban të dhëna pronësie, çdo të dhënë topografike e hartografike, do të administrohet dhe do të përpunohet (pozicionimi) nga inxhinieri gjeodet pranë ATP-së, pjesë e grupit të punës për shqyrtimin administrativ të kërkesës. ATP-ja, në funksion të procesit të njohjes e të kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të



Problematikat

Në rastet kur ATP-ja konstaton mungesë në dokumentacion, subjektit të shpronësuar i kërkohet plotësimi i dosjes përkatëse, brenda 30 ditëve

Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilave lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces. Çdo institucion shtetëror, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për procesin e njohjes e të kompensimit të pronës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të sigurojë pa tarifa dhe taksa informacionin apo dokumentacionin e kërkuar nga agjencia, si dhe të raportojë arsyet e mospërmbyshjes së një mase apo rekomandimi të kërkuar.

VERIFIKIMI NË TERREN

Verifikimi në terren për pozicionimin dhe gjendjen faktike të pronës, si dhe përgatitja e aktverifikimit përkatës duhet të kryhet në prezencë të kërkuesit. Akti i verifikimit është

sipas formularit tip të miratuar me urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së. Kur në pronën e pretenduar nga subjekti kërkues janë ngritur nga të tretë objekte në zona informale, ATP-ja nuk disponon me kompensim fizik mbi këtë pronë, por me një nga mënyrat e tjera të kompensimit. ATP-ja kërkon nga njësitë administrative vendore informacion nëse mbi pronën e pretenduar nga subjekti ka plan urbanistik të miratuar që i shërben interesit publik. Në këto raste, ATP-ja nuk disponon me kompensim fizik mbi këtë pronë, por me një nga mënyrat e tjera të kompensimit. Për kërkesat e paraqitura për trajtim para hyrjes në fuqi të ligjit nr.133/2015, dhe të patrajuara me vendim, ATP-ja fillon menjëherë shqyrtimin e tyre, si më poshtë vijon: a) Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijon regjistrin e kërkesave pa vendim, bazuar në rendin kronologjik të aplikimit të tyre pranë strukturave përgjegjëse në kohën e dorëzimit të tyre, bazuar në nivel qarku. b) Brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nis procesin e njoftimit të subjekteve të shpronësuar për dokumentacionin që duhet plotësuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara me vendim të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së, sipas prioritetit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 15, të ligjit 133/2015. c) Procedurata e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të akteve nga subjektet e shpronësuar gjatë trajtimit të kërkesave u nënshtrohen dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

TRAJTIMI I KËRKESAVE

Mënyra e trajtimit, shqyrtimit dhe dhënies së vendimit për kërkesat e subjekteve të shpronësuar bëhet në përputhje me ligjin nr.133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave". ATP-ja, pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave e të marrjes së vendimit, pajis subjektet e shpronësuar me dokumentin përkatës për njohjen, masën dhe mënyrën e kompensimit të pronës sipas rastit, kompensimin fizik brenda kufijve të pronës së njohur, kompensimin nga fondi i tokës apo kompensimin financiar të pasurisë si dhe të drejtave të tjera reale, sipas përcaktimeve në ligjin nr.133/2015. Në rast se ATP-ja merr vendim për njohje dhe kompensim fizik në pronën e subjektit, prona vlerësohet, si më poshtë vijon:

a) Prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit.

b) Prona e kthyer vlerësohet sipas zërit kadastral aktual të saj dhe sipas zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit, duke llogaritur diferencën e vlerës, që do të rezultojë nga ndryshimi i zërit kadastral.

c) Kur nga ky vlerësim rezulton se subjekti përfiton një pronë që ka vlerë më të lartë sesa prona që ka pasur në momentin e shpronësimit, atëherë subjektit i kompensohet fizikisht sipërfaqja që i korrespondon vlerësimit dhe pjesa tjetër e pronës kalon në fondin e tokës me vendim të ATP-së. Pozicionimi i pronës pas vlerësimit do të kryhet nga grupi i punës.

Kjo është Zyli...

Të pathënat e aktores së 250 premierave në skeçe, teatër e kinema



NGA XHAHID BUSHATI

1. Zylia Miloti është një aktore me një botë të pasur shpirtërore, ku në interpretimet e saj rrjedh natyrshëm humori shkodrë. Tabani i saj është Estrada e Varietesë. Galerinë e personazheve që krijoi, veçanërisht në skeçet: "Familja Bush", "Kunati i shokut Xhemal", "Konstandini dhe Doruntina", "Lulashi", "Fotografia", "Lokja" etj., mbetet zëmardhe në skenën e humorit shqiptar. Befasimet në krijimin e figurave që nuk i ngjajnë njëra-tjetrës, intuïta, batutat të mbarsura me një frazeologji të trevës së Shkodrës, bukuria që përherë sfidon moshën etj., bën që ta sjellë

bukur dhe në mënyrë simpatike humorin në skenë. Dhe magjia e saj qëndron te forca interpretative. Kjo është Zyli... e pse jo, një Tinkë e humorit...

Zyli!.. Nuk i largohet traditës shkodrë, asaj të biçikletave. E, nga lagjja me traditë "Perash", ku ajo banon, me biçikletë udhëton rrugëve të qytetit të saj të lindjes dhe... ndalet si zakonisht në portat e teatrit "Migjenit. Nuk troket... Hyn pa trokitur... Ajo... që pa i mbushur të 14-vjetave, kur ishte në klasën e 7-të u paraqit për herë të parë para publikut shkodrë si një këngëtare e vogël por shumë e talentuar. Kënga do ta ndjekë pas...

Por pas do ta ndjekin edhe rolet aktoriale... Në fillim dramatike, më pas do të qëndrojnë në "ishullin" e saj të humorit. Ishte 20-vjeçe, kur "puthi" skenën e estradës profesioniste të teatrit "Migjeni". Ishte viti 1967. Me rolet e saj: e paarritshme dhe modeste, fisnike dhe plot elegancë, komunikuese dhe me një mirësi qeshjeje, elegante dhe e bukur edhe sot e kësaj dite, plot sharm dhe pa teprime, energjike dhe sfiduese e moshës së saj,...

vijon në faqet 14-15

■ **Aktorja /** Galeria e pazakontë e personazheve që krijoi, veçanërisht në skeçe

■ **Rrëfimi/** Isha 13 vjeç kur më thirrën për të interpretuar si aktore e dramës në teatrin "Migjeni"




Jeta urbane dhe arsimimi në zonën shqiptare të pushtimit italian

Gjatë kohës që po piqeshin kushtet për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, dy nga gjashtë Fuqitë e Mëdha të kësaj kohës, Italia dhe Austro-Hungaria ishin përkrahëse të çështjes shqiptare. Të dyja fuqitë mbanin këtë qëndrim, sepse synonin të kontrollonin Detin Adriatik, porta e madhe e tyre tregtare në Lindjen e Afërt. Këto territore, në fakt prej mëse një gjysëm shekulli ishin zona të ekspansionit të tyre ekonomik. Në të njëjtën kohë Austro-Hungaria dhe Italia, kundërshtonin daljen e Serbisë në Adriatik...

NGA DORIAN KOÇI

faqe 18-20



Whitney Warren, Një amerikan në Shqipëri në mbarim të Luftës së Parë Botërore

Quket Whitney Warren, dhe është Dikush. Fjala është konkretisht për arkitektin e njohur amerikan dhe bashkëthemeluesin e firmës "Warren and Wetmore" e cila, vetëm në vitet 1910-1930, ndërmori projektimin dhe ndërtimin e mbi 50 godinave madhështore në Manhattan e në New York City.

Siç del më poshtë nga artikulli i tij "Shqipëria", botuar më 23 nëntor 1918 në organin francez "la Renaissance", ai ka qenë për vizitë në vendin tonë...

NGA FOTAO ANDREA

faqe 16-17

PORTRET | AKTORJA

Kjo është Zyli...

Një portret që zbërthen jetën dhe karrierën e aktores së humorit Zylyha Milori

Biseda dhe kujtime për aktoren e Estradës profesioniste të teatrit "Migjeni" të Shkodrës, Artisten e Merituar Zylyha Miloti...Fillesat ne art, rolet e para, familja dhe humori që shoqëron çdo stacion të jetës së aktores dhe karriera me më shumë se 250 premiera...

NGA XHAHID BUSHATI

vijon nga faqja 13

...e freskët dhe me një humor që i del nga shpirti, "vajzë e re" e me një fytyrë që nuk i gjen mudha... Kjo është Zyli, me një kontribut prej më se 250 premierash shfaqjeje. Le të kujtojmë fillimisht disa komedi, si: "Surpriza", "O vajzën, o komunën", "Vël-lai nga babai", "Fejesë me internet"; të shfaqjeve: "Big brother 1", "Big broderher 2"; te filmat: "Shoku ynë Tili" me rolin e nënës, "Dy herë mat" me rolin e gruas së drejtorit; të roleve, si: Hana, Rabija, Zadjia, Luli, Lokja, Ana... etj., etj.

Zylyha... sec i shkëlqejnë edhe ca çmime, edhe ca medalje, si këto që po përmend: "Gruaja e Vitit 2000 - 2001" nga Instituti i Biografive në Kembrixh të Anglisë, "Naim Frashëri i Artë", "Mjeshtrë e madhe e skenës", "Ambasadore e Paqes", etj.

2.

Shenja zodiake e Zylyhës është Bricjapi. Ndonëse nga familja e saj dhe e burrit, as nga farë e fisi nuk kanë pasur e as nuk kanë ndonjërin kasap apo blektor.

-E lexoni rubrikën: "Horoskopi", në gazeta?

Përgjigje: Shenja ime është Bricjapi. Ndonëse nga familja ime dhe e burrit, as nga farë e fisi nuk kemi pasur e as kemi ndonjërin kasap a blektor.

Kaq shumë dua të di për shenjën time, sa jo vetëm që e kam mësuar përmendsh orën kur jepet në ekranin e vogël, por jam një amatore e rregullt e gazetave. Dua të di ç thonë për shenjën time. Bile nganjëherë, kaq kureshtarë jam, sa shfletoj edhe gazeta të vjetra. Nganjëherë kujtohem se iks gazetë e kam marrë në dorë disa herë... Nuk e di pse, por më pëlqen... Nganjëherë mendimet, ëndrrat e idetë më dalin me atë të horoskopit. Por fjalët e shprehjet e fundit më ngatërojnë moshën. Janë për rininë! Hyjmë edhe ne në "të moshuarit" rastësisht (qesh).

-Aktori dhe fëmijëria - një binom me plot ëndrra dhe kujtime! Edhe pse në largësi kohore, malli "ndez" shumë dëshira të fshehura e kujtime të bukura...

Përgjigje: Fëmijëria ka shumë kujtime. Është moshë e singertë. Vetë fëmijëria është një kujtim i bukur që mund të krahasohet me një lulebore, një yll, një qiell të kaltër, një zog në fluturim, një... E me që jam te fëmijëria, të voglës Zyli i pëlqente të këndonte, të merrej me teatër, të lozte me kukulla, të bënte rete odash, të...gjithçka të bënte siç ëndërron një vajzë e vogël. Nga natyra kam qenë fëmijë i urtë. Më vonë më kanë thënë: "Kurrë s'na ka marrë mendja, që ti një ditë do të bëhesh aktore!?"

Siç duket urtësia e shpesh vetmia paskan qenë dy rrugët për t'u bërë artiste. Ç'është them?!... Ndoshta ka qenë dhe vetë koha, për të qëndruar "kokëulur", le pastaj të guxojë të thojë se dua të bëhem artiste, të dal në skenë para syve të njerëzve, etj. etj. Kjo, ndoshta ka qenë dhe arsyeja që si aktore kam shpërthyer vonë.

Siç duket talenti paska qëndruar "besnik" në pasaportën time. Kam kujtuar se do të bëhem këngëtare, por, në fakt u bëra aktore.

-Aktore?! Po kur?!..

Përgjigje: Që në moshën 13 vjeçare jam thimur për të interpretuar si aktore e dramës në teatrin "Migjeni". Ka qenë një rol vajzë në dramën "Tepër sekret", me regjisor Ndoc Sheldinë. Më kujtohet se e shoqja e bep Shirokës, Beatricja më ka rregullur bishtalecat dhe veshjen, sepse për moshën që kisha dukeshë e rritur. Por vitet kalojnë. Një kontribut kam dhënë edhe në grupin artistik amator të PAM-it. Edhe këtu m'u shfaqën ca "shenja" të tjera të horoskopit (qesh), si: spikere, këngëtare, parodiste e interpretoese në skeçe të ndryshme.

-Si punoni për rolin tuaj?

Një tregues është dhe përvoja skenike... Përgjigje : Në vitin 1967 u bëra "profesioniste" në Estradën profesioniste të qytetit tim. U njoha me aktorë që kishin emër në skenë, si T. Banushi, H. Smaja, P. Preka, B. Pepa, G. Kruja, do të njihesha me të tjerë që do të bënin emër, si Z. Deda, J. Shala, K. Biga, D. Xhai, E. Çinari, S. Ruçi. Më dukej sikur "përsëndtja" e "bisedoja" me galerinë e personazheve që kishin krijuar e që do të krijonin në skenën e teatrit të qytetit tim. E personazhe të rinj do t'i shtoheshin kësaj galerie, personazhe me humor, falë interpretimit tim!

Pas 31 vjet pune, mund të sjell detaje nga përvoja e punës sime. E lexoj materialin me kujdes. Kur është i bukur shihet qysh në leximin e parë. Ky ngacim për mua është shumë i rëndësishëm, do të thoja jetik për materialin. Me shumë dashamirësi e nënvizoj, njëkohësisht dhe më vonë e pasuroj me batutat e mia. E theksoj dhe një herë, rëndësi ka të "thërrasë" fabula. Domsdo interpretimi ka vlerën e vet të pamohueshme. Dua të veçantoj dhe diçka: ka pasur raste, kur autori ka pyetur: "Vallë, a është materiali im ky?!" Gjithësesi mendoj që aktori nuk është i interesuar të "prishë", sepse është "buka" e tij.

-Kur interpretoni, ju "ndrisin" sytë. Veçori aktoriale apo..?


Përgjigje: Kur interpretoj nuk i dalloj amatorët nga profesionistët. S'kam dalluar kurrë. Si personazhit, ashtu edhe partnerit unë nuk i bëj hile...

-Si e "fotografojnë" vitet aktorin, e konkretisht Zylin?

Përgjigje: Mbjaj mend veten, kur kam hyrë për herë të parë në estradë. Isha 20 vjeçe. Po tani, pas 30 vjetësh?...Ndryshimi shihet... Bashkë me të shihen edhe rolet. Nuk mund të luaj më 20 vjeçaren. Rolet kalojnë sipas moshës. Megjithatë, edhe në këtë moshë që jam, në shfaqjen e parafundit, publiku ka qeshur dhe njëkohësisht është befasuar, kur kam dalë me minifund. Një interpretim të tillë donte personazhi. Të "urdhëron". Kjo tregon se Zyli ka kohë të lërë skenën. Ka edhe disa vjet...

-Aktori nuk luan vetëm në skenë. Ka partnerë...

Përgjigje: Po. Rolet më të bukura, më të realizuara i kam



me Taano Banushin, Paulin Prekën, Zef Dedën, pastaj edhe me aktorë të tjerë. S' mund të harroj paroditë me Tanon, apo skeçet "Beqoja në spital", "Fotografia"; me Paulin Prekën në skeçet "Lokja", "Dy anë të një medaljeje"; me Zef Dedën në skeçet: "Kunati i shokut Xhemal", "Konstandini dhe Doruntina" etj. etj. Mjafton të kujtoj Tano Banushin. Me ta marrë materialin, ka ditur ta diskutojë atë, ka pasur aftësinë të dijë se "ku i dhemb e ku i djeg" si i thonë një fjale të urtë popullore, pa folur për interpretimin e shkëlqyer e të paarrtshëm të tij.

-Në galerinë e personazheve që keni interpretuar veçohen shumë figura nënash, të cilat nuk i ngjajnë njëra - tjetrës...

Përgjigje: Të faleminderit! Tani të vijmë te skeçi "Lokja" (sipas motiveve të dramës "Toka jonë" të K. Jakovës).

Nuk kam ndjerë aspak vështirësi në realizimin e figurës së Lokes, e kam fjalën për të folurën dialektore të saj. Mbase ka ndikuar që jam nënë, mbase turmetë që bënim herë pas here në Malësi, ku kam patur fatin të njoh shumë figura grash, të njoh detaje nga jeta e tyre, psikologji e natyra të ndryshme. Të gjitha këto më ndihmuan që të ndërtoj një Loke me brumë të dramës "Toka jonë", por e veshur me dukur, mendëi, fjalor të një kohe të re, që në ndërgjegjen e saj krijon përplasje, kontrastin, e për rrjedhojë "lulëzojnë" situata e efekte komike.

Te një komedi muzikore e titulluar "Çështje familjare" e F. Krajës, interpretova figurën e një nuseje, siç i themi nga Shkodra, xhadë. Siç duket ishte edhe tema, e cila zgjoi interes për publikun e pranishëm, pa ishin edhe marrëdhëniet vjehërr - nuse, përmes një dialogu përgjithësisht poetik e detajeve të gjetura, që krijojnë një humor të këndshëm. Jashtë skenës, në publik, pati shumë diskutime e pëshpërime. Në mes tyre, pati edhe ndonjë zë gruaje të moshuar që foli: "E mjera vjehërr që të paska!" Siç duket me rolin kisha qëlluar në shenjë. Ndërsa në jetë kam qenë nuse e mirë për vjehërrin.

-Ju kujtohet se, për interpretimet me nivel në zhanrin e humorit, jeni nderuar me çmimin "Çajupi"?

Përgjigje: E kujtoj pas 13 vjetësh.

-Po titullin "Artiste e Merituar"?

Përgjigje: Si s'e kujtoj. Kishte 110 vjetorin Banda muzikore e Shkodrës. Për anëtarët e kësaj bande muzikore, nuk u dha as një çmim, as një dekoratë! Çuditërisht unë dhe Paulin Preka u nderuam me titullin: "Artist i Merituar", ndonëse nuk i kishim rënë asnjë vegle muzikore, e nuk kishim marrë pjesë qoftë edhe një ditë në provat e bandës.

-Po në ekran e keni parë veten?

Përgjigje: Ndoshta angazhimi me skenën, ka bërë që me filmn të "mbaj" distancë. Oferta kam pasur, por realisht interpretimi në filma është me të numëruar gishtinjtë e dorës. Megjithatë kujtoj: "Dy herë mat", "Shoku ynë, Tili", "Pak fresk,



sonte!" (ky film televiziv) etj.

-Thatë pak më parë: "angazhimi me skenën". Si ta kuptojmë?

Përgjigje : Unë e dashuroj profesionin tim. Nuk mendoj të shkëputem shpejt nga skena. I kam dhënë jetën time. Mjafton të përmend një fakt: pak kohë më parë isha te vajza në Gjermani. Menduan disa të afërm të mi, se nuk do të kthehesha. Në fakt u ktheva. Profesionin është shkaku kryesor që më ka detyruar të kthehem. E përsëris: e dua shumë, s' mund të ri pa të!

3. NJË KARTOLINË, NË FORMË KUJTIMI PARA 13 VJETËSH... (PËRSËRI NJË INTERVISTË...)

Aktorja e estradës së Shkodrës, Zylia Miloti ishte përsëri një befasi edhe në Festivalin "Apollon 2006" që u zhvillua në Fier. Për rolin e Gjylit dhe për aktrimin më të mirë, ajo u nderua nga juria me çmimin e dytë.

Të mësuar me rolet e saj në një shfaqje estrade, kësaj radhe aktorja erdhi ndryshe, do të thonim disi jashtë "formatit" të zakonshëm dhe traditor. Erdhi me një rol sa komik aq dhe dramatik në dramën "Një histori e thjeshtë". Autori dhe regjisor i kësaj pjese Edmond Mhilli i besoj rolin e protagonistes.

Lidhur me karakterin e Gjylit që krijoi artistja Miloti, që në këtë festival ishte surprizë dhe befasi, zhvilluam një bisedë me regjisorin e teatrit "Migjeni" të Shkodrës, Edmond Mhilli...

-Në punën tuaj si regjisor keni bashkëpunuar edhe me aktoren Zylia Miloti. Cili është vlerësimi për të?

*Me aktoren Zylia Miloti, Artiste e Merituar, kam filluar bashkëpunimin që kur u emërova në Estradën e Shkodrës, në vitin 1976.

Në të gjitha premierat që kam vënë, me Zylin bashkëpunimi ka qenë i frytshëm. Ka qenë një aktore e dashur, e imja, në kuptim profesional. Në asnjë punë prej këtyre viteve, nuk mund të them që gjatë procesit krijues të kem pasur keqkuptime. Përkundrazi, Zyli, edhe kur kishte ndonjë gjë që nuk bindej, heshtëte, gjykonte... e më pas..., shumë më pas diskutonte. Sepse raportet me regjisorin i shikonte si gjë të shenjtë. Dhe kurrë në punën e saj s'e ka prishur këtë shenjtëri. Këto cilësi i ka pasur edhe Artisti i Popullit, Tano Banushi.

Zyli përherë ka qenë një aktore me kërkesa kryesore të mjeshtërisë së aktorit. Ajo ka punuar me regjisorë si Paulin Sekuj, Gjergj Vlasi..., dhe pastaj shumë vite me mua (që vazhdon ende) dhe mbart përvojat e tyre.

Nga natyra është një aktore këmbëngulëse, nuk diskutohet e talentuar, e me një ndjeshmëri të jashtëzakonshme artistike. Janë pikërisht këto cilësi të vyera të saj, të cilat më ngacmuan dhe më bindën përfundimisht që unë ti besoj rolin e Gjylit tek drama-komedi „Një histori e thjeshtë“, ku unë isha autor e regjisor.

Zylit ia dhashë të lexojë veprën. Të nesërmen erdhi me lot në sy. Ishte entuziaste për rolin dhe shprehu gatishmërinë për ta interpretuar.

-Tani të vijmë te shfaqja teatrale „Një histori e thjeshtë“. Aktorja Zylia Miloti nuk mbart më role në shfaqje estrade, siç jemi mësuar ta shikojmë, por përballat me një rol drame, sa serioz aq dhe komik. Pse i gjithë ky besim?

*Te karakteri i Gjylit kam pasur parasysh të nxjerr një grua shkodrane me karakteristikat tipike të mjedisit të saj. Ndoshta dhe mund t'i afrohet, ndoshta dhe t'i bjerë për shtat aktore, kjo nuk ka asgjë për t'u çuditur. Por unë isha i bindur që Zyli do ta realizonte këtë rol, megjithëse ishte shumë e vështirë. Se një aktor estrade del rreth 10 minuta në skenë. Po të interpretojë në një komedi me një akt, mund të dalë në skenë një me çerek ore, e në këtë 15 minutësh ka apo s'ka 8 minuta në skenë. Kurse në rastin konkret kishim të bënim me një grua, me Gjylin, që si personazh e fillon dhe e mbaron veprën. Rrjedhimisht ka ndenjor 2 orë pa tetë minuta në skenë, pra, me një ngarkesë e me një procedim artistik të këtij karakteri.

Kur Zyli-Gjyl doli në skenë, miqtë e mi regjisorë mu shpre-

hën: „Mondi, fillimisht kur doli Zyli e filloi interpretimin në rolin dramatik... sikur... s'patëm besim dhe thamë...„...dicka Mondit do t'i ketë ndodhur...“ Pastaj, nga skena në skenë, Zyli na befasi në krijimin e këtij karakteri, që vërtet ishte një mrekulli“.

-Si bashkëjetojë Zyli te Gjyli dhe Gjyli te Zyli?

*Vepra është e ndërtuar në dy plane: komik dhe dramatik. Kalimet nga njëri plan në tjetrin dhe anasjelltas, Zyli-Gjyl, Gjyli-Zyli bënte me një natyrshmëri dhe ndjeshmëri të admirueshme profesionale. Si protagonist e shfaqjes ajo luajti dramën e Gjylit, me një besueshmëri, zhdërvjelltësi dhe nivel.

Kam një detaj, që lëviz në gjithë veprën. Është një shprehje tipike shkodrane: „U thasha si thahet fiku“. E kam përdor edhe për kalimin nga plani dramatik në planin komik dhe anasjelltas. Zyli-Gjyl, që edhe këtë detaj nuk e anashkalon, por e vlerëson me një lojë që të mahnit.

-Tani që shfaqja ka mbaruar, ky „besim“ është justifikuar artistikisht nga aktorja Zylia Miloti?

*Po. E kam pasur bindje (në kuptimin profesional) që këtë rol do ta realizonte. E kjo ka qenë vazhde e atij serioziteti që Zyli ka punuar vite të tëra me mua, si dhe me regjisorë të tjerë. Të qenurit aktore e këtyre dy planeve e ka pasur dhe më parë. Cilësitë e saj aktoreke dhe përvoja i kanë dhënë personalitetit të saj artistik një dimension të ri vlerësimi.

Kujtoj që në momente të lirshme të punës i thoja: „Zyl, do të befatosh spektatorin“. Dhe kjo e vërtetë doli... Sepse shquhej nga një punë këmbëngulëse profesionale. Qëndiste çdo fjalë. Kurrë në prova (edhe pse e lodhur) nuk më tha: „a të pushoj pak!“. Magjia e interpretimit ishte e tillë sa ajo arriti të bëhej njësh me rolin, të mishërohej në karakterin e personazhit Gjyl. Realimi që i bëri kësaj figure ishte i tillë, sa Gjyli do të mbetet padyshim në fondin e teatrit kombëtar, figurë e krijuar nga mjeshtria e



interpretimit të artistes Zylia Miloti.

4. Ç'THONË PËR ZYLIN...

Shkrimtari dhe dramaturgu Fadil Kraja: „Në çdo teatër shkojnë dhe vijnë shumë aktorë, regjisorë, autorë apo skenografë... Shumica dërmuese e tyre, me kalimin e kohës harrohen, fshihen nga kujtesa, sepse nuk lënë gjurmë. Të pakët, shumë të pakët janë ata që kujtohen dhe i qëndrojnë kohës dhe ndërtojnë apo shkruajnë historinë e çdo teatri, kudo që interpretojnë. Në teatrin "Migjeni" të Shkodrës, Zylia Miloti është një aktore e tillë, pjesë e rëndësishme në historinë e këtij teatri gjurmëlënës. Aktore potente, me një pathos të lakmueshëm, me individualitet, me sharm... jo vetëm në shtratin e humorit e të satirës ku shkëlqen, gjithashtu, mjeshhtërisht. Talente të tillë si Zyli janë fat për një teatër, sepse vijnë rrallë. Ata nuk kanë moshë. Në kujtesën e spektatorit ata mbeten të rinj e të freskët përjetësisht.“

Regjisorin dhe karikaturistin Bujar Kapexhiu: „Zylia Miloti, mendoj se, është ndër aktoret më të mirat të humorit shqiptar

në përgjithësi, jo vetëm në interpretimin e karaktereve, por njëkohësisht në improvizimin dhe theksin e batutës humoristike me një plastikë të përsosur dhe mbi të gjitha me një lirshmëri në lëvizjet në skenë. Kam parur fatin që ajo ka interpretuar në filmin tim "Dy herë mat", duke i shtuar vlerat e autorit dhe regjisorit. Janë talente që rrallë i vijnë skenës dhe filmit shqiptar“.

Studiuesi dhe kritiku Prof. Josif Papagjoni: „... paraqitet si një nga aktoret më të suksesshme të Estradës Profesionale të Shkodrës për rreth 40 vjet (vazhdon edhe sot e kësaj dite). Ka luajtur shumë role në gjedhet e shkurtra të humorit, si komedi me një dhe disa akte, skeçe, dialogë, monologë, parodi, kuplete etj. Ishte plot hir në skenë, me një prani aktoriale që imponohej gjithandej, me zë të plotë e të bukur. Shfrytëzonte me sens e maturi nëndialektin e të folmes së trevës së Shkodrës, pa e bjerrur atë në një zhargon të rëndë e të pakomunikueshëm, përkundrazi duke e seltur e duke i dhënë një tingëllim poetik e plot muzikalitet. Krijoi figura grash prepotente e zotëruese ndaj burrave, llafazane apo të llastuara, sikundër edhe femra snobe, malësore disa naive apo "burmesha", zyrtare e intelektuale të kohës etj. Në aktrimin e saj këqyren më pak elementet e groteskut, duke qenë më aktive ato të një humorit me theksa realistë e sjellje sa më pranë modeleve jetësore. Ishte partnere e parapëlqyer e aktorit të mirënjohur Tano Banushi, sikurse edhe e Zef Dedës, me të cilët ka luajtur shumë pjesë të shkurtra për estradë ("Fotografi", "Në spital", "Kunati i shokut Xhema", "Truall i zënë", "Toka jonë" etj.) në vitin 2006 luajti rolin e Gjylit në pjesën "Një histori e thjeshtë" të Edmond Mhillit në teatrin "Migjeni", me të cilin fitoi çmimin si "Aktorja më e mirë" në festivalin e aktrimit "Apollon 2006". Loja e saj u shqua për finesë, elegancë, skrupulozitet e vërtetësi deri në hollësitë psikofizike, me një përshtatshmëri të rrallë dhe me shkapërcime të natyrshme, si të pandjeshme, nga tragjika te komikja dhe anasjelltas, duke krijuar figurën e një nëne të dhimbshur e plot mall për birin emigrant“.

Besnik Çinari, aktor, një nga partnerët më të spikatur të Zylit: "Zylia Miloti është një ndër aktoret e shquara në të gjitha kohërat në Shqipëri. Është fat i madh për mua me interpretu në skenë krah saj, këtu e 32 vjet më parë, e fat më i madh që rreth 20-vjet (e vazhdon...) të jesh si një partner“.

Fatbardh Smaja, regjisor: "Është një aktore e kompletuar. Ajo interpreton në mënyrë të jashtëzakonshme. Gjithmonë ka pasur diçka të veçantë në ndërtimin e figurave artistike në botën e personazhit. Gjithmonë përpiqet të shpërndajë mirësi në grup. Dëgjon me shumë vëmendje dhe përpikëmeri kërkesa e regjisorit“.

Bujar Qamili, Mjeshër i madh i këngës popullore shkodrane: "Zylia Miloti është një aktore e shkëlqyer e humorit dhe e komedisë, që rrallë mund t'i vijë teatrit "Migjeni". Një emër shumë i madh dhe i pëlqyeshëm në çdo shtëpi shkodrane dhe shqiptare. Emri i Zylia Milotit është sinonim i teatrit "Migjeni". Pa Zylin nuk mund të bëhet humor në skenë. Zyli me madhësinë e saj vazhdon të ecë me biçikletë nëpër Shkodër dhe, shpesh qytetarët e shikojnë dhe thonë: 'Si s'po din m'u plakë Zyli!' Zyli është dhe do të mbetet ikonë e humorit shqiptar. Është kënaqësi e madhe për këdo, kur është ballë për ballë, sidomos kur pin një kafe me Zylin.“

5.

Zyli e do shumë qytetin e saj Shkodrën që u lind më 11.01.1946. I rrezaton ky emër teksa shumë herë e përmend. I rrezaton: në sy, në shpirt, në lëvizjet dhe në rrëfimin e herëpashershëm të saj...

Shpesh... kur largohet, dëshiron të kthehet sa më shpejt. Në këtë "ikje..." teksa shikon kalanë, i kujtohen vargjet e Mjedës-shkodran dhe sytë i mbushen me lot. "Unë e du Shkodrën, - thotë Zyli, - e du shumë, aq shumë sa 'inshallah' ktu du me më dalë shpirti!"

Dhe... Zyli shpesh... 'largohet'... Se era e mallit për të bijën, Aidën, atje në Gjermani ku shkon "t'ia puthë sytë" e bën pakëz nostalgjike por edhe optimiste. Sepse atje e presin një mbesë dhe një nip që ia freskojnë më tepër jetën. Gjyshes (që ngjan si një përallë e bukur) i falin fëmijërinë e tyre. Është Lulebora që ëndërron të bëhet balerinë dhe Driloni që ëndërron të bëhet këngëtar (edhe pse dita-ditës ata po rriten dhe hedhin shtat...)

Zyli... kjo aktore fjalëpake dhe e bukur, e magjishme; e nget biçikletën nëpër Shkodër si një vajzë e re. Dhe Shkodra këtë mrekulli e mrekullon duke e fiksuar në celuloidin e saj të kujtesës.

Vizita | ARTIKULLI

NGA FOTQA ANDREA

Quhet Whitney Warren, dhe është Dikush. Fjala është konkretisht për arkitektin e njohur amerikan dhe bashkëthemeluesin e firmës "Warren and Wetmore" e cila, vetëm në vitet 1910-1930, ndërmoi projektimin dhe ndërtimin e mbi 50 godinave madhështore në Manhattan e në New York City.

Siç del më poshtë nga artikulli i tij "Shqipëria", botuar më 23 nëntor 1918 në organin francez "la Renaissance", ai ka qenë për vizitë në vendin tonë, pikërisht në mbarim të Luftës së parë botërore, një vizitë jo thjesht njohëse në rrafsh kulturor a turistik, por një vizitë me shumë gjasa politike, nisur nga nacionalizmi dhe angazhimi i tij pro-italian, për të mbështetur kërkesat e Italisë në Adriatik gjatë dhe pas Luftës së Madhe.

Është fakt historik se në kuadër të rivalitetit të Fuqive të kohës për vënie nën kontroll të zonave gjeostrategjike, "Çështja e Adriatikut" dhe vetë "Çështja shqiptare" dolën në plan të parë në mbarim të Luftës, kur përpara forcave politike shqiptare shtruhej detyra e ngutshme për ruajtjen e tërësisë territoriale dhe përcaktimin e statusit të ri juridik të shtetit shqiptar. Veçse, vetë këto forca, për shkak të rrethanave të ndërlikuara kombëtare e ndërkombëtare, po përballeshin me dy prirje politike në gjirin e tyre: njëra palë që mbështeste idenë se shqiptarët janë në gjendje të ngrënë e të drejtojnë vetë shtetin e pavarur shqiptar, pa ndërhyrje të huaj, apo ndryshe pa "protektorat" (S. Nivica e B. Pejani); dhe tjetra palë që kërkonte vendosjen, për një kohë të caktuar, të shtetit të pavarur shqiptar nën mbrojtjen e një Fuqie të huaj, si kusht i domosdoshëm për mëkëmbje dhe shmangje të çdo rreziku nga jashtë, sidomos nga fqinjët ballkanikë. Por edhe në këtë rast, për vënie të Shqipërisë nën mandatin e një Fuqie të jashtme, do shfaqeshin dy orientime: njëri fraksion i patriotëve shqiptarë që do t'i kërkonin Konferencës së Parisit mbrojtje amerikano-angleze dhe kundërshtim të protektoratit italian (M. Turtulli, G. Adhamidhi e M. Konica, mbështetur nga kolonitë shqiptare në Turqi, SHBA e Rumani); dhe tjetri fraksion me orientim proitalian (Turhan Pasha, L. Bumçi, M. Kruja, L. Gurakuqi, por edhe mjaft personalitete të tjera politike si S. Gjika, M. S. Gurra, M. Frashëri, M. Libohova, L.Nosi, etj.), që shihnin tek Italia një shtet perëndimor si fqinji më i afërt i Shqipërisë, me lidhje tradicionale, historike e kulturore, dhe me qytetërim të përparuar.

Këta patriotë, me sytë nga Italia, synonin thjesht dhe vetëm një mandat ndihme ndaj Shqipërisë, për "asistencë dashamirëse" dhe sidomos "ndihmë për një kohë të caktuar", siç nënvizonte memorandum i tyre i 14 prillit 1919 drejtuar Konferencës së Paqes. Ndonëse Italia nuk përmendej konkretisht me emër në këtë memorandum si një Fuqi protektore për Shqipërinë, kjo gjë lihej të kuptohej, ndërkohë që shprehej në të qartë se "ndihma duhej të ishte e tillë që të pajtohej me pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit shqiptar të bashkuar". Një



Whitney Warren

Një amerikan në Shqipëri në mbarim të Luftës së Parë Botërore

«Shqipëria» shkrimi i 1918-ës, botuar organin francez 'La Renaissance' nga arkitekti i njohur amerikan, pas një vizite me shumë gjasa politike, nisur nga nacionalizmi dhe angazhimi i tij pro-italian...

protektorat italian ndaj vendit tonë, i kufizuar në kohë, dhe me frymë europiane, shihej kështu si domosdoshmëri në kushtet jashtëzakonisht të vështira të shtetit të ri shqiptar që rrezikonte të copëtohej për të tretën

herë, deri në zhdukje, pas Kongresit të Berlinit dhe Traktatit të Londrës.



Nga ana tjetër, kërkesa për një protektorat italian ndaj Shqipërisë vinte edhe për arsye se mjaft personalitete politike shqiptare besonin në miqësi-

në e lashtë midis dy vendeve, e sidomos tek deklarata e Italisë e vitit 1917, që kishte shpallur "pavarësinë e gjithë Shqipërisë", ndryshe nga Austro-Hungaria, e cila kishte premtuar vetëm autonominë e saj. Në të njëjtën

kohë, duke u mbështetur tek parimi i "vetëvendosjes së popujve", si një aspiratë e çmuar për një paqe të drejtë e të qëndrueshme, parim i përkrahur fuqimisht nga presidenti amerikan Wilson, që deklaroi publikisht se nuk njihje traktatet e fshehta në kurriz të popujve - sikurse ishte Traktati i fshehtë i Londrës i vitit 1915 që zhdukte Shqipërinë nga harta e Ballkanit -, patriotët shqiptarë ishin të detyruar të pranonin (maj 1919) vendimin e Fuqive për vënie të Shqipërisë nën mandatin italian me argumentimin se "vendi nuk kishte arritur ende një pjekuri politike të duhur, për një jetë shtetërore plotësisht të pavarur".

Në të vërtetë, iluzioni se Italia do të ishte aleatja e jashtme më e mundshme dhe më e afërt e kombit shqiptar, shpejt do të shuhej më 1920 me Luftën e Vlorës, kur Italia (me mendësinë kolonialiste të kohës) do të këmbëngulte edhe ushtarakisht për vënien dhe mbajtjen nën kontroll të Vlorës, Sarandës, Durrësit, etj. Ashtu siç pati bërë edhe më 1915 me pushtimin e krejt rajonit të Jugut të Shqipërisë në akset Vlorë-Përmet dhe Tepelenë-Gjirokastrë-Sarandë. Ashtu siç do të bënte më në fund, edhe më 7 prill 1939, kur do të pushtonte Shqipërinë, pa hequr dorë nga qëllimet e saj aneksoniste ndaj Shqipërisë...

Por, le të kthemi në nëntor 1918, në prag të Konferencës së Parisit tek amerikani Whitney Warren, që realizon në këtë kohë vizitën e tij në Shqipëri. Në fakt, që në vitet e Luftës së parë botërore e shohim atë në Europë, si bashkëthemelues të Komitetit të Studentëve Amerikanë të Shkollës së Arteve të Bukura në Paris, duke mbrojtur kauzën franceze. Dhe shumë shpejt, i lidhur me miqësi të



SHQIPERIA

NGA WHITNEY WARREN

ngushtë me shkrimtarin e njohur italian Gabriele d'Annunzio, mbështet aktivisht edhe kërkesat e Italisë në Adriatik, duke u emëruar njëkohësisht përfaqësues diplomatik i Shteteve të Bashkuara në shtetin e lirë të Fiumes (Rjeka). Përkrahës i nacionalizmit politik italian, ashtu si d'Annunzio, që kishte hartuar më 1915 broshurën politike "Per la piu grande Italia", edhe Warren e kërkonte Italinë fuqi europiane të dorës së parë që duhej të shfaqte "frymë të re protektore" dhe "partneritet", por pa e lënë në hije parimin e "vetëvendosjes" së popujve. Duke ndjekur logjikën dhe frymën e kohës, në këtë shkrim, ai i njeht Italisë përkujdesjen për zhvillim të Shqipërisë dhe partneritet me të.

Njeri i besuar i Departamentit të Shtetit dhe posaçërisht i presidentit Wilson, ai ishte një figurë qendrore mes intelektualëve dhe politikanëve të shquar të Europës dhe Ballkanit, tek mbante lidhje të ngushta me ta, për ta paraqitur sa më objektivisht, realisht e në mënyrë konstruktive gjendjen në Ballkan gjatë dhe pas Luftës së parë, pikërisht në atë zonë të rrezikshme të kontinentit të vjetër të quajtur "Fuqi e barutit". I vetëdijshëm për rolin e Shteteve të Bashkuara si faktor paqëje, stabiliteti e progresi në rajon, dhe përfaqësues i tyre në Fiume (shpallur "shtet-tampon i pavarur"), një qytet në Kroaci, banuar kryesisht nga italianë e kroatë dhe konsideruar në atë kohë si "molla e sherrit" midis Italisë nga njëra anë, dhe mbretërisë kroato-serbe, nga ana tjetër, në çështjen aq delikate të kontrollit të Adriatikut, e shohim kështu amerikanin Warren të lidhur me letërkëmbim të dendur me mori personalitetesh të botës, që nga presidenti Th. Roosvelt dhe mbreti Albert I i Belgjikës deri të duka i Albës, mbreti i Monakos, shkrimtari Marsel Proust, konti Barbarini, shkrimtari dhe politikani Maurice Barrès, kryeministri francez G. Clémenceau, e me radhë, por edhe me personalitete europiane që ndiqnin nga afër "Çështjen shqiptare", si Justin Godart, d'Estournelle de Constant, Antonio Baldacci e Victor Bérard. Mbi të gjitha, Warren nuk e kursen penën e tij për të shkruar artikujt e ese që i botonte në organe të ndryshme të Europës, por edhe në formë broshure. Përmendim këtu artikujt e tij "Për Neutralitet", "Roli i Amerikës në luftën ajrore", "Po Adriatiku?", "Për miqtë e Francës", "Amerika dhe Anglia", "Duke vështruar Italinë", "Uniteti i Organizatës", "Bashkimi i Aleatëve", "Çështja e Adriatikut dhe Trente Trieste", "Hapi i fundit", "Përpjekja ushtarake dhe Italia gjatë luftës", "Mali i Zi: Krimi i Konferencës së Paqes", etj.

Përballë frymës së rivalitetit gjeo-strategjik që orientonte veprimet e Fuqive të kohës gjatë dhe pas Luftës së parë botërore, e cila do të bënte mbi 20 milionë viktima dhe do të rrezikonte mbi të gjitha të zhdukte krejt Shqipërinë, përballë kompleksitetit të ngjarjeve politiko-ushtarake që e shndërruan Shqipërinë në shesh-beteje në vitet 1914-1918, shohim personalitete të rëndësishme të botës shqiptare e të huaj të mobilizohen fuqimisht për të mbrojtur pas Luftës integritetin e kombit shqiptar në kufijtë e tij etnikë, të veprojnë mbi të gjitha, me mprehtësi e shkathtësi, në fushën diplomatike, e cila do të dilte tashmë në plan të parë për rivendosjen e Paqes së përgjithshme. Në kërkim të një "partneri strategjik" për Shqipërinë, nuk mungon në këtë mes edhe veprimtaria e amerikanit Warren, i cili e nis shkrimin e tij "Shqipëria" me një aluzion ironik nga bota e operave komike të Offenbach, "Banditët" dhe "Dukati i Gerolsteinit".

Z Whitney Warren, ka pasur rastin të vizitohet kohët e fundit Shqipërinë dhe ka vërtetuar në vend dëshirat që ushqejnë vetë shqiptarët në gjendjen e përgjithshme që e karakterizon. Në artikullin që na ka dërguar, tregon mënyrën se si e sheh ai çështjen të zgjidhur në castin e vendosjen së paqes së përgjithshme". (Ndërrhyrje redaksionale e gazetës "La Renaissance", 23 nëntor 1918).

Mes tërë problemeve që shtrohen për zgjidhje para Traktatit të paqes së përgjithshme, çështja e Shqipërisë është nga ato me të dhëna nga më pak të njohurat prej publikut francez. Shqipëria nuk është, siç duan ta përfytyrojnë, një vend operete ku [liberti] Meilhac të na ndërtoka aty skenën për "Banditët", apo një shtet i tipit "Girolstein", i bërë vetëm për të qenë teatri i të papriturave qesharake të një princ Wied-i. Është një truall tepër i lashtë që ka luajtur një rol të madh në Histori dhe që është në pritje të një zhvillimi mjaft të rëndësishëm nëse fati i saj rregullohet në një mënyrë të tillë që t'i sigurojë Europës së riorganizuar disiplinim të forcave dhe shfrytëzim të burimeve që zotëron.

Mbase nuk është e kotë të vërehet se përcaktohen me emrin "Shqipëri" të katër ish vilajetet e Turqisë europiane, të njohura me emrin vilajeti i Shkodrës, i Kosovës, i Manastirit dhe i Janinës, emra këto që komunikat nga Orienti i kanë bërë aq të njohura dhe që janë themelet e një njësie të vetme etnologjike, gjeografike e historike. Emërtimi "Albania" është për më tepër krejt konvencional. Termi i vërtetë që duhet të shërbejë për të përcaktuar këto rajone është ai që përdorin vetë banorët e tyre: "Shqipëria", vendi i Shqipës. Ky emërtim ka dobinë se karakterizon shumë saktë krenarinë, fisnikërinë si dhe traditat luftarake e të guximshme të një popullsie malësorësh të palodhur që llogarisin ndër tërëgjyshërit e tyre një mbushulli heronjsh, ndër të cilët më i famshmi është Skanderbegu.

Kombësia shqiptare është me origjinë të largët e misterioze; shkon siç thuhet gjer në epokën primitive të Pellazgëve dhe shqiptarët konsiderohen përgjithësisht si pasues të drejt-përdrejtë të Ilirëve, të cilët kolonizuan të parët brigjet lindore të Adriatikut. Shihet pra se është fjala për një racë tepër të lashtë dhe që mund të rivendikojë me shumë arsye të drejtë për të mos u ngatërruar me asnjë tjetër.

Madje mund të thuhet se vetëdija e një trangu të përbashkët etnik ka shuar mes shqiptarëve grindjet që lindin zakonisht nga larmia e besimeve. Në fakt, praktikojnë tri fe, katolike, ortodokse e myslimane, por në dallim nga popujt e tjerë ballkanikë për të cilët feja dhe kombësia krijojnë një gjë të vetme, ata nuk janë të përçarë nga ndonjë mosmarrëveshje besimi. Përkundrazi, ekziston edhe tradita për disa fise katolike të martojnë djemtë e tyre me vajza nga fise myslimane. Zakon që tregon se deri në çfarë shkalle të lartë familja shqiptare krijon një njësi të plotë të pandashme.

Banorët flasin një gjuhë më vete që nuk ka të bëjë as me sllavishten, as me greqishten, por është me origjinë ilire, mësimi i së cilës u ndalua repte dhe për një kohë të gjatë gjatë sundimit të Turqisë. Bashkësive myslimane dhe ortodokse u imponohej njohja e gjuhës turke apo greke. Nuk mund të mësohej shqipja veçse në shkollat e hapura nga shtetit italian dhe Austria në Skutari, Durazzo e Valona. Edhe pse u përpoqën për ta zhdukur gjuhën shqipe, ajo përsëri mbeti e pacenuar: një provë tjetër e lidhjes së atyre që flasin këtë gjuhë me traditat e atdheut të lashtë.

Tek paraqitëm shkurtimisht këto çështje, cili është fati i Shqipërisë nëpër histori? E pavarur, me gjithë përpjekjet e grekëve për të mos e lënë të tillë, e nënshtruar ndaj romakëve vetëm me anë të tradhtisë, bashkohet rreth heroit të saj kombëtar Skënderbeut në shekullin XV; ky



Whitney Warren

kapedan i madh, që mbante titullin mbret i Epirit e i Maqedonisë mbretëroi në vitet 1443-1467 dhe gjatë tërë kësaj periudhe nuk pati qëllim tjetër veç të siguronte lirinë dhe madhësinë e atdheut të vet kërcënuar nga ambicia turke. Pas vdekjes së tij, lufta për pavarësi zgjati gjatë katër shekujve dhe asnjëherë qeveria osmane nuk arriti të vendosë autoritetin e vet në rajonet malore të vendit; vetëm qytetet iu nënshtruan forcës. Por do të ndodhte sidomos në vitet 1870 që shqiptarët të kërkonin fuqimisht autonominë e tyre. Më 1878, kur Kongresi i Berlinit i dha Malit të Zi dy kantone shqiptare, disa territore Serbisë e të tjera Greqisë, revolta shpërtheu kudo dhe u shtyp veç me gjak. "Lidhja Shqiptare", e themeluar me qëllim që të shpallte e të realizonte kërkesat e saj autoktone, i dyfishoi përpjekjet më 1897 dhe 1903. Më 1908, propaganda e saj dha rezultate të mëdha mes fiseve shqiptare. Programi për pavarësi mori fillimisht një formë krejt parlamentare dhe deputeti shqiptar Ismail Kemal Bej themeloi një parti të re, "Bashkimi Liberal", si kundërvënie ndaj Komitetit "Bashkim e Përparim". Me ardhjen në fuqi të xhonturqve, shkëputja u bë përfundimtare midis Portës dhe Shqipërisë. Që prej kësaj kohe, lufta për pavarësi nuk rreshti një ditë; vijnë kryengritje pas kryengritjesh të Fiseve: më 1911, revolta arrin pikën e saj kulmore, dhe më 1912, në mesin e Luftës ballkanike, Ismail Kemal Bej, themelues i "Bashkimit Liberal", shpall në Valona pavarësinë e vendit të tij dhe krijoi një qeveri të përkohshme. Arrimë këtu në ngjarje që ende janë të freskëta në kujtesë: më 1913, Mbledhja e Ambasadorëve në Londër pranoi që Shqipëria të bëhet një shtet i pavarur; do pasojnë kështu mbretërimi i shkurtër i princ Wied, pëstjellimet, mosmarrëveshjet e nxitura nga Austria, kryengritjet e reja dhe më në fund, largimi i nxituar i princit. Pasandaj erdhi Lufta...

Nga këto fakte, të paraqitura në mënyrë të thatë, qëllimisht, për t'i bërë të mundur publikut të shohë përmbledhtas tiparet themelore të historisë dhe të karakterit shqiptar, del se ka ardhur çasti për Shqipërinë të fitojë një status qëndrueshmërie, për t'i garantuar një autonomi që asnjëherë nuk ka reshtur së kërkuar ndër shekuj, gjatë luftërash të panumërta, si dhe

t'i sigurojë një mbrojtje që e ka të nevojshme për një jetë në paqe, një jetë frytdhënëse e të rregullt. Thuhet: "Përvoja e princ Wied-it vërteton se Shqipëria gjithmonë është e pakënaqur". Nuk ka gjë më të pavërtetë e njëkohësisht më të vërtetë. Që këtej del se ndihma e një Fuqie të madhe është e nevojshme për këtë popull të organizuar keq, jeta politike e të cilit kurrë nuk ka pasur një kuadër të kënaqshëm, por aspak të prirë për një skllavëri të re. Mjaft të shohim shtetet e tjera ballkanike. Greqia fillimisht u mbështet, gjatë kohës së Otonit, nga një organizëm bavarez, pastaj, më vonë, nga një organizëm francez. Bullgaria u ndihmua nga Rusia, si dhe Mali i Zi. Në këtë mënyrë, edhe Shqipëria duhet të gjejë, në vitet e para të hovit të saj të ri, një mbështetje nga jashtë. Ku ta gjejë këtë mbështetje që as Turqia, as Austria kurrë nuk kanë qenë as të denjë, as të aftë për t'ia dhënë, ku tjetër përveçse tek Italia?

Të mos harrojmë se mbi bregdetin italian të Adriatikut, ekziston tashmë një koloni prej 200.000 shqiptarësh që janë vendosur atje për t'iu larguar zgjedhës turke; të mos harrojmë po ashtu se vetëm Italia ka një kuptim të saktë të gjendjes shqiptare. Programi i saj është: "Shqipëria shqiptarëve". Ajo nuk kërkon tjetër veçse të mbështesë kauzën e tyre. Kush mund të thotë të njëjtin gjë ndër shtetet që kanë synuar dhe synojnë ende të vënë dorë mbi atë tokë pjellore?

Përpjekja e bërë nga aleatët tanë gjatë luftës së sotme (mund të shkruajmë tani: "gjatë luftës së fundit"), për të përmirësuar fatin e Shqipërisë dhe për të dëbuar që andej armikun e përbashkët ka qenë e madhe: bëri më në fund të mundur depërtimin e qytetërimin latin në rajone të egra dhe krijoi lidhje mirënjohjeje shumë të forta midis shqiptarëve e italianëve. Për të përmendur vetëm dy shembuj, le të kujtojmë veprën e mësuesve italianë që i vunë vetes si detyrë të përkujdesen krahë për krahë si ndaj fëmijëve katolikë, ashtu dhe ndaj fëmijëve ortodoksë e myslimanë në territoret e pushtuara dhe që aritën rezultate nga më të mirat; le të kujtojmë gjithashtu se që prej vitit 1915, ushtarët italianë çelën mbi 1.000 km rrugë, shtruan një rrjet të plotë linjash telegrafike, telefonike dhe radio-telegrafike, ndërtnuan ujësjellës, kanale vaditjeje, ura, linja elektrike, etj... Atje, si kudo, trupat e xhenios italiane përfunduan kryevepra, konkretisht ndërtime dhe rrugës Vlorë-Sarandë, e quajtur ndryshe edhe rruga e Himarës, duke çarë shkëmbinj e pyje mijëveçare dhe duke zigzaguar guximshëm në rajone dikur të virgjëra. U deshën jo më shumë se 20 muaj për të përfunduar këtë rrugë të përkryer automobilistike, e gjatë 130 km. Ndërmarrje të tilla janë vetëm fillimi i një pune qytetëruese, që të njëjtat duar duhet ta vazhdojnë.

Pozita e Shqipërisë në Adriatik – fqinjësia e saj me vende ku ndikimi latin është ndërjet prej kohësh, ku ndikimi italian, në vazhdë të tij, nuk ka reshtur kurrë së ushtruar një veprimtari bamirësie, qoftë edhe gjatë sundimit austriak – domosdoshmëria para së cilës gjendet Shqipëria për t'u mbështetur mbi një amaturë qytetëruese – vetë dëshira e banorëve të saj, gjithçka përputhet për t'ia besuar Italisë drejtimin e një Shqipërie autonome. Siç shkruan gazeta "Kuvendi", organ i interesave shqiptare: "Drejtuesi i sotëm, mbrojtësi i nesërm mban një emër që askush nuk mund ta shqiptojë pa u përkulur me respekt. Ky emër është "Roma".

Një politikë me synimin për t'i kënaqur të gjithë, ku të ushtronin ndikimin e tyre shumë Fuqi njëkohësisht do të binte ndesh me interesat parësore të kësaj treve dhe do të krijonte një gjendje të papajteshme, të padrejtë, plot rreziqe, të papajteshme me sigurinë për të cilën Europa ka nevojë.

Whitney-Warren
Qytetar Amerikan,
Anëtar i Insittutit.

STUDIMI | LUFTA

NGA DORIAN KOÇI

Gjatë kohës që po pëqeshin kushtet për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, dy nga gjashtë Fuqitë e Mëdha të kësaj kohe, Italia dhe Austro-Hungaria ishin përkrahëse të çështjes shqiptare. Të dyja fuqitë mbanin këtë qëndrim, sepse synonin të kontrollonin Detin Adriatik, porta e madhe e tyre tregtare në Lindjen e Afërt. Këto territore, në fakt prej mëse një gjysëm shekulli ishin zona të ekspansionit të tyre ekonomik. Në të njëjtën kohë Austro-Hungaria dhe Italia, kundërshtonin daljen e Serbisë në Adriatik, pasi shikonin në këtë rast një plotësim të ambicies së Pansllavizmit në rajon. Ndonëse Austro-Hungaria ishte një hap përpara në aspektin politik dhe kulturor, duke se Italia po i kushtonte një rëndësi të veçantë aspektit ekonomik. Kështu në datën 28 shtator të vitit 1913, Herbert Gering, diplomati britanik që sherbeu nga vitet 1911-1915, si konsull i ambasadës britanike në Romë raportonte qendrës si më poshtë:

Kam nderin t'ju raportoj se, në përgjigje të kërkesës sime këtë pasdite, ministri i punëve të jashtme, i cili është kthyer në Romë pas pushimeve verore, më informoi se janë të sakta raportimet e shtypit se ministria e jashtme italiane ka inkurajuar Banca Commerciale Italiana, që të dërgojë një komision me inxhinierë dhe ekspertë financiarë në Shqipëri për të egzaminuar burimet e vendit, me synim për të vlerësuar se çfarë përqindje do të merret prej financuesve italianë në krijimin eventual të Bankës së Shtetit Shqiptar. Markezi i San Xhulianos tha se përveç këtij janë formuar edhe disa komisione të tjera, ngaqë nevojitet shumë informacion lidhur me pasuritë natyrore, me gjendjen e bujqësisë dhe mjetet e zhvillimit të vendit, në tërësi. Me sa kuptova, komisioni i organizuar nga Banca Commerciale do të nisej dje nga Italia dhe besoj se do të nisë investigimin e vet në Shqipërinë e Jugut. (1-Valentina Duka, Dokumenta Britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, Toena, Tiranë, 2012, fq. 111).

Dokumenti i mësipërm tregon se Italia po investonte në Shqipëri dhe së shpejti do të dominonte në ekonominë e brishtë dhe të prapambetur shqiptare. Italianët e shikonin në të njëjtën kohë, Shqipërinë, si një pikë nevralgjike e interesave politike dhe synimeve hegjemoniste të tyre në Adriatik e Ballkan. Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore dhe qëndrimi i dyzuar i Italisë për t'u rreshtuar në njërin apo tjetrin krah, do t'i jepej fund me afrimin dhe plotësimin e interesave të saj strategjike. Periudha nga 1914-1915, karakterizohet nga tratativa të shumta të të dyja palëve, si të Bllokut Qëndror ashtu edhe të Antantës, ku secila dëshironte ta tërhiqte Italinë mbas vetes. Nderkohë edhe pse Vjena kishte interesa gjeostragjike, kryesisht në Shqipërinë Veriore, ajo i njihte Italisë sovranitetin ndaj Vlorës dhe ishullit të Sazanit. Kjo njohje e interesit strategjik ndaj Italisë, ndodhte për arsye se Austro-Hungaria, që kishte në zotërim ende popullsi italiane në perandorinë e vet dhe ndihej e kërcënuar nga jugu.

Vendosja e Italisë në një rol të privilegjuar bëri që ajo të luante dhe ta kishte si në patronazh Shqipërinë dhe çështjen shqiptare. Përfshirja e saj deri në vitin 1914, kishte qenë nëpërmjet diplomacisë tepër aktive dhe mbështetjes së grupeve të



► Kartoline e Vlorës ku duken ushtarë italianë gjatë Luftës së parë Botërore

Lufta e Parë Botërore

Jeta urbane dhe arsimimi në zonën shqiptare të pushtimit italian

Çfarë investimesh u bënë dhe si u administruan krahinat përreth Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës, Përmetit, Kolonjës e Tepelenës, të cilat përbënin një zonë me rëndësi strategjike për Italinë gjatë Luftës së parë Botërore...

patriotëve shqiptarë që përfaqësonin dhe interesat italiane. Mirëpo, pas ngjarjeve të vullshme të rebelimit të Shqipërisë së Mesme, largimit të Princ Vidit nga Shqipëria më 1914, si dhe aktivizimit të ambicieve serbo-greke, Italia e pa të udhës që të ishte e pranishme edhe me trupat e saj në territorin shqiptar, që i konsideronte si vitale për interesat e saj strategjike në Ballkan. Për të dërguar forcat e saj në bregdetin shqiptar, ajo u kap pas rrezikut që Shqipërisë i kanosej nga forcat e ashtuquajtura "vorio-epirote", të formuara kryesisht prej ushtrisë së rregullt greke si dhe të burgosurve ordinerë grekë të amnistuar nga qeveria greke. Rreziku në fakt kishte qenë i madh pasi rebelimi jugor i kishte shërbyer si thikë në shpinë qeverisë së Princ Vidit, por në të njëjtën kohë, propaganda italiane e hiperbolizoi në momentin kur vendosi të ndërhynte në Shqipëri. Deklarata e thirrjes: "Kush prekte Vlorën, prekte Italinë!", në fakt

e nxorri zbuluar ambicien e vërtetë italiane, sesa qëllimet humitare që shpalli në ndërrhyrjen e vet në Shqipëri.

Në 25 dhjetor 1914, kur në Shqipëri vijonte konflikti i brendshëm i armatosur ndërmjet forcave esatiste dhe kryengritësve të Shqipërisë së Mesme, Italia pushtoi Vlorën, duke zbarkuar në fillim me forcat e marinës luftarake dhe pas tri ditësh me forca tokësore. Për shkak të gjendjes së rëndë, që po kalonte vendi, forcat atdhetare shqiptare nuk bënë ndonjë qëndrësë të armatosur. Në kushtet e vështira të brendshme të vendit, reagoi vetëm pushteti lokal në Vlorë dhe disa nga paria e atjeshme. Prefekti i Vlorës, Osman Haxhiu dhe zv/kryetari i bashkisë Ali Asllani i paraqiti konsullit italian në Vlorë një protestë me shkrim kundër pushtimit të Shqipërisë. Me hezitimin e Greqisë, për të marrë pjesë në një nga aleancat e Luftës së Parë Botërore, forcat italiane e zgjeruan rrezin e zbarkimit

të tyre, duke përfshirë pothuajse gjithë Shqipërinë e Jugut.

Zona e pushtimit italian, gjatë Luftës së Parë Botërore përfshinte krahinat përreth Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës, Përmetit, Kolonjës e Tepelenës, të cilat përbënin një zonë me rëndësi strategjike për Italinë. Qytetet që bënë pjesë në zonën e pushtimit italian ishin kryesisht qytete të vogla, përveç Gjirokastrës e cila numëronte rreth 11.000 banorë, popullsia e qyteteve të tjera nuk ishte më shumë se 5 mijë secili. Administrimi i qyteteve dhe zonave rreth tyre ishte me dorë të hekurt, përta i përket marrjes së vendimeve administrative, por shumë më efektiv se ai i mëparshëm osman, përta i përket krijimit të një kulture administrative, që do të vendosej në themelet e shtetit shqiptar pas viteve 20'.

Që në fillim të vendosjes të forcave italiane në Vlorë, komanda e tyre mori menjëherë masa me karakter administra-



► Ushtarë italiane në Sarandë, 1920

tiv. Në Vlorë, ata vendosën pranë Prefekturës dy këshilltarë, njërin për çështjen e përgjithshme politike, tjetrin për çështjet financiare. Kjo masë administrative e nxirte në plan të dytë Prefektin e Vlorës, Osman Haxhiun. Pushtuesit cënuan rëndë edhe kompetencat e organeve të zgjedhura, siç ishte bashkia. Tani këshilltari italian pranë kryetarit të bashkisë diktonte gjithçka dhe asnjë nëpunës shqiptar nuk kishte të drejtë të vepronte pa urdhërat e italianëve. Italianët vunë dorë edhe mbi gjyqet e doganës e qytetit. Administrata e doganës u mbush me nëpunës italianë, të cilët shtinë në dorë bashkë me të ardhurat e saj, edhe rreth 100 000 fr.ar, të depozitës doganore.(3-Valentina Duka, Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924, Toena, Tiranë, 1997, fq. 57) Ata e shkëputën Vlorën nga pikpamja administrative prej pjesës tjetër të vendit. Administrata e re ushtarake, e cilia u vendos në Shqipëri, e filloi jetën mbi një truall të zbrazët nga pikëpamja financiare dhe e dokumentacionit, sepse funksionarët grekë kur u larguan nga këto vise, morën me vete shumicën e regjistrave, shkresat dhe të hollat e arkës publike.

Gjatë administrimit të tyre, italianët, bënë edhe një organizim të ri të bashkive. Ata i kushtuan vëmendje të veçantë shtimit të të ardhurave të tyre financiare, duke vendosur rregulla të forta në drejtimin e mbledhjes së taksave, si dhe duke kontrolluar rigorozisht hyrjet dhe daljet në arkën bashkiake. Në këto kushte bilanci buxhetor i bashkive u mit mjaft. Kështu p.sh. buxheti i bashkisë së Gjirokastrës nga 40 000 lireta që ishte në vitin 1917, u rit në 402 000 lireta në vitin 1918; i Sarandës nga 74 000 lireta në 85 000 lireta; i Përmetit nga 24 376 lireta në 46 000 lireta. Një pjesë e mirë e këtyre të ardhurave, u përdorën për punëra të ndryshme publike, një pjesë e të cilave janë në funksion edhe sot si godina administrative. Lehtësimi nga pushtimi i ashpër grek i Shqipërisë së Jugut si dhe investimet publike që filluan, e rritën ndjeshëm imazhin e Italisë në sytë e popullsisë shqiptare, por ky imazh do të dëmtohej rëndë dhe gati në mënyrë të pariparueshme pas denoncimit dhe marrjes vesh nga opinioni publik në nëntor 1917, i Traktatit të Fshehtë të Londrës. Traktati i Londrës u nënshkrua më 26 prill 1915, nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, të Francës dhe të Rusisë në njërin

anë dhe të Italisë në anën tjetër. Përfundimi i kësaj marrëveshjeje ishte të kënaqte lakmitë italiane dhe ta rreshtonte atë për krahu Antantës. Shqipërisë, ashtu si dhe më parë në Konferencën e Ambasadorëve, sërish i cënoheshin territore dhe shteti i gjymtuar shqiptar vendosej nën tutelën italiane për t'u përfaqësuar në komunitetin ndërkombëtar.

Traktati i Londrës i vitit 1915 ka hyrë në histori si një ndër aktet kryesore të diplomacisë së fshehtë. Ai është në të njëjtën kohë një ndër aktet ndërkombëtare më tipike të periudhës së imperializmit në përgjithësi. Nga arsenalit i diplomacisë zor se ka dalë një akt tjetër si ky, që ta karakterizojë më mirë thelbin e politikës së Fuqive të Mëdha ashtu dhe metodat e saj. Duhet theksuar se në gjithë këtë traktat asgjë tjetër nuk e nxjerr aq qartë natyrën e vërtetë të imperializmit, të politikës së tij sidomos ndaj vendeve të vogla, sesa ajo pjesë, që bën fjalë për Shqipërinë e fatin e saj.(4-Arben Puto, Çështja Shqiptare në

Gjatë administrimit të tyre, italianët, bënë edhe një organizim të ri të bashkive. Ata i kushtuan vëmendje të veçantë shtimit të të ardhurave të tyre financiare, duke vendosur rregulla të forta në drejtimin e mbledhjes së taksave, si dhe duke kontrolluar rigorozisht hyrjet dhe daljet në arkën bashkiake

aktet Ndërkombëtare të periudhës së Imperializmit, vëll.II, 8 Nëntori, fq.151).

Nenet që i referohen direkt Shqipërisë ishin nenet 6 dhe 7. Neni 6 i kushtohej kërkesës kryesore të Italisë, së cilës i përgjigjet duke parashikuar "soveranitetin e plotë italian mbi Vlorën, mbi ishullin e Sazanit dhe mbi një territor të gjerë sa të siguronte mbrojtjen e atyre pikave". Zotërimi i këtij hiterlandi të gjerë ishte kryeura, që diplomacia italiane kish synuar prej kohësh në Shqipëri. Në nenin 7 bëhej një ndarje e "plaçkës", ku përfshihej edhe optimi i ri i Shqipërisë. Tani Italisë me këtë formulim i jepej për të përfaqësuar një shtet shqiptar në marrëdhëniet me jashtë. Mirëpo ngjarjet evoluan në terren më shumë sesa mund të mendohej. Administrimi i territoreve të Shqipërisë së Jugut, që kishte qenë dhe truallit ku nacionalizmi shqiptar kishte operuar më tepër dhe pjesa më e urbanizuar e Shqipërisë, me qytete të spikatura si Korça, Berati dhe Gjirokastra, rezultoi të ishte jo i lehtë për autoritetet italiane dhe për më tepër pavarësia e Shqipërisë e panegociushme nga qarqet patriotike nacionaliste. Ky presion për të ardhmen e Shqipërisë ishte arsyeja, që i detyroi italianët që gradualisht, të ndryshonin mendim dhe metodë për përfaqësimin e tyre ndaj çështjes shqiptare edhe pa u publikuar teksti i plotë i traktatit në gazetën ruse "Izvetia" në nëntor 1917.

Në 3 qershor 1917, italianët shpallën proklamatin e tyre në Gjirokastrë ku shqiptarëve u jepeshin disa të drejta.

GGJITHË POPULLIT SHQIPTAR!

Sot më 3 qershor 1917, në ditën e përvjetorit të lirive kushtetuese italiane, ne, gjeneral kolonel Xhiacinto Ferrero, komandati i korparmatis XV, me urdhër të qeverisë së mbretit Viktor Emanuelit III, shpallim sollemnisht unitetin dhe pavarësinë e gjithë shqipërisë nën egjiden dhe mbrojtjen e Mbretërisë së Italisë.

Shqipëtarë! Me këtë akt ju, shqiptarë do të keni institucione të lira, milici gjyq, shkolla të drejtuara nga qytetarë shqiptar; do të mund t'i administroni vetë pasuritë tuaja, në të mirën tuaj profesionale dhe për mirqënie gjithnjë më të madhe të vendit tuaj.(5-Eqerem bej Vlora, Kujtime 1885-1925, IDK, fq. 432).

Ai ju bënte thirrje shqiptarëve të mernin armët dhe të kujtonin traditat e lidhjeve të

dy brigjeve të Adriatikut gjatë Perandorisë Romake, ku dhe u kujtonte shqiptarëve se veç një det i ndante me Italinë. Në proklamatin rithekshej sërish miqësia me Italinë dhe se Shqipëria do të kishte mbrojtjen e Italisë për t'i garantuar pavarësinë. Mirëpo gjatë kësaj kohe kemi edhe një notë kundër proklamatin për protektoratin italian në Shqipëri. Establishmenti ushtarako-politik i Italisë nuk mund të binte dakord me lëshimin e Vlorës dhe kujdestarinë ndaj shtetit të cunguar shqiptar.

Gjithësesi, pavarësisht kundërshtimeve në aspektin politik të pavarësisë së Shqipërisë, autoritet italiane për të fituar prestigj dhe influencë në sytë e popullsisë vendase, i kushtuan kujdes të madh, si sistemit urbanistik, ashtu edhe riparimit të infrastrukturës. Në fushën e arsimit, ata mbyllën shkollat fillore greke dhe në vend të tyre hapën shkolla fillore në gjuhën shqipe dhe italiane. U hapën kurse për arsimtarë shqiptarë si në Gjirokastrë edhe në Vlorë, si dhe u sollën nga Italia mjete mësimore dhe një sërë librash shkollorë. Gjatë kësaj periudhe u hapën spitale, u ngritën ferma, u kushtua vëmendje punëve publike dhe u inkurajua prodhimi bujqësor. Të gjitha investimet italiane ishin të rëndësishme, por ato në fushën e arsimit fituan një rëndësi më të madhe kulturore duke pasur parasysh gjendjen e shtetit të ri kombëtar, shqiptar. Lufta e parë botërore e gjeti të brishtë edhe arsimin shqiptar. Trevat shqiptare u ndanë në katër zona pushtimi ku secili nga këto shtete pushtuese imponuan mënyrën e tyre për përhapjen e arsimit. Shumë intelektualë shqiptarë u ngritën me kërkesat e tyre për të pasur një arsim të unifikuar kombëtar. Ndër të tjera ata këmbëngulën që gjuha shqipe të bëhej gjuhë zyrtare dhe të përdorej edhe në shkolla si dhe të organizohej rrjeti i shkollave shqipe. Në të njëjtën kohë kërkoheshin hapja e kurseve të shpejta për përgatitjen e mësuesve, ngritjen e shkollave profesionale me synim që të kalohet nga puna e thjeshtë e dorës në artizanat, të hapeshin konvikte ku të strehohen sidomos nxënësit e aftë që vinin nga zonat e largëta. Gjithashtu, të dërgoheshin nxënës për studime të mesme dhe të larta në shkolla të ndryshme në Evropë.

Në zonën e pushtimit Italian u mbyllën shkollat në gjuhën Greke dhe u hapën shkolla fillore në gjuhën shqipe, në të cilat dominonin mësues Italianë dhe mësimi i italishtes filloi të zinte vendin e parë....

STUDIMI | LUFTA

vijon nga faqja 18-19

...U hapën kurse të shkurtra për arsimtar shqiptar si në: Gjirokastrë dhe Vlorë, ku morën pjesë 135 veta dhe u sollën nga Italia mjete mësimore dhe libra shkollorë. (6-Valentina Duka, Historia e Shqipërisë 1912-2000, kristalina-KH, Tiranë, 2007, Fq. 96).

Ndërkaq, qeveria italiane në qarkun e Vlorës dhe të Gjirokastrës krijoi një administratë ushtarake, që drejtohej nga specialistë italianë. Në këtë zonë shkoi duke u rritur numri i shkollave. Çdo shkollë kishte mësues shqiptar dhe mësues-ushtarë italianë. Mësimi i gjuhës italiane ishte i detyrueshëm. Për aftësimin e mësuesve shqiptarë në Vlorë u organizuan kurse të shkurtra, ndërsa në vitin 1917 u dërguan edhe 25 vetë, ku ndoqën një kurs 3 mujor pedagogjik. Shkollat punonin sipas programit të shkollave italiane. (7-Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, fq. 330).

Në vitin shkollor 1917-1918, në Gjirokastrë u hap edhe një shkollë qytetëse me profil tregëtar, në të cilën të gjitha mësimet të bëheshin në italisht. U bënë përpjekje për të çelur edhe shkolla me profil artizanale e bujqësor, por këto ngelën të parealizuara. Të udhëhequr nga interesat e veta ushtarake, politike dhe ekonomike italianët u kushtuan rëndësi të madhe qytetit të Vlorës dhe zonës përreth tij. Në këtë qytet ata ndërtuan çdo gjë që duhej nevojave të frontit. Në radhë të parë ata bënë një sërë punimesh drenazhimi në periferi të qytetit dhe ngritën institucionin italian të post-telegrafës. Gjithashtu me shpenzimet e prefekturës së Vlorës ngritën spitalin civil të qytetit me kapacitet 50-60 shtretër. Komanda për nevojat e ushtrisë bllokoi gjithë lokalet me pronësi shtetërore. Italia ndërtoi edhe disa pallate e barka për të sistemuar ushtarët. Në të njëjtën kohë italianët montuan edhe një central elektrik për ndriçimin e limanit dhe të rrugëve kryesore të qytetit. U montuan tubacione të ujit të pijshëm, si dhe ujrave të zeza.

Mullinjtë e blojës me motor edhe preset hidraulike të vajit, të vetmet njësi industriale të trashëguar në vitet e mëparshme, u vunë në shërbim të luftës. Në shpinë të godinës së bashkisë u ndërtuan edhe një sërë magazina dhe furrash. Për qëllimet e saj komanda italiane ndërtoi edhe një oficinë mekanike. Ata ndërtuan edhe një fabrikë tullash dhe një punishte lëkurësh. Shoqëria italiane "SIMSA", me qendër në Romë, bleu minierën e Selenicës së Vlorës kundrejt një shpërblimi prej 1 700 000 liretash. (8-Valentina Duka, Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924, Toena, Tiranë, 1997, fq. 159). Gjithashtu u ndërtua edhe një fermë bujqësore.

Autoritetet italiane i kushtuan shumë rëndësi edhe sistemit urbanistik të qyteteve të tjera në Shqipërinë e Jugut. Në qytetin e Gjirokastrës u restaurua godina e prefekturës. Restaurime u bënë edhe në ndërtesat ku u vendosën ambulanca, jetimorja, bashkia dhe policia e qytetit. U ndërtua një shesh i madh në qendër të qytetit, u ndërtuan banesa për akomodimin e oficerëve italianë, si dhe magazina për sistemin e mallrave të ndryshëm. Ata kryen edhe një sërë punimesh për të ndërtuar ujësjellsin e Sopotit, i cili do t'i siguronte Gjirokastrës ujë të pijshëm. Në Sarandë u ndërtua një magazinë ushqimore, e cila lidhej me portin me anë të një dekovili, që shpejtonte ngarkim-shkarkimin në të. Gjithashtu u ndërtuan edhe godinat e nën-prefekturës dhe bashkisë së qytetit të Leskovikut, si dhe u sistemuan një sërë rrugësh në qytetin e Delvinës dhe Tepelenës. (9-Valentina Duka, Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924, Toena, Tiranë, 1997, fq. 60). Pjesa më e madhe e këtyre ndërtimeve u bë duke shfrytëzuar fondet e prefekturave dhe të bashkive. Edhe ekonomia e qyteteve u vu në shërbim të luftës. U bë edhe projektimi i një tipografie, e cila do



► Ushtarë italianë në Vlorë, 1920

Lufta e Parë Botërore

Si u ndërtua rrjeti rrugor në Shqipërinë e Jugut nga ushtritë pushtuese

Për nevojat e tyre ushtarake ushtritë pushtuese austriake, italiane e frënge ndërtuan me shpejtësi rreth 1 000 km rrugë të improvizuara. Pjesa më e madhe e tyre (rreth 650 km) u ndërtuan nga ushtria austriake, ndërsa rreth 200 milje u ndërtuan nga ushtria italiane...

të lidhej me një shkollë artizanale, çka nuk u arrit të realizohej.

Komanda italiane rëndësi i kushtoi edhe edhe marrëdhënieve tregëtare, brenda zonës së pushtimit. Kjo për arsye edhe sepse Italia i shikonte këto marrëdhënie edhe si mjet të rëndësishëm për të forcuar pushtetin e vet politik dhe ekonomik. Skela kryesore ku realizoheshin këto, ishte Vlora. Gjatë vitit 1917 kemi një rritje të madhe të importit, sidomos miellit dhe misrit, për shkak të nevojave të mëdha që kishte në to ushtria pushtuese dhe tregu vendas. Në vitet 1917-1918 kemi edhe rritjen e eksportit. Ritja e vlerave gjatë këtyre viteve shpjegohet me blerjen prej palës italiane të sasive të mëdha të leshtit të përpunuar e të vajit të ullirit. Për hir të interesave të tyre ekonomike dhe strategjike, pushtuesit italianë, ashtu si ata francezë dhe Austro-hungarezë, bënë eksplorime për naftën dhe qymyrgurin në zonën e tyre të pushtimit. Për këtë qëllim italianët kryen edhe një sërë punimesh për hapjen e rrugëve të ndryshme.

Hapat e para për ndërtimin e një rrjeti rrugor u hodhën që në fillim të pushtimit. Për nevojat e tyre ushtarake ushtritë pushtuese austriake, italiane e frënge ndërtuan me shpejtësi rreth 1 000 km rrugë të improvizuara. Pjesa më e madhe e tyre (rreth 650 km) u ndërtuan nga ushtria austriake, ndërsa rreth

200 milje u ndërtuan nga ushtria italiane. Me rrugët që u ndërtuan nga ushtria italiane u lidh Vlora me Gjirokastrën, me Përmetin, me Delvinën dhe me Sarandën. Ushtritë franceze që kishin pushtuar qarkun e Korçës, ndërtuan vetëm rrugë me karakter vendor. (10-Akademja e Shkencave, Histori e Popullit Shqiptar Vëllimi II, Toena, Tiranë, 2002, fq. 106). Përveç këtyre, ushtritë austriake e italiane, gjithmonë për interesat e tyre ushtarake, ndërtuan gjatë Luftës së Parë Botërore një rrjet dekovili, me një gjatësi prej 350 km. Dekovili i ndërtuar nga ushtria italiane pati karakter vendor dhe ndryshonte nga ai ndërtuar nga Austro-Hungaria, i cili lidhte qytetet më të rëndësishme. Ky sistem rrugor ishte shumë i dobët dhe nuk i lidhte të gjitha krahinat e Shqipërisë. Qytetet e Shqipërisë Veriore nuk lidheshin me ato të Shqipërisë Jugore dhe të dyja këto pjesë ishin të shkëputura nga viset e Shqipërisë Juglindore. Qeveria italiane projektoi edhe ndërtimin e një hekurudhe transballkanike, e cila do të fillonte në Bari e do të përfundonte në Stamboll. Puna për ndërtimin e kësaj hekurudhe njohu vetëm fillimet e saj, sepse rrjedha e ngjarjeve të mëvonshme e detyroi Italinë t'i pezullonte punimet.

Edhe pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore Italia vazhdonte të ishte prezente në Shqipëri, sidomos në zonën e Vlorës, të cilën

vazhdonte ta kishte nën administrim. Gjatë fundit të vitit 1919 dhe fillimit të vitit 1920 patriotët shqiptarë menduan të mbanin një kongres të madh dhe në këto momente të vështira Lushnja ishte qyteti më strategjik dhe që i plotësonte kushtet, pasi ai ishte një qytet në qendër të vendit, ku delegatët do ta kishin shumë më të lehtë për të ardhur e për të marrë pjesë në Kongres. Mbatja e Kongresit të Lushnjës ndeshi në kundërshtimin e qeveritarëve të Durrësit dhe të pushtuesve Italianë, por më në fund ai arriti të mbahej duke marrë vendime shumë të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë. Vendimet e tij ngjallën jehonë të madhe në qarqet patriotike shqiptare dhe u përshtetën ngado. Aty u arrit një bashkim politik i një aleance të të gjitha shtresave e grupimeve politike, e cila i dha shpejt frytet e saj. Rezultati i parë i Kongresit të Lushnjës ishte organizimi dhe mbështetja e Luftës së Vlorës që garantoi tërësinë territoriale të Shqipërisë të njohur ndërkombëtarisht në 1913. Lufta e Vlorës i dha fund pushtimit italian në Shqipëri dhe kohezionin e duhur të brendshëm shqiptarëve për të marrë fatet e vendit në duart e veta. Kjo tendencë në mendimin patriotik shqiptar do të mbizotëronte si ide gjatë gjithë rrugëtimit të mëvonshëm shtetformues shqiptar.

Durrës, dyshohet zhdukja e një helmete ilire 2 orë pas zbulimit

Historiana Sonila Boçi: Zbulimet arkeologjike rrezikojnë zhdukjen nga punimet



DHURATA HAMZAI
TIRANE

Kanë marrë përmasat e një skandali të madh punimet për projektin e Bashkisë së Durrësit për të ndërtuar një Velierë betoni. Megjithatë u dha një vendim për ndërprerjen e punimeve, ato ende po vijnë dhe kjo ta tronditur specialistët e historisë dhe arkeologjisë që kanë shkuar në vendngjarje. Historiana e njohur Sonila Boçi Pepivani ka shkuar në Durrës ditën e premte dhe është shokuar para zbulimeve të topave dhe predhave të periudhës osmane. "Ajo që më shqetësoi dhe që e ngrita zërin është pikërisht kjo gjë, që ne nuk e dimë se si është marrë në Këshillin Bashkiak të Durrësit vendim për të ngritur gjithçka pa marrë më përpara, nëse është marrë apo jo nuk e dimë sepse nuk ka transparencë, është marrë apo



Sonila Boçi

nuk është marrë një vendim nga njerëzit e specializuar për këtë punë dhe ndodhi ajo që ndodhi. Është zbuluar një gjë e jashtëzakonshme, është një ndërtesë qeveritare e peri-

udhës osmane, duhet të jetë diku te fundi i shekullit 18, fillimi i shekullit 19, kjo nuk ka rëndësi fare nëse është e periudhës së vonë sepse gjithsesi është trashëgimi historike dhe nga mënyra se si ndërtohej në periudhën osmane ata merrnin gur gjithandej dhe aty mund të ketë gur edhe të periudhës ilir", u shpreh Boçi.

Ndërsa lajmëron zbulimet e tjera që janë bërë, ku bëhet fjalë për një top tjetër të periudhës osmane, pas atij që doli në dritë gjatë gërmimeve për Velierën, historiana Boçi pohon se miqtë i kanë thënë se kanë dalë në dritë, edhe objekte ilire, dhe se një helmetë ilire është parë të dalë nga gërmimet dhe pas dy orësh është zhdukur. "Janë zbuluar edhe të tilla gjetje dhe duhet të kishte arkeologë të cilët minimalisht t'i merrnin këto gjëra dhe t'i skedonin dhe t'i shënonin në procesverbal. Isha dje në Durrës dhe pashë me shumë dhimbje se aty ishin të zbuluara disa gjyle topi të rrumbullakëta në mënyrë perfekte, kishte

bazamente që mu dukën qartazi të periudhës ilire. Një koleg miku im nga Durrësi po më fliste për një tip që atij i ishte dukur si përkrenare ilire që e kishte parë në atë zonë dhe më tej s'e kishte gjetur më, s'e kishte parë më", shprehet ajo. Historiana Boçi pohon se është i gabuar mbulimi me beton i këtyre objekteve arkeologjike, sepse ka dëshmi të trashëgimisë historike.

DYSHIMET

Por gjetja e një përkrenare ilire nuk konfirmohet nga specialistët

që janë kujdesur për këto objekte me vlerë, por përkundrazi, mohohet ekzistenca e një objekti i till. Tashmë mbetet për t'u konfirmuar nga institucionet nëse ka pasur përkrenare apo gjithçka ngelet në kuadrin e dyshimeve të paprovuara. Një ditë më parë edhe arkeologu Eduard Shehu, njëherësh mbikqyresi i punimeve pohoi se rrënojat, i përkasin një objekti të periudhës osmane, i cili është rrëzuar në vitin 1926 për t'i çelur udhë rrugës dhe sheshit përpara portit detar.

GJIROKASTËR

Dy autorë italianë promovojnë librin për Musinenë

M Mauro Geraci dhe Simonetta Ceglie, dy autorë italianë të librit "Musine Kokalari, Jeta Ime Universitare", kanë shkuar në Gjirokastrë për 100-vjetorin e lindjes së heroinës së demokracisë. Qëllimi i udhëtimit nga Italia në Shqipëri ka qenë promovimi i librit në italisht, ku flitet për jetën dhe krijimtarinë e Musine Kokalari. Banesa Kadare, ishte zgjedhur për të shfletuar disa pjesë nga ky libër i cili mbart në vetvete, disa pjesë jetë ende të pazbardhura të Musine Kokalari kohën kur ka qenë me studime në Romë. Autorët e këtij libri rrëfejnë aktivitetin e Musine Kokalari në Romë, krijimtarinë e saj letrare dhe veçantinë në vargjet poetike. Mauro Geraci, autor i librit: "Musineja ka një karakter personal. Ajo ka studiuar në të njëjtin universitet ku kam studiuar unë në të njëjtin qytet, ka banuar në një shtëpi që ende edhe sot banohet nga disa miq e të afërm të mij pra janë korrespondenca të karakterit personal. Ndërsa gjëja që më ka bërë përshtypje për shkrimtaren dhe veprën e saj letrare, është sesi ajo arrin të jetë në të njëjtën kohë e fortë, militate nga këndvështrimi sentimental-politik dhe në të njëjtën kohë e ëmbël. Poezia është e ëmbël shumë e rafinuar. Ajo ndalet tek dhimbjet e grave që nuk mund të dilnin nga shtëpia, madje flet edhe për gratë fantazma që vësh-

tronin pas dritareve të banesave të Gjirokastrës dhe që nuk mund të dilnin përpara se të martoheshin. Poezia e Musinesë është denoncuese, ajo nuk ka një vizion ilirik sentimental apo triumfues të kulturës popullore shqiptare sic e kishin autorët e Rilindjes apo të apostujve të Rilindjes Shqiptare. Por ajo në fakt nga bota popullore, denonconte mjerimin, varfërinë, urinë, vuajtjen, raportin me pushtetin një poezi shumë shqërore, pjesa tjetër është e lidhur me poezinë e letërsinë e mjeshtërive të tillë si Migjeni, Enrest Koliqi, Mitrush Kuteli, Lasgush Poradeci. Këta janë poetët e saj të referimit. Një letërsi etnografike dhe veprat e saj janë njëkohësisht vepra letrare dhe vepra shkencore. Është një dokumentim etnografik". Simon-



etta Ceglie, autore e librit: "Jeta e saj universitare nuk tregon vetëm jetën e saj në Romë. Gjithçka shihet

përmes syve të saj. Ky libër është pasqyrë e shpirtit të saj, është një shkrim i thjeshtë dhe shprehës. Kur

dikush e lexon dhe bie në kontakt me shkrimin e saj, ai ndjehet Musine dhe në fund kupton që është një reflektim për jetën e saj. Në aktivitet ka qenë e pranishme ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro dhe familjarë të Musine Kokalari. Zonja Kumbaro përveçse falenderoi autorët e librit për Musinenë, dha sqarime edhe për simbolikën e çeljes së dosjes së parë të Sigurimit të Shtetit për Musine Kokalari, si dhe dha lajmin e rehabilitimit të banesës Kokalari e cila sipas saj, do të jetë një bashkëpunim mes familjes Kokalari dhe ministrisë që ajo drejton". Aktiviteti i djeshëm u organizua në kuadër të 100 vjetorit të lindjes së disidentit Musine Kokalari ku organizatore ishte Ministria e Kulturës dhe Konsullata e Nderit të Italisë në Gjirokastrë.

TIRANË

Marshimi sensibilizues "Një shtëpi muze për Fishtën"



Dhjetra të rinj janë bërë bashkë këtë të shtunë në Tiranë për të sensibilizuar qytetarët dhe organet kompetente për të ndërtuar një muze për Gjergj Fishtën në fshatin Fishtë. Me bluza të bardha me mesazhe të ndryshme dhe me maska me fytyrën e Fishtës të rinjtë kanë marshuar

në mënyrë paqësore nga bulevardi "Dëshmorët e Kombit" drejt sheshit "Nënë Tereza". Nisma studentore "Një shtëpi, një muze për trashëgiminë kulturore" synon që me ndihmën e Ministrisë së Kulturës dhe të donatorëve të ndërtojnë një muze për poetin e madh Gjergj Fishta.

Sipas tyre muzeu do të ndërtohet në themelet e shtëpisë ku "Homeri" i Shqipërisë ka jetuar për 6 vjet. Fishta ka luajtur një rol kryesor në krijimin e alfabetit shqiptar, ka qenë deputet i parlamentit shqiptar dhe ka patur një kontribut të vyer në krijimin e identitetit shqiptar.

Kukësi ka fituar me përmbysje 2-1 në kryeqytet ndaj Tiranës, duke ruajtur avantazhin prej 4 pikësh nga vendi i dytë, që tashmë mbahet nga Skënderbeu i vetëm, pas fitores së korçarëve 1-0 ndaj Laçit.

Në ndeshjen me Tiranën, Kukësi u gjend në disavantazh, por bardheblutë "shkatërruan" vetë gjithçka të mirë që bënë në pjesën e parë. Tirana e pjesës së dytë luajti aq dobët sa në fund të ndeshjes pati shumë dyshime për një lëshim të qëllimshëm nga ana e skuadrës bardheblu. Këto zëra u ngritën nga tifozët e thjeshtë, por edhe nga një politikan si deputeti i PS, Erjon Braçe. Deputeti nëpërmjet një statusi në facebook e ka quajtur rezultatin e kësaj ndeshje si të paracaktuar. "Çfarë turpi!... Këtu nuk ka fitues nga gara, këtu fitues të paracaktuar", shkruan ndër të tjera Braçe. Deputeti jo vetëm ka akuzuar hapur dy ekipet për një kurdisje, por edhe mendon se kjo është prova reale se ai ka pasur gjithmonë të drejtë kur akuzonte kreun e FSHF-së, Armand Duka.

Për sa i takon ndeshjes, në pjesën e parë Tirana edhe pse me disa lojtarë të rinj në përberje luajti më mirë dhe pati epërsi në lojë ndaj Kukësit. Kjo u konkretizua edhe me përsi në rezultat, kur në 39 pas një goditje dënimi, portiere Koliçi nuk kontrolloi topin siç duhet. Sfera përfundoi te Hoxhallari dhe ky i fundit gjeti Takun, i cili pak hapa larg portës, nuk e ka të vështirë të dërgojë topin në rrjetë. Në pjesën e dytë Tirana ishte gati ekip tjetër duke ja bërë më të lehtë Kukësit të ndryshojë "fytyrë", me Pejcin, që pas 45 minutave të para në hije u rikthye protagonist i golit në këtë kampionat duke shënuar golin e barazimit në të 57-tën. Tirana shfaqti vendosje të pasigurta në mbrojtje, me portiere Lika që në më shumë se një rast mbajti në lojë skuadrën me pritjet e tij nga Pejci, që për peshën që ka aty përpara, u harrua shumë shpesh në zonë gjithsesi në këtë moment paniku për Tiranën, Cisse për pak sa nuk ndryshoi rrjedhën e ndeshjes duke humbur golin e 2-1 për Tiranën. Megjithatë Kukësi që po bënte gjithçka për të fituar, arriti ta gjejë epërsinë



Kukësi ruan distancën nga vendi i dytë

Verilindorët mundin 2-1 Tiranën, Skënderbeu 1-0 Laçin

KATEGORIA SUPERIORE

JAVA E 21-TË

■ Tirana – Kukësi	1 - 2
■ Skënderbeu -Laçi	1 - 0
■ Vllaznia - Flamurtari	3 - 2
■ Teuta - Partizani	0 - 0

SOT

■ Luftëtari – Korabi

RENDITJA

■ 1 Kukësi	45
■ 2 Skënderbeu	41
■ 3 Partizani	39
■ 4 Tirana	27
■ 5 Luftëtari	25
■ 6 Vllaznia	24
■ 7 Flamurtari	20
■ 8 Teuta	20
■ 9 Laçi	20
■ 10 Korabi	11

e kërkuar në të 83-tën me Eminin. Goli vulosi dhe mbylljen e ndeshjes me skuadrat që nuk rrezikuan më. Kukësi ruajti epërsinë ndaj rivalëve në klasifikim duke mposhtur për herë të parë Tiranën në këtë kampionat, që bëri realisht ndeshjen më me "hënë" të të gjithë kampionatit.

NDESHJE E ÇMENDUR NË SHKODËR

Vllaznia dhe Flamurtari kanë dhuruar një ndeshje të çmendur në Shkodër, një nga më të bukurat e këtij sezoni ku gjithçka ndryshoi në mënyrë të vazhdueshme në minutat shtesë. Flamurtari shënoi me anë të Bushiç në pjesën e parë dhe krijoi edhe disa raste të tjera, por nuk arriti të mbyllte ndeshjen. Nga ana tjetër, Vllaznia qëndroi në sulm gjatë gjithë kohës dhe u shpërblye me Hebajn në minutën e 76. Shkodranët gjetën rrjetën në minutën e 90, kur Bakaj shënoi atë që men-

dohej se do të ishte goli i një fitoreje të shkëlqyer. Por vetëm pak sekonda më vonë, Bushiç ndëshkoi përsëri ish-ekipin e tij, duke barazuar shifrat. Megjithatë, asgjë nuk kishte mbaruar, pasi një harkim nga e majta gjeti Pjeshkën në zonë dhe futbollisti i ri gjuajti me kokë duke realizuar golin e fitores 3-2 që largon përsëri Vllazninë nga fundi i klasifikimit ndërsa mban në zonën e rrezikut Flamurtarin.

SKËNDERBEU KALON LAÇIN

Skënderbeu kalon me sukses Laçin, rezultati nuk ndryshon është 1-0 si dy ndeshjet e para në kampionat, edhe këtë herë vendos një gol i Hamdi Salihit. Pavarësisht rezultatit minimal kampionët shfaqën një lojë më të mire duke mos e vënë në dyshim asnjëherë fitoren e tyre. Pas kësaj fitoreje vendi i dytë është i Skënderbeut, me Partizanin që mbetet dy pikë pas.


ATLETIKË

3.000 metra, Luiza Gega e treta në Mitingun e Parisit

Luiza Gega vazhdon të mbajë lart flamurin shqiptar në arenën ndërkombëtare të atletikës. Nënkampionia e Europës arriti një kohë të jashtëzakonshme në Mitingun Ndërkombëtar të Parisit. Në debutimin e vitit 2017, Gega zuri shkallën më të ulët të podiumit mes 13 atleteve të tjera në garën e 3 mijë metrave për sallat e mbyllura. 8 minuta, 52 sekonda e 53 të qindtat ishte koha e atletes shqiptare, e cila vendos në këtë mënyrë edhe re-

kord kombëtar pasi e përmirëson rekordin paraardhës me rreth 37 sekonda. Një garë përgatitore për Luiza Gegën e cila do të marrë pjesë gjatë muajit Shkurt edhe në Ostrava të Çekisë në disiplinën e 1500 metrave, ndërsa më pas do të jetë e pranishme në Kampionatin Ballkanik për të rritur të sallave të mbyllura që mbahet në Beograd ku bashkë me të, Shqipëria do të ërfaqësohet edhe nga 5 atletë të tjerë. Një

ndalesë e veçantë sezonale për Luiza Gegën do të jetë Europiani i Atletikës për sallat e mbyllura që do të zhvillohet po në Beograd. Sipas presidentit të Federatës Shqiptare të Atletikës, Gjergj Rruli, në evenimentin që starton në datën 3 Mars, nënkampionia e Europës do të garojë në 1500 dhe 3000 metra, ndërsa një tjetër atlet shqiptar pjesëmarrës në këtë eveniment do të jetë edhe Izmir Smajli në hedhjen së gjati.



Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Nisi punën në Fast Food në Durrës tani shëf kuzhine në Gjermani
- Itali, Bes Kallaku pjesë e spektaklit të humorit, 'skifteri në shtëpinë e tij'
- Grabitja e 2,7 milionë €, rojet: I fikëm kamerat se do pinim kafe
- Krimi në Fier, 29-vjeçarja që u vra nga i dashuri ishte shtatzënë
- FOTO/Merr formë Bulevardi i Ri i Tiranës, nis mbjellja e pemëve
- Rruga e Arbërit, paraqitet ofertë financiare nga një kompani
- Ngjela: Sali, kujdes! Lu ishte me shërbim kur u vra Bin Ladeni
- Turma sulmoi Musinën, i shkëlën gjysmën e flokëve/ Letra sekrete
- Krimi i pasionit në Fier, ja të rinjtë që kishin lidhje jashtëmartorese
- Hapet dosja e Kokalarit, ja si ruhej dyqani i saj në shtator '45

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Quiz online nga Kadri Vokopola Ja edhe pyetjet për sot 11 shkurt 2017
- Protesta, Basha kërkon ngritjen e çadrave para zyrës së Ramës
- Meta: Jo frikë nga reforma, ka politikanë që s'kalojnë Vettingun
- Itali, Bes Kallaku pjesë e spektaklit të humorit, 'skifteri në shtëpinë e tij'
- Grabitja e 2,7 milionë €, rojet: I fikëm kamerat se do pinim kafe

VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

Parashikimi i motit për datën, 10.02.2017 dhe javën në vazhdim për vendin tonë dhe rajonin

Parashikimi i motit për datën, 11.02.2017 dhe javën në vazhdim për vendin tonë dhe rajonin


Grabitja, Tahiri: Policia do të shoqërojë transportin e parave

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

A është me vend protesta e PD për zgjedhjet që do zhvillohet më 18 shkurt?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



2.142 | 323 918
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

FJALËKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 34 KUTI

17x17 crossword grid with numbers 1-17 in the first column.

HORIZONTAL

- 1. Janë pikat e veçanta në kontartë. -Një tip... kërcimi. -Fillojnë daljen. 2. Një thënie e Horacit. -Fund i një fatziu. -Me të nxjerrin një tezë. 3. Kampionat me Boston Celtics. -Mish-pa kocka. -Lëvizje Autonome Lokale. -Lauda ish-pilot. 4. Bogarde që ektor. -Është shterpëzimi. 5. Emri i lashtë i Trojës. -Ai aureus është bakter që shkakton infeksione. 6. Moore aktore. -Bashkojnë kënde të kundërta në katror. 7. Është baba. -Është dash i sakrifkuar. -Ian Fleming. 8. Fillojnë takimin. -Mund të jenë nusërie. -Ai dhe ajo. -Harris aktor 9. Ushtrohet me imponim -Skllavja e Abrahamit. -Robert Redford. 10. Gjysma e rrogës. -Ente Informative Rajonale -Fara këngëtare. -U shkrua nga Zola 11. Adresa e shkurtër. -Janë tek në sende. -Një fjalë si kudo. 12. Mund të jetë mallrash.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Word search grid with words hidden horizontally and vertically.

-Lumë në Spanjë. -Është ekspert i të bukurës

VERTIKAL

- 1. Hidhen për t'u zgjedhur. -Janë tek në radar, 3. Është irritim. -Gustave që e piktor e ilustrues. 4. Diftong në duar. -I ka tek klori. -Kështu fillon filmi. 5. Zërat pa zanore. -... i ri është qytet i yni.

- 6. ... Dei i de Balaguer. -Hoffman aktor. 7. Lëvizje Ekonomike Lokale. -Janë zyza në komo 8. Inicialet e Daudet. -... Mater në një lutje të Jacopone da Todi. 9. Një Xhemil aktor. -Inicialet e Gide 10. Mund të jetë celular. -Brian o Roxy Music. 11. Valeria showgirl. -Malet pa kufij. 12. Andi futbollist

- Janë spektakolare të tilla polare. 13. Fundi i një samurai -Heroina e Nabokov -Kufizojnë e botës. 14. Ishin luftat romako-kartagjenase. -Mbyllin të çara. 15. Kush është... është i aftë. -Gjysmë aneksi. 16. Një çast në malësi. -Një pije... Branca. 17. Është këndi ndërmjet rrafshit të meridianit dhe atij pingul të një -Pak dramatike

FJALËKRYQI SPORTIV

Sports crossword grid with images of soccer players.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Word search grid for sports crossword.

HORIZONTAL

- 1. Shefqeti qw qe porier 4. Gjysmë alarmi. 7. Johnson që qe atlet i famshëm. 10. Fillojnë metodën. 11. Hingis tenisiste. 12. Është përfaqësuesja e tulipanëve. 15. Në fund të vitit 16. Cristiano CR7 17. Mauricio mesfushor kilian 20. Arte pa re. 22. El Gaucho i futbollit. 24. Janë në derë. 26. Një pjeë e boksit 28. Alien pa çifte. 29. I paharruari Minga

- 31. Inicialet e Morata-s. 32. Fillojnë nazet. 33. Një pjesë e territorit. 34. Kështu fillon loja. 37. Muhammad, alias Cassius Clay. 40. Personazhi në foto. 44. Ruhet ajo sportive. 46. Personazhi në foto.

VERTIKAL

- 2. Është private ajo e imja. 3. Është livadh. 4. Një pjesë e amerikanëve. 5. Luan derby me Roma-n 6. Marsi i akëjve. 7. Fillojnë bisedimet. 8. Pak enigmatike. 9. King Cole i muzikës. 10. Paolo, ish as- i Milan 12. Keisuke te Milan. 13. Altin ish-mesfushor. 14. Titulli i Capello-s. 16. Hoëard regjisir. 18. Me të bëjnë letër. 19. Pak arbitrare. 21. Fillojnë trainimin. 22. Një pije piratësh 23. Me të mxjerrin thatë. 25. Kufizojnë gjuajtjen. 27. Në hyrje tëv oazit 29. Emër djali. 30. Ka shumë një kampion. 35. Një e shkruar në dollar. 36. Fara këngëtare. 37. Gjysmë alarmi. 38. Pak lagështirë. 39. Gjysma e normës 41. Fillojnë drejt 42. Janë në digë. 43. Unë... në Itali. 44. Hekuri në tabelë. 45. Në krye të rojave

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGJA 1-9

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

PËRGJIGJE

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do i merrni gjerat shume me seriozitet ju te dashuruarit dhe do bëni te pamundurën qe te zgjidhni edhe disa mosmarrëveshje qe keni pasur. Beqaret do ndihen mjaft mire ne ambientin e qete ku jetojnë dhe nuk do bëjnë asnjë lloj përpjekjeje për ta ndryshuar atë. Ne planin financiar fati ka për te qene gjate gjithë kohës ne anën tuaj dhe gjendja do jete e shkëlqyer.

LUANI

Ka rrezik te mos i qëndroni besnike partnerit tuaj sot dhe kjo fale joshjes qe do iu beje dikush qe e njihni. Çdo hap qe do hidhni do ndikojte tek e ardhmja juaj. Beqaret do jene te matur dhe do dine se me cilët persona te shoqërohen. Shume shpejt ata mund te ndryshojnë edhe lidhjen. Buxhetin do arrini ta stabilizoni goxha dhe do i kryeni pa problem shpenzimet e nevojshme.

SHIGJETARI

Nëse jeni ne një lidhje do ndiheni me te lutur se kurrë ne krahët e partnerit tuaj. Ne fakt ai qe keni ne krah do perkujdeset për çdo detaj. Beqaret me ne fund do takojnë një person qe do ju preke zemrën dhe shpirtin. Me te do fillojnë një lidhje vërtet fantastike. Për financat ka për te qene dite e qete. Nuk do keni aspak vështirësi për te bere edhe disa investime te menduara.

DEMI

Do jeni shume te sinqerte me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe do flisni hapur me te për gjithçka. Kjo gjë do ju afroje edhe me tepër, pavarësisht se te dy palët do kenë pakënaqësi. Me komunikim dhe mirëkuptim arrihet çdo gjë. Beqaret do kenë prioritet te tjera dhe nuk do e kenë mendjen tek dashuria. Financat do jene goxha me te mira për shkak te gjithë kujdesit qe keni treguar.

VIRGJËRESHA

Dite goxha e tensionuar do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Mes tyre dhe partnerit nuk ka për te ecur asgjë si duhet. Beqaret me mire le te presin edhe pak kohe para se te hedhin hapa, pasi nuk është ende momenti i duhur. Financat nuk kane për te qene aspak problematike kështu qe me një strategji me te mire mund te arrini edhe ta përmirësoni situatën.

BRICJAPI

Nuk do keni për çfarë te ankoheni sot ju te dashuruarit sepse yjet do perkujdesen ne çdo moment dhe marrëdhënia ne çift do jete e shkëlqyer. Beqaret gjithashtu do kenë një dite te animuar dhe te mbushur me takime. Gabim do jete nëse ata nuk do pranojnë te shoqërohen me asnjë. Ne planin financiar do i bëni me kujdes llogaritë dhe gjendja ka për te qene e shkëlqyer.

BINJAKËT

Mundohuni ta kontrolloni veten sot ju te dashuruarit sepse ne te kundërt keni për te pasur probleme serioze me partnerin. Nuk mundet te kërkonit gjithë kohës te jeni ju mbi këdo. Për beqaret nuk do mungojnë mundësitë për takime, por rastet nuk do jene ashtu si ata kane pritur. Buxheti nuk do jete ne gjendjen me te mire te mundshme kështu qe kujdes me çdo lloj shpenzimi.

PESHORJA

Do keni diskutime te gjata me partnerin tuaj gjate kësaj dite lidhur me disa probleme te se shkurarës, por edhe për te ardhmen. Mund te merrni edhe disa vendime. Beqaret duhet te jene me te duruar ne mënyrë qe te gjejnë personin qe do ju përshatet me se miri. Sot mundësitë nuk do jene ato qe keni pritur. Nëse doni financa me te mira duhet patjetër te ulni ne maksimum shpenzimet.

UJORI

Dite shume normale do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Me partnerin nuk do keni as mosmarrëveshjen me te vogël. Beqaret duhet te bëjnë atë qe do ndiejnë pas takimeve qe do kenë. Po menduan për çdo detaj dhe sesi do shkoje e ardhmja kane për te mbetur vetëm gjithmonë. Ne planin financiar do ketë disa ndryshime mjaft pozitive.

GAFORRJA

Jeta juaj ne çift nuk ka për te qene aspak e keqe sot. Do dini si te ruani një klime te ngrohte dhe bashkëpunimi do mbizotërojë ne çdo moment. Beqaret do kenë një dite normale. Pavarësisht se nuk do mungojnë mundësitë për njohje te reja, ato do preferojnë t'i marrin gjerat sa me shtruar. Ne planin financiar kënaquni me gjendjen qe keni dhe mos kërkonit përmirësime te jashtëzakonshme.

AKREPI

Nëse jeni ne një lidhje as qe duhet t'iu shkoje ndërmend te flitroni me dike tjetër sot sepse situata mund t'iu dale jashtë kontrollit atëherë kur nuk e prisni. Beqaret nuk duhet te presin ndonjë ngjarje te jashtëzakonshme, por gjithsesi disa takime interesante do mund t'i realizojnë. Financat do i keni tej mase kujdes dhe pak nga pak gjendja do filloje te normalizohet.

PESHQIT

Mundohuni te mbani larg rutinën nga jeta juaj ne çift gjate kësaj dite sepse ajo mund te jete shkatërruese. Flisni hapur me partnerin dhe bëni atë qe është me e mira për te dy. Beqaret do kenë mundësi te shumta për aventura kalimtare te cilat do ua mbushin zemrën me gëzim. Nëse duan lidhje serioze do ju duhet te presin edhe pak. Ne planin financiar gjendja do jete e mire.

PËRGJIGJE

Word search grid for horoscope section.

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

17x17 cryptogram crossword grid.

NA VIZITONI



BUNK'ART 2



**EKSPOZITA VIDEO-MUZEALE BRENDIA ISH-BUNKERIT
ANTI-BËRTHAMOR I MINISTRISË SË BRENDSHME**

www.bunkart.al / info@bunkart.al

**HAPUR ÇDO DITË:
10:00 deri 20:00**



**Prenotime:
+355 (0) 67 20 72 905**

**RR. "ABDI TOPTANI"
PRANË MINISTRISË
SË BRENDSHME-TIRANË**

